



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XII-të (dymbëdhjetë) -e rregullt, mandati VIII-të, e mbajtur më 29 qershor 2026.

Mbledhja filloi në orën 12:55 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Isak Shabani Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës, dhe atë:

Nga LVV: Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Luljeta Muçolli-Azemi; Haki Rudari; Abedin Zeka; Avni Isalmi; Ardi Hasani, kurse munguan: Flandra Kadriu, Vlora Jashanica, Qëndresë Hajrizi.

Nga LDK: Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Blerta Azemi-Berisha; Ekrem Rrahmani; Ermal Osmani; Arben Xhemajli; Arnisa Sylejmani; Isak Ejupi, kurse munguan: Valdet Restelica, Valon Demolli; Gresa Qosa-Maqastena.

Nga PDK: Isak Shabani-Kryesues i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi,

Nga GUXO: Demokrat Hodolli, i cili mungoi.

Nga Unioni i Blakçorve: Gentrit Arifi.

Nga AAK: Baki Feta,

Gjithashtu të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, z.Fahri Restelica Nënkrjetar i Komunës; U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtorja e Administratës DA; Arbnorë Uka Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Ahmet Ahmeti-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Valbona Ibishi Azemi-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMH; Behram Latifi-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe, përfaqësues media lokale (TV Llapi), përfaqësues të KFOR; dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë, konstatoi kuorumin ku sipas listës së nënshkrimeve dhe numërimit, 27 anëtar/e të Kuvendit ishin prezent për momentin në sallë dhe konstatohet se ka kuorum për vendimmarrje dhe mbarëvajtje të punës, ndër të tjera theksoi, para se të fillojmë me rendin e ditës ju njoftoj se kjo seancë është thirrë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, po ashtu thirrjen dhe rendin e ditës e keni marrë me kohë, mirëpo siç edhe jeni njoftuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është propozuar edhe një pikë shtesë e rendit të ditës që është, *Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-71712029-00209-0 në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm, dhe si pjesë e këtij propozimi është edhe nënpika Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00209-0, në sipërfaqe 38882 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm,* prandaj unë fillimisht e hedh në votim propozimin (pikën dhe nënpikën shtesë) që është trajtuar në KPF dhe që është rekomanduar për këtë seancë, që të hyjnë si pika shtesë në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryesues do të ishte mirë që paraprakisht të na jep një fjalë hyrëse ndokush nga Ekzekutivi i Komunës, këtu qenka edhe drejtoresha e drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, andaj do të ishte mirë që para se të votojmë ta kemi arsyetim përse kjo pikë e rendit të ditës po propozohet si pikë shtesë në këtë mbledhje dhe pse nuk ka ardh me kohë.

Kryesuesi i kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, unë e kam parë në Rregulloren e punës së Kuvendit që thuhet se për propozime për pika shtesë nuk hapet debat por vetëm hedhen në votim, por si do iku do nga praktika e deritanishme ne kemi dëgjuar arsyeshmërinë para se të hedhet në votim ashtu siç e ceku edhe parafolësi zotëri Rrahmani. Pra nuk prish punë asgjë që edhe tani të jepet arsyeshmëria nga ana e Drejtoreshës së DPKGJ nëse veç dëshiron, urdhëroni e nderuar.

znj.Saranda Stublla-Uka, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ, theksoi, atëherë siç jeni në dijeni në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është paraqitur si propozim për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për këtë seancë ky propozim të cilin e lexoj Kryesuesi i Kuvendit paraprakisht së bashku me propozimin tjetër shtesë që ka të bëjë me formimin e komisionit për këtë parcelë. Arsyeja përse është ardh paksa me vonesë është se kamë qenë në pushim vjetor, po ashtu edhe shefes së sektorit i'u desht të shkoj në pushim disa ditë, andaj për këtë arsye është bërë vonesa e dërgimit të materialit, por që sipas procedurave ligjore kemi të drejtë madje edhe sot të propozohet, do të thonë nuk na ndalon ligji, kështu që pres përkrahjen e juaj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë e dëgjuat edhe një herë arsyeshmërinë dhe propozimin në fjalë, andaj e hedh në votim që të hyjë në rend të ditës si pikë dhe nënpikë shtesë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, Njëzëri me 26 vota Për, mbështetet propozimi i Kryetarit të Komunës i prezantuar nga Kryesuesi i Kuvendit dhe Drejtoresha e DPKGJ, dhe sipas rekomandimit të KPF nga mbledhja e mbajtur më 26.06.2026, që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihen edhe pika/nënpika shtesë, sipas materialit përkatës të prezantuar dhe dërguar me Konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së, dhe atë: (në pikën 6 dhe 6.1)

-Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-71712029-00209-0 në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm.

-Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00209-0, në sipërfaqe 38882 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, do të thotë të gjithë ju e keni rendin e ditës para vetës, po ashtu edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 26.06.2026, së bashku me materialet përkatëse të këtyre pikave, përfshirë edhe pikat shtesë.

Tani unë si Kryesues i Kuvendit dua të propozoj edhe një pikë të rendit të ditës që të hyjë edhe kjo si pikë shtesë në këtë mbledhje (para pikës Të Ndryshme). Të nderuar kolegë, nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal na është sjellë një Shkresë sipas të cilës ne si Kuvend na duhet ta rishqyrtojmë vendimin e Kuvendit të Komunës të cilin e kemi marrë më 31 mars 2026 për dhënien në shfrytëzim Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit, pra në bazë asaj që ka ardh nga MAPL vendimi në fjalë nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, dhe ndër arsyet që është kërkuar që ne si Kuvend ta rishqyrtojmë atë vendim është sepse është evidentuar se parcela kadastrale në të cilën gjendet objekti i ish Emergjencës së qytetit i cili jepet në shfrytëzim afatgjatë nuk është pronë e Komunës së Podujevës por është pronë e cila figuron në emër të personave individual e po ashtu edhe evidentohet që e njëjta parcelë kadastrale me nr.258-0 në ZK Podujevë është në konteste gjyqësorë, prandaj MAPL e ka vlerësuar që nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, kështu që ne do ta fusim si pikë shtesë në

këtë kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje dhe pastaj do ta rishqyrtojmë atë vendim sipas rekomandimeve të MAPL-së.

Sa i përket procedurës së rishqyrtimit kemi të bëjmë me tri variante, -plotësim ndryshim i vendimi e që nuk kemi mundësi në këtë rast sepse është vlerësuar i paligjshëm, -shfuqizim i vendimit e që edhe këtu nuk vie në shprehje kjo si mundësi sepse nuk kam pranuar të publikohet deri sa nuk kemi marrë vlerësimin e formës së prerë nga MAPL, kështu që na mbetet forma -anulim i vendimit e që mendoj se kjo vie në shprehje në këtë rast pasi që kemi marrë vlerësimin si jo të ligjshëm të këtij vendimi nga MAPL.

Tani do t'jua shpërndajnë administrata materialet përkatëse ku është edhe Shkresa e MAPL-së sa i përket vlerësimit ligjor të këtij vendimi,

Pra propozimi im është që të hyjë në rend të ditës si pikë shtesë, *Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-463/06-0019215/26 të datës 31 mars 2026 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit.*

Do të thotë kjo është ajo që unë e paraqita si arsyeshmëri që nga MAPL vendimi në, fjalë na është kthyer mbrapa në procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë, me kërkesën e tyre për ta rishqyrtuar në Kuvend, mirëpo pastaj gjatë debatit në këtë pikë të rendit të ditës mund të diskutojmë më gjerë, prandaj e hedh në votim që edhe ky propozim i imi të hyjë në rend të ditës si pikë shtesë në këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 25 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë e Përmbajtur, mbështetet propozimi i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës që në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje të përfshihen si pikë shtesë edhe pika sipas materialit përkatës të prezantuar tani në këtë mbledhje, dhe atë:

-Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-463/06-0019215/26 të datës 31 mars 2026

-Shkresa e MAPL-së nr.020-270/10 datë 12.03.2026,

(pikë kjo e cila rendit si pikë e 7, kurse pika Të ndryshme kalon si pikë 8 e rendit të ditës)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani vazhdojmë me rendin e ditës, urdhëroni kush dëshiron fjalën.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, para se të vazhdojmë me procedurat e miratimit të rendit të ditës deshta t'ju bëjë një pyetje i nderuar Kryesues se në bazë të të cilit plan jemi mbledhur ne sot këtu për të diskutuar, nëse jemi mbledhë në bazë të Planit të punës së Kuvendit për vitin 2026 e që unë si anëtare e komisionit përkatës që e kemi hartuar dhe që e kemi proceduar në Kuvend për miratim dhe që e kemi votuar këtu, madje ju jeni zotuar që do të punoni në bazë të atij Plani të punës. Pra a mund ta dimë përse në qershor 2026 në plan të punës në këtë muaj janë paraparë Informata prej Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, dhe prej Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, andaj përse nuk janë pika të rendit të ditës në këtë muaj, a po punojmë në bazë të planit apo nuk po punojmë në bazë të planit, nëse jo atëherë nuk lodhemi të krijojmë Plan të punës fare dhe pastaj të mos i zbatojmë ato.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, thënë të drejtën ju e keni parë që ka propozime të shumta për këtë mbledhje, do të thotë janë 8 pika në rend të ditës, madje ndër to kemi edhe Kornizën Afatmesme Bbuxhetore, Raportin e Auditimit dhe të tjera, pra është e stërngarkuar, kështu që kam menduar që ndoshta më mirë do të ishte që në mbledhjet tjera që do të jenë më të lira dhe që do të kemi mundësi t'i debatojmë më gjerësisht sepse nëse i bëjmë sot 12 pika do të ishte shumë, kështu që kjo ka ardhur si propozim edhe në marrëveshje me Kryetarin e Komunës dhe Drejtoritë komunale, andaj po besoj që nuk prishë punë, nuk është që s'jam duke e përcjellë edhe Planin e punës, besoj se nuk do të kalohet asnjë pikë e planifikuar, por nëse vie puna te shtyrja njëmuajore apo diçka tjetër, ta kemi parasysh se ajo ndodh vetëm për shkak të stërngarkesës së pikave të rendit të ditës.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, në rregull atëherë i nderuar Kryesues, shtyrja njëmuajore ndodh sepse njerëz jemi dhe kuptojmë komplet këtë punë, mirëpo sa i përket pikave të rendit të ditës edhe në qoftë se bëhen shumë, ne fundja për atë punë jemi të thirrur me ardh në mbledhje, të diskutojmë dhe të qëndrojmë

këtu sepse edhe po paguhemi për këtë punë. Megjithatë nëse janë shtyrë ato pika për këtë shkak që e ceku Kryesuesi është në rregull, vetëm të sqarohemi a nuk kanë dashur drejtorët e Drejtorive t'i sjellin Informatat apo për çfarë arsye nuk janë përfshirë në rend të ditës, prandaj në këtë rast mendoj që dy pikat e cekura duhet të përfshihen në seancën e ardhshme të muajit korrik.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, plotësisht ke të drejtë e nderuar Arnisa, sinqerisht t'ju them të drejtën drejtorët e atyre dy drejtorive kanë shpreh gatishmërinë t'i sjellin ato Informata por unë mendova dhe e vlerësova që po e ngarkojmë si shumë seancën, plus paraprakisht ishte edhe vazhdimi i seancës së kaluar, andaj ju them se vetëm kjo ka qenë, përndryshe ato Informata të gatshme siç më kanë njoftuar drejtorët.

Tani unë po e hedh në votimin komplet rendin e ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje, përfshirë Koontstaimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 26.06.2026, si dhe pikat shtesë të cilat u mbështetën paraprakisht në fillim të kësaj mbledhje që të hyjnë si pika shtesë sipas materialeve përkatëse të dërguara dhe prezantuara.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 27 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së si dhe duke përfshirë edhe pikat shtesë të cilat u mbështetën paraprakisht për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e datës 26.06.2026 respektivisht materialit të prezantuar sot në fillim të kësaj mbledhje, (të cilat renditen në 6 dhe 6.1; 7)

Rendi i miratuar i ditës:

1. Procesverbali nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 01.06.2026
2. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga vitit 2025 në vitin 2026 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore
3. Propozim vendimi për transfer / rialokim të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimi në kategori dhe programe të caktuara buxhetore
4. Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2027/2029
5. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit - ZKA për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2025.
- 5.1. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e ZKA
6. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-71712029-00209-0 në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm
- 6.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00209-0, në sipërfaqe 38882 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm
7. Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-463/06-0019215/26 të datës 31 mars 2026
- Shkresa e MAPL-së nr.020-270/10 datë 12.03.2026
8. Të ndryshme

1. Procesverbali nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 01.06.2026

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sigurisht keni mund ta lexoni këtë procesverbal i cili ju është dërguar me materialin e mbledhjes, andaj urdhëroni nëse ndokush ka ndonjë vërejtje eventuale, sugjerim apo ndonjë korrigjim, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë procesverbal sipas materialit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 27 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 01.06.2026, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga vitit 2025 në vitin 2026 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, me radhë kemi propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga vitit 2025 në vitin 2026 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, andaj ftoj për fjalë hyrëse propozuesen e kësaj pike drejtoreshën e DBF të mërcë fjalën.

znj.Arbnorë Uka-Osmari, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para jush keni propozim vendimin për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2025 në vitin 2026 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore. Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës të pashpenzuara për vitin 2025 në shumën e gjithmbarshme prej 1,440,443.17 € nga e cila shuma prej 832,008.11€ është tejkalim i të hyrave vetanake të planifikuara për vitin 2025, këto barten në vitin 2026 në programet dhe kategoritë ekonomike si në vijim: Në kategorinë e shpenzimeve kapitale kemi vlerën e gjithmbarshme në të gjitha programet 1,278,620.09€ dhe atë të planifikimi dhe zhvillimi ekonomik të ndërtimi i Tregut të ri të qytetit kodi i projektit 55189 shuma 252,682.40€, kjo bartje në këtë projekt bëhet për arsye se ky projekt pritet që të përfundojë deri në fund të vitit 2026 dhe për këtë arsye nevojitet kjo bartjet e këtyre mjeteve të ky program. Programi tjetër është infrastrukturë publike të projekti Rregullimi i infrastrukturës së varrezave të qytetit në vlerë 115,510.48€, kjo po ashtu është projekt dhe obligim kontraktual i cili pritet të vazhdojnë punimet deri në fund të vitit 2026 dhe është paraqitur nevoja e bartjes së kësaj vlere.

Pastaj të planifikimi hapësinor dhe rregullativ është projekti në vazhdim, zgjerimi ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “Xhemajl Mustafa” me infrastrukturë përcjellëse, shuma 147,627.96 € si dhe projekti tjetër është ndërtimi i rrugës lidhëse nga magjistranja Podujevë-Prishtinë deri në rrugën “Vëllezërit Frashëri” si dhe rrugën “Shaban Shala”, kodi i projektit 5191, shuma prej 153,849.67 €, mjete këto që po ashtu barten për të finalizuar punimet të cilat kanë mbetur në gjysmë, si dhe një faturë e papaguar të projekti rruga “Vëllezërit Frashëri”.

Programi tjetër është shërbimet e shëndetësisë primare, projekti për ndërtimin e QMF 3 në Podujevë bashkëfinancim me Organizatën Chatar Charity Kosova në shumë 77,829.00 €, kjo është kjo faturë e pranuar gjatë vitit 2026, do të thotë është pranuar me vonesë nga ana e Chatar Charity dhe për arsye se në buxhetin e vitit 2026 nuk kemi pasur kod për të bërë këtë pagesë, atëherë është paraqitur nevoja që prej të hyrave vetanake të bëhet kjo pagesë.

Të programi tjetër është arsimit parafillor çerdhet, ndërtimi i Kuzhinës qendrore për fëmijë në çerdhe dhe nxënës të shkollave në Podujevë, vlere është 203,000.00€, kjo është e nevojshme për finalizimin e këtij projekti i cili parashihet që deri në fund të vitit 2026 të përfundojë i tëri.

Mandej programi tjetër është arsimit fillor, projektet janë si në vijim: Ndërtimi i sallës së brendshme sportive në shkollën “Ali Ajeti” në Sfeçël, vlere 206,452.34 €. Projekti për ndërtimin i shkollës në “Hasan Ramadani” në Shajkoc shuma 75,730.24 €, dhe Projekti i tretë është ndërtimi i aneksit të shkollës “Naum Veqilharxhi” në Llapashticë vlere 45,938.00 €. Të gjitha këto projekte kanë qenë të kontraktuara më herët dhe kjo është vlere e fundit e cila pritet që të finalizohen si projekte.

Kemi edhe një pagesë për në kategorinë e mallrave që është përmes arsimit fillor për furnizimin me lëndë djegëse dru, ky furnizim është bërë gjatë vitit 2026 dhe ka mbetur faturë e papaguar në vlerë 86,000.00€.

Në kategorinë e shpenzimeve komunale kemi propozuar vlerën 75,823.08 €, nëpër kategori të ndryshme që është në administratë, për shërbimet e kujdesit primar shëndetësor, për arsimin parafillor çerdhet, për arsimin e mesëm, dhe kjo vlerë është e nevojshme të vendoset të shpenzimet komunale për arsye se pritët që deri në fund të vitit të kemi shpenzime komunale për shkak që vitin e kaluar me vendime gjyqësore të shpenzimet komunale janë marrë mjetet buxhetore dhe kanë mbetur disa fatura të papaguara për shërbime

komunale të cilat janë realizuar në vitin 2026 dhe në këtë mënyrë kjo vlerë është e nevojshme për finalizimin e pagesave kur të vijnë gjatë vitit 2026.

Pres përkrahjen nga ana e juaj që ky propozim vendim të aprovohet dhe po ashtu pres edhe komente nëse keni lidhur me këto projekte të propozuara.

z.Haki Rudari, theksoi, ne sot kemi një propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2025 në vitin 2026 dhe destinimin e tyre në kategori apo projekte të ndryshme.

Të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës të pashpenzuara për vitin 2025 në shumën prej 1,440,443.17€, nga e cila shumë 832,008.11€ janë të hyra vetanake të tejkaluara në bazë të programit të cilën e ka bërë Drejtorja. Këto të hyra vetanake sigurisht që do të barten për programe të rëndësishme të cilat do t'i lexojnë në vijim. Ndërtimi i Tregut të ri të qytetit, në fakt unë nuk do t'i lexoj të gjitha sepse i ceku drejtoresha, pastaj Rregullimi i infrastrukturës së Varreza të qytetit, mandej Planifikimi hapësinor rregullativ, te Shërbimet shëndetësore në arsim dhe të tjera, prandaj ne Grupi i LVV-së konsiderojmë se këto projekte janë të rëndësishme për jetën qytetarëve dhe do ta përkrahim përmes votimit.

z.Besim Latifi, theksoi, ne Grupi LDK-së e mbështesim bartjen e të hyrave vetanake dhe konsiderojmë që është në interes të qytetarëve që këto mjete të shfrytëzohen në projektet e cekura nga drejtoresha e DBF-së në fjalën hyrëse, mirëpo kemi vërejtje për shkak të vonesës së bartjes së këtyre mjeteve ngase kjo ka mund të bëhet në mars ose në prill. E kam cekur edhe herën e kaluar që të krijohen mundësitë që saktësisht këto mjete të shfrytëzohen dhe të mos rrezikojmë që përsëri të mos mund t'i shfrytëzojmë këto mjete.

Për mua ajo çka ishte absurde dhe që kam vërejtje si dhe që kërkoj sqarim është tek çështja e rrugës “Xhemajl Mustafa” sepse ne e dimë që kjo rrugë ka përfunduar andaj a kanë mbetur obligime të papaguara apo çka ka ndodhur saktësisht.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, në parim ne Grupi i PDK-së e përkrahim bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026. Janë disa mangësi që besoj që duhet t'i diskutojmë të gjithë së bashku gjatë procesit, por si parim ne e përkrahim këtë pikë.

znj.Arbnorë Uka-Osmari, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, sa i përket rrugës “Xhemajl Mustafa” është një faturë e cila është e pa paguar për shkak që në buxhetin e vitit 2026 nuk ka qenë e planifikuar për shkak të vendimeve gjyqësore të cilat janë marrë nga ky projekt viteve të kaluara dhe ka mbetur pa u realizuar. Ndërsa rreth asaj që pse bartja e hyrave vetanake është realizuar në këtë muaj, do të thotë se bartja tani bëhet për shkak që kemi pritur vendimin e Thesarit, barazimin me Thesar e Shtetit, kjo për shkak siç e dini edhe ju që për një cent mund të mos ketë barazim dhe pastaj i bie që të sjellët edhe njëherë në Kuvend e që mendoj se është e tepërt. Kështu që kemi pritur aprovimin edhe vendimin e Departamentit të Thesarit në kuadër të Ministrisë së Financave.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën rreth kësaj pike unë e hedh në votim miratimin e propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2025 në vitin 2026 dhe destinimi në kategori dhe programe të caktuara buxhetore sipas materialit që ju është dërguar si dhe asaj që e prezantoi drejtoresha e DBF-së në fjalën hyrëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 26 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, miratohet propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga vitit 2025 në vitin 2026 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, sipas përmbajtjes së materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Propozim vendimi për transfer / rialokim të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimi në kategori dhe programe të caktuara buxhetore

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në këtë pikë kemi të bëjë me propozim vendimin për transfer / rialokim të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, andaj urdhëroni e nderuara drejtoresh e DBF mund ta paraqitni fjalën hyrëse dhe arsyeshmërinë e kësaj pike.

znj.Arbnorë Uka-Osmari, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para jush keni propozim vendimin për transfer - rialokim të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore.

Pra kemi të bëjmë me transfer të mjeteve nga kategoria e subvencioneve nga programi planifikimi dhe zhvillimi ekonomik vlera prej 45,000.00€ të cilat ridestinohej te programi bujqësia, pra në vlerë 45,000.00€ me synimin për subvencionimin e bujqve për litër qumësht në blegtori të cilën e kemi pasur edhe zotim edhe premtim të Kryetarit të Komunës.

Ridestnimi apo transferi tjetër i mjeteve është nga kategoria e kapitaleve nga arsimit fillor, do të thotë nga tabela dixhitale kodi i projektit 52635 shuma 100,000.00€ të cilat ridestinohej te ndërtimi i një objekti të shkollës së mesme në vlerë e njëjtë 100,000.00€, kjo bëhet me qëllim që të finalizohet objekti i shkollës së mesme te kampusi i shkollave të mesme dhe pritet që ky objekt të vihet në funksion në fund të vitit 2026.

Po ashtu është edhe një propozim tjetër nga programi po ashtu i arsimit që është fillimi i aneksit të shkollës “Xheladin Rekaliu” vlera 200,000.00€ që po ashtu bartet te i njëjti program arsimit i mesëm, kodi i projektit është 51920 në shumën e njëjtë 200,000.00€ pra është ndërtimi i një objekti të shkollës së mesme te kampusi i shkollave të mesme, pra kjo bëhet për arsyen e njëjtë për shkak që presim finalizim të këtij objekti dhe vënien në shfrytëzim nga nxënësit. Arsyeja pse është marrë prej ndërtimit të aneksit të shkollës “Xheladin Rekaliu” është për shkak që nuk i kemi iniciuar procedurat e prokurimit për ndërtimin këtij aneksi. Ndërsa te tabela dixhitale presim që prej 150,000.00€ që kanë qenë me buxhet të Komunës për vitin 2026, shuma prej 100,000.00€ të bëhet ridestnim, kurse shuma prej 50,000.00€ të bëhet inicim i procedurave për tabela dixhitale.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, sot po e shqyrtojmë këtë propozim vendim për rialokimin e mjeteve buxhetore. Fillimisht ne Grupi i LVV-së e përkrahim rialokimin e 45.000.00€ për subvencionimin e fermerëve në litër qumësht, pasi që mbështetja e bujqësisë është shumë e rëndësishme për Komunën tonë. Sa i përket arsimit, po ashtu e mbështesim edhe ndërtimin e objektit të shkollës së mesme te kampusi i shkollave të mesme pasi që është një investim i nevojshëm, mirëpo shprehim shqetësimin tonë sa i përket ridestnimit të mjeteve nga projekti i tabelave dixhitale dhe aneksit të shkollës “Xheladin Rekaliu”, prandaj nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave kërkojmë sqarim për qytetarët se kur do të fillojnë procedurat e realizimit të këtyre dy projekteve.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne Grupi i LDK-së jemi kundër dhe e kundërshtojmë këtë sepse mendojmë që është e kundërligjshme. Unë edhe në KPF debatova me drejtoreshën e DBF lidhur me këtë sepse Ligji për buxhetin e vitit 2026 tregon qartë se përqind të buxhetit keni të drejtë të rialokoni sepse kjo çështje rregullohet me përqindje e që është 15%, ndërsa këtu ka nën programe që shkojnë deri 100%.

Ne e kemi pas kesi rasti edhe në vitin 2023 ku edhe pse MAPL e ka pranuar atë vendim, Ministria e Financave nuk e ka pranuar dhe e ka kthyer si të kundërligjshëm, dhe edhe tani me këtë mendoj që prapë do ta bëjë të njëjtën gjë.

Çështja tjetër që dua ta them është shembull, çfarë matjesh ka bërë drejtoresha e DBF dhe përse është vendosur që t'i merret buxheti Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE apo nga subvencionimi për biznese dhe të kalojnë te bujqit, pra duhet të jepet një arsyetim se cili ekspert e ka paraparë kështu dhe nëse ka qenë premtim elektorale e që e di se ka qenë, por ka qenë njëherë premtim

edhe që 400,000.00€ t'i ketë edhe DPZHE për biznese. Pra nëse i ke planifikuar 400,000.00€, pastaj i ke vë aty 350,000.00€ dhe 340,000.00€ do të thotë 45,000.00€ po jua heq atyre dhe po mbeten 295,000.00€. Mirë do të ishte të kryhet njëherë puna e subvencionimit sipas planifikimit, aq më shumë për Ndërmarrjet publike sepse aty shkruan subvencione për Ndërmarrjet publike dhe për Ndërmarrjet private, kurse tani përse është zvogëluar kjo shumë, nëse ka mundësi të na jepni një sqarim.

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, dua t'ju jap përgjigjem me radhë, sa i përket tabelave dixhitale jemi në fazën e fillestare të prokurimit dhe po besoj që shumë shpejt veç do ta finalizojmë, kurse aneksi i shkollës "Xheladin Rekaliu" pritet për vitin e ardhshëm.

Sa i përket tejkalimit të përqindjes që u përmend, ne i kemi bërë matjet dhe sipas neve jemi në rregull kështu që po mbetet të vlerësojnë MAPL dhe MF dhe të kthejnë opinionin e tyre të fundit nëse është ligjore apo jo. Këto mjete kemi vlerësuar që është e nevojshme fillimisht sivjet të fillojmë me 45,000.00€ subvencion për litër qumësht, mandej për vitet e ardhshme do të planifikojmë që edhe te zhvillimi ekonomik si dhe te bujqësia, paralelisht t'i përkrahim këta dy sektorët.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ta lajmëruar për diskutime tjera, atëherë hedh në votim miratimin e këtij vendimi për transferimin dhe rialokimin të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimin në kategori dhe program e caktuara buxhetore, sipas materialit që e keni marrë më herët.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 26 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 17 vota Për, 8 vota Kundër, 1 votë Të Përmbajtur, miratohet propozim vendimi për transfer / rialokim të buxhetit të Komunës së Podujevës dhe destinimi në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, sipas përmbajtjes së materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2027/2029

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani në radhë është pika e katërt të rendit të ditës, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës për vitet 2027-2029. Andaj edhe për këtë ftoj propozuesin e kësaj pike që është drejtoresha e DBF të prezantoj këtë pikë.

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, gjithashtu para jush kemi paraqitur Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për vitet 2027-2029 e cila përbën dokumentin kryesor strategjik për planifikimin e buxhetit komunal për tre vitet e ardhshme. Ky dokument është hartuar në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin për financat e pushtetit lokal, Ligjin për vetëqeverisjen lokale, Ligjin e buxhetit si dhe Qarkoren Buxhetore 2027 të Ministrisë së Financave.

Prioritetet kryesore për periudhën 2027-2029 janë, zhvillimi i infrastrukturës në qytet dhe në fshatra, përmirësimi i arsimit dhe shërbimeve shëndetësore, rritja e mirëqenies sociale, mbështetja e kulturës rinisë dhe sportit, zhvillimi ekonomik, përkrahja e bizneseve dhe bujqësisë, promovimi i turizmit dhe planifikimi i qëndrueshëm urban.

Kjo kornizë paraqet bazën mbi të cilën do të ndërtohet buxheti i Komunës së Podujevës për vitin 2027 dhe planifikimet për 2028 dhe 2029 me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore dhe realizimit të projekteve me interes për qytetarët. Atëherë sipas Qarkores së parë buxhetore planifikimi i buxhetit për vitin 2027 është 35,849,048.00€, ndërsa për projeksioni 2028 është 37,425,150.00€ si dhe projeksioni për vitin 2029 është planifikuar 39,444,425.00€.

KAB sipas limitit të parë buxhetor, kemi grandin e përgjithshëm, grandin e arsimit, grandin e shëndetësisë primare, kemi grandin në Teatër, grande për shërbimet rezidenciale dhe kemi të hyrat vetanake.

Sa i përket investimeve kapitale vlen të theksohet se në bazë të planifikimeve në KAB kemi planifikuar 9.5 milion euro, ndërsa për vitin 2028 10.5 milion euro, ndërsa për 2029 12.6 milion euro. Këto investime do të mundësojnë realizimin e projekteve prioritare në infrastrukturë, arsim, shëndetësi dhe sektorë të tjerë me rëndësi për zhvillimin e Komunës së Podujevës. Po ashtu i kemi dhënë prioritet të veçantë sektorit të arsimit dhe mbetet një nga prioritetet kryesore me synimin për shtrirjen graduale të mësimit gjithë ditor.

Përveç grandit specifik të arsimit të ndarë nga niveli qendror, arsimi është mbështetur edhe nga grand i përgjithshëm me mbi 5 milion euro, për përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së arsimit.

Kjo dëshmon edhe njëherë përkushtimin tonë për përmirësimin e cilësisë së arsimit, krijimin e kushteve për mësim gjithë ditor dhe realizimin e investimeve të nevojshme në infrastrukturë arsimore.

Po ashtu i është dhënë edhe prioritet shëndetësisë, dhe në këtë edhe përveç grandit specifik për shëndetësi kemi bërë një përkrahje edhe nga grand i përgjithshëm në këtë mënyrë duke përmirësuar në vazhdueshëm shërbimet shëndetësore.

Në dokumentin e prezantuar para jush gjeni në detaj të gjitha projektet bazuar në kufjtë e parë të Qarkores buxhetore 2027-2029. Për fund dua t'i cekë edhe disa përmirësime të cilat edhe në mbledhjene KPF-së i kemi cekur dhe ju janë përcjellë me konstatime, do të thotë janë gabimet teknike, dhe atë në faqen 9 duhet të zëvendësohet vlera e cekur sikurse në KPF, pra vlera tek të hyrat vetanake 2,280,518 duhet të zëvendësohet vlerën 2,483,340 si dhe vlera 33,568,530 € të zëvendësohet me vlerën 33,365,708 €, do të thotë këto ndryshime duhet të bëhen në faqet 9, 25 dhe 26.

Po ashtu te numri i stafit për çerdhe apo arsimit parafillor duhet të shtohet numri për 10 persona për shkak që në vitin e ardhshëm planifikojmë që t'i hapim 8 çerdhe dhe atë te pishat, në Dobërdolë, Batllavë, Shtedim, Lupç, Llaushë, Obrançë dhe Llapashticë e Epërme. Kostoja totale vjetore e 10 edukatorëve është 81,840.00€. Pres komentet e juaja dhe pres aprovimin nga ana juaj për të vazhduar tutje.

z.Valdet Kamerolli, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore është një prej dokumenteve më të rëndësishme që ne diskutojmë dhe votojmë në Kuvendin Komunal, e ne sot para vetes si dokument e kemi Kornizën Afatmesme Buxhetore i cili gërsheton vizionin dhe projeksionet për vitet 2027, 2028 dhe 2029 për punët dhe projektet që e presin Komunën tonë gjatë këtyre viteve. Ky dokument na dëshmon se Komuna e Podujevës po ecë në drejtimin e duhur duke filluar nga rritja e buxhetit komunal, pra rritja e buxhetit prej mbi 1 milion euro për vitin 2027 krahasuar me vitin 2026 nuk është rastësi por është një rezultat i qeverisjes së mirë, të përgjegjshme, planifikimit të mirë financiar, të punës së vazhdueshme për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe kulturor të Komunës sonë nga Ekzekutivi dhe administrata komunale.

Një nga rritjet më të rëndësishme që ka ndikuar drejtpërdrejt në këtë rritje është performanca e shkëlqyer e arkëtimit të të hyrave nga tatimi në pronë, ku për disa vite me radhë Komuna e Podujevës ka tejkaluar parashikime e përcaktuara në Qarkoren Buxhetore për këtë kategori të hyrash, duke dëshmuar menaxhim efikas, rritje të besimit të qytetarëve dhe një administratë që punon me përgjegjësi, andaj pikërisht kjo performancë po reflektohet sot në buxhet më të madh dhe në më shumë investime për qytetarët.

Kjo KAB parasheh investime të rëndësishme në arsim, kulturë, sport dhe zhvillim ekonomik, fusha këto që për vite me radhë janë lënë në harresë dhe sot po trajtohen si prioritete të zhvillimit të Komunës tonë.

Investimet në këtë sektor janë investime në të ardhmen e fëmijëve, të rinjve dhe sportistëve, artistëve, të biznesit dhe të vendit. Gjatë degjimeve buxhetore kur të mbahen do të ketë mundësi përfshirjen e disa projekteve konkrete për qytet dhe fshatra, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së mjedisit, krijimit të hapësirave rekreative për ndërtimin e përmirësimin e infrastrukturës sportive, dhe besoj se këto projekte që janë të paraqitura i përgjigjen drejtpërdrejt nevojave të qytetarëve dhe duhet të jenë pjesë e investimeve të viteve në vijim. Podujeva sot ka buxhet më të madh, më shumë investime dhe një vizion të qartë për zhvillim dhe ky është rezultati i qeverisjes që punon, planifikon dhe i kthen të hyrat e qetarëve në projekte konkrete për çdo lagje dhe fshat të Komunës tonë. Andaj sot me kënaqësi do të votoj për Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe njëkohësisht ftoj edhe kolegë tjerë të votojnë për.

z.Besim Latifi, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore nuk është një dokument formal që miratohet vetëm sa për të përmbushur një procedurë, përkundrazi është dokumenti bazë mbi të cilin ndërtohet buxheti i vitit 2027 dhe projeksionet për vitet 2028 dhe 2029. Pikërisht për këtë arsye ky dokument do të duhej të ishte hartuar me analizë të mirëfilltë, planifikim të saktë dhe transparencë të plotë.

Siç dihet, Ministria e Financave ka nxjerrë Qarkoren e parë buxhetore me të cilën janë përcaktuar kufijtë fillestar buxhetor për komunat e më pas do të pasojë edhe Qarkorja e dytë e madje nëse është e nevojshme edhe e treta ku përcaktohen kufijtë final sipas kategorive ekonomike në këtë periudhë. Komuna ka qenë e obliguar të zhvillojë konsultimet e brendshme mes Drejtorive si dhe konsultimet publike me qytetarët në mënyrë që nevojat e tyre të përfshihen në planifikimin buxhetor, mirëpo fatkeqësisht jemi dëshmitarë se qytetarët nuk ju përgjigjën dhe në masë të madhe i bojkotuan këto dëgjime publike të organizuara nga Komuna dhe për këtë jam edhe vetë dëshmitar. Ky bojkotim i qytetarëve nuk ndodhi rastësisht, ata nuk morën pjesë sepse për vite me radhë kërkesat e tyre janë injoruar, kur qytetarët e humbin besimin se zëri i tyre dëgjohej, ata nuk shohin më arsye për me marrë pjesë në dëgjime publike, për më tepër, nuk janë respektuar as kriteret minimale të përcaktuara me udhëzimin administrativ për konsultimet publike.

Pikërisht për këtë arsye, Grupi i këshilltarëve të LDK-së organizoi dëgjime publike me qytetarët ku qytetarë nga i gjithë Llapi i'u përgjigjën thirrjes sonë dhe paraqitën kërkesat e tyre tek ne si kuvendarë, andaj sot nuk po flas vetëm në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së por po flas edhe në emër të atyre qytetarëve që kanë parashtruar kërkesa tek ne dhe kërkoj që kërkesat e tyre të përfshihen në KAB dhe më pas në buxhetin e vitit 2027.

Ne si grup e kemi analizuar këtë KAB dhe kemi ardhë në përfundim se kjo Kornizë ka mangësi serioze pothuajse në secilën kategori ekonomike, ajo që bie në sy më së shumti është mungesa e transparencës, mungesa e analizës në planifikim dhe mungesa e llogaridhënies. Së pari po ndalem tek mallat dhe shërbimet, pothuajse i gjithë buxheti për mallra dhe shërbime është centralizuar në Drejtorinë e Administratës, por kjo është në kundërshtim me vetë logjikën e KAB-it, pra çdo Drejtori përfshirë Zyrën e Kryetarit, Zyrën e Kuvendit duhet ta ketë buxhetin për mallra dhe shërbime sipas nevojave reale që ka.

Është absurde që Zyra e Kryetarit të varet nga miratimi i Drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës për furnizime, pra t'ia miratuar kërkesën Kryetarit të Komunës një drejtor ose drejtoresh e Drejtorisë së Administratës. Pastaj buxheti nuk duhet të planifikohet me centralizim dhe me shuma paushallë, pra planifikimi bëhet mbi bazën e analizave dhe nevojave konkrete reale. Në këtë Kuvend ne kemi miratuar Planin e punës dhe kemi votuar që buxheti për mallra dhe shërbime të Kuvendit të rritet, kurse unë pashë që përsëri është i njëjtë, përsëri kemi 20.000.00 € për Kuvendin, kjo është e papranueshme, organi më i lartë i Komunës së Podujevës që është Kuvendi i Komunës t'i ketë vetëm 20.000.00€ për mallra dhe shërbime, madje është një vendim i Kuvendit andaj ju lutem që të paktën vendimet e nxjerra nga Kuvendit t'i zbatoni. Po ashtu është e paarsyeshme që domethënë edhe Drejtoritë të tjera përfshirë edhe shërbimin e zjarrfikësve të mbeten pa buxhet për mallra dhe shërbime.

Mandej kemi shpenzimet komunale e që edhe këtu mungon analiza, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit figurojnë zero euro te shpenzimet komunale, ndërsa në Drejtorinë e Administratës janë planifikuar 400,000.00€, si është e mundur kjo, prej nga do ta paguani energjinë për ndriçimin publik në Podujevë. Pra ne jemi dëshmitarë se gjatë gjithë pjesës së dytë të vitit të kaluar ndriçimi publik në Podujevë ka qenë jashtë funksionit në shumë zona dhe fshatra, pse po ndodh kjo, sepse nuk po planifikohen mjete të mjaftueshme për pagesën e energjisë elektrike në kategorinë ekonomike adekuate, prandaj po kemi dhe papërgjegjësi. Prandaj e them se çdo Drejtori duhet t'i planifikojë shpenzimet e veta, e jo të krijohen fonde të centralizuara pa asnjë arsyetim dhe në kundërshtim me vetë logjikën e KAB.

Çështja tjetër, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, por ka edhe Drejtori tjera këtu që kanë planifikuar 90,000.00€ për Hartën Zonale, por për cilën Hartë Zonale, një Hartë Zonale që është miratuar para dy ose tri viteve, e që sa e di unë ka ende afat ajo Hartë Zonale, a ka ndonjë revidim apo çka është çështja këtu sepse nuk kemi informata. Po ashtu janë planifikuar 50,000.00€ për Plane të hollësishme rregulluese urbane dhe përsëri për këtë nuk e kemi këtu një njoftim për cilat zona do të bëhen këto plane rregulluese urbane edhe cilat zona kanë plane të tilla dhe në cilat zona nuk kanë.

Te shërbimet publike po ashtu i shohim 80,000.00€ të planifikuara për rregullimin e semaforëve, cilët semafor, apo janë ata semaforët ekzistues te kryqëzimi prapa stadiumit të qytetit të cilët prej që keni ardh në pushtet nuk janë funksional, asnjë ditë nuk janë funksional, kurse ju kanë dashur 6 vite ta konstatojnë se a janë mirë apo keq. Pastaj njësoj edhe me sinjalizimin horizontal edhe vertikal çdo vit ndahen shuma të mëdha dhe askund nuk specifikohet cila rrugë, cili segment rrugor, pa kurrfarë adrese. Kjo është mungesë e plotë transparence tek përshkrimi i projekteve prioritare për vitin 2027.

Edhe te kapitalet, në urbanizëm ndahen 250,000.00€ ku thuhet për riasfaltimin dhe rikonstruktimin me infrastrukturë, shtrohet pyetja ku, në cilën rrugë, njësoj e kemi edhe shumën 300,000.00€ për asfaltim rrugët e qytetit, as këtu nuk specifikohet askund, ama duhet kuptuar që KAB nuk është free-balanc ku janë karakteret e caktuara dhe s'mund të shkruash më shumë, pra është dokument word dhe shkruhet ashtu siç janë shkruar disa projekte që janë specifikuar mjaft mirë. Do të thotë 90% e projekteve janë të paspecifikuara, ndërsa disa projekte janë të specifikuar saktësisht ashtu qysh duhet të jenë të specifikuar në KAB. Unë pashë që në fshatin Dobratin janë të planifikuar 30,000.00€ për rrugë por që nuk specifikohet askund cilat rrugë, andaj kështu është pothuajse për secilin fshat.

Ajo që më ra në sy ishte edhe projekti në vlerë 500,000.00€ për rregullimin e rrugëve të asfaltuara pra thuhet rrugëve të asfaltuara, nga rruga “Zahir Pajaziti” te rruga “Skënderbeu dhe “Xhemajl Mustafa”, pyetja është cilat janë aty rrugë sepse një rrugë është lidhëse në mes rr.”Zahir Pajaziti” dhe rr.”Zahir Pajaziti” që është rr.”Vëllezërit Frashëri”, rrugët tjera të gjitha përfundojnë, vie nga rr.”Skënderbeu” dhe përfundon te Lumi Llap, ose prej rr.”Zahir Pajaziti” te Lumi Llap, pra janë rrugë anësore, mirëpo rrugë lidhëse nuk ka, andaj e them se kjo është skandaloze si planifikim i tillë.

Te shëndetësia planifikohen pajisje mjekësore për QKMF-në, por edhe këtu nuk specifikohet çfarë pajisje, nuk ka asnjë analizë, asnjë çmimore, do të thotë planifikohen ambulanca kur nuk e dimë edhe sa ambulanca nevojiten, mirëpo për çdo vit planifikohet nga një ambulancë, shtrohet pyetja, sa ambulanca ka QKMF dhe sa ambulanca nevojiten për t'i mbuluar të gjitha nevojat e QKMF-së.

Tek arsimi planifikohen 300,000.00€, thuhet për renovimin e institucioneve arsimore, dhe as këtu asnjë transparencë, as cila shkollë, as çarë do të rinovohet, asnjë listë prioritare, asgjë hiç, dhe përsëri planifikim për tabelat dixhitale ndonëse pak më parë bëmë një ridestinin nga ai projekt, sigurisht e keni vlerësuar që nuk nevojiten, kurse tani në pjesën tjetër po nevojiten sërish në vitin 2027. Madje edhe emërtimet qysh i pashë në këtë KAB siç është ndërtimi i kuzhinës, qendrës së kompetencës, ndërtimi i sallave sportive, do të thotë edhe sall sportive dhe objekte të cilat janë në përfundim, përsëri emërtohen si ndërtim dhe si projekte të reja, jo si vazhdimi i tyre.

Të nderuar, në Komunën e Podujevës çdo rrugicë, çdo rrugë, çdo institucion vartës i Komunës ka emërtim, prandaj nuk ka arsye që projektet të shkruhen në mënyrë të përgjithshme. Kjo mënyrë e planifikimit, unë jam i bindur që nuk është rastësi, andaj edhe po e cek, ajo krijon hapësirë që më vonë projektet të orientohen aty ku po dëshiron pushteti, sipas interesave politike dhe jo sipas prioriteteve të qytetarëve, por duhet kuptuar se që buxheti është i qytetarëve, jo i pushtetarëve. Prandaj kërkojmë që kjo KAB të plotësohet me një analizë të mirëfilltë duke i marrë parasysh edhe vërejtje të cilat i ceka, qoftë për emërtime të qarta, qoftë për planifikim real të shpenzimeve nëpër Drejtori dhe duke pasur transparencë të plotë, sepse vetëm kështu qytetarët do ta dinë se ku do të investohen paratë e tyre dhe vetëm kështu ky Kuvend mund ta kryejë detyrën e tij në mbikëqyrjen e Ekzekutivit.

Në fund dua të përmend edhe disa kërkesa konkrete të qytetarëve të cilat janë adresuar te Grupi i këshilltarëve të LDK-së dhe kërkoj që ato të merren për bazë dhe të përfshihen në KAB, e që nëse këto kërkesa dhe vërejtjet tona merren parasysh, ne do ta mbështesim këtë dokument.

Po fillojmë me kërkesat e qytetarëve. Në fshatin Lladoc kërkohet ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik te rrugët “Isa Softolli” dhe “Toplica”. Në fshatin Llaushë kërkohet ndërtimi i parkingut te shkolla “Kadri Kadriu”, trotuari rreth shkollës deri tek rruga “Mus Kallaji”, ndriçimi publik në këtë rrugë “Mus Kallaji” deri tek rruga “Haxhi Avdyli” si dhe ndriçimi i rrugës “Maliq Zymeri” që lidh fshatin Llaushë me fshatin Bajçinë. Gjithashtu banorët u ankuan edhe për investime selektive gjatë degjimit që e kemi parë, do të thotë është ardh deri te kjo shtëpi është ndërprerë, është vazhduar te tjetra e kështu me radhë.

Në fshatin Llapashticë kërkohet asfaltimi i rrugës “Gumurishta”, kërkesë e përsëritur që disa herë. Mandej në fshatin Dobratin kërkohet ndërtimi i trotuarit në rrugën “Islam Rekalu” që lidh lagjet “Rekalu” dhe “Ahmeti” me qendrën e fshatit. Trotuari nga lagja “Dervisholl deri te lagja “Pronovit” në rrugën “Çeshmja” si dhe trotuari nga lagja “Dervisholli” deri te lagja tjetër “Bajgort” në rrugën “Imer Dervisholl” deri te rruga “Mehë Uka” si dhe vazhdimi trotuarit në rrugën kryesore në fillim të fshatit.

Në fshatin Lluga kërkohet asfaltimi i rrugës “Ali Sfarça”, pra banorët janë ankuar që është anashkaluar kjo rrugë që disa herë me motive politike, kjo ishte kërkesa dhe ankesa e tyre. Në qytet banorët e lagjes “Brecalia” po kërkojnë që të intervenohet në rrjetin e ujësjellësit për shkak se gjatë muajve të verës atje nuk ka ujë dhe është e pamundur të qëndrohet, do të thotë s'ka ujë edhe është telashe e madhe. Ne e dimë që këtu shpeshherë po diskutohet çështja e kompetencave në investime kapitale për shtrirje të rrjetit të ujësjellësit edhe zgjerim të rrjetit të ujësjellësit është kompetencë e Komunës, kemi Ligjin për vetëqeverisje lokale i cili e specifikon qartë. Te çështja e furnizimit dhe reduktimet mund të ketë diskutime që është kompetenca e Kompanisë së Ujësjellësit, mirëpo gjatë asaj kohe sa ka ujë duhet me qenë normal me shtypje adekuate, do të thotë krejt pjesa e qytetit mbi hekurudhë e kanë këtë problem.

Një kërkesë tjetër është nga banorët e fshatit Dyz të cilët kërkojnë shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në këtë fshat i cili aktualisht furnizohet vetëm me puse të cilat gjatë muajve të verës po kanë vështirësi dhe përsëri po kanë probleme edhe me sasi dhe me cilësi. Po ashtu banorët e këtij fshati kanë një kërkesë për asfaltimin e rrugës “Hamdi Uka” nga faza e fundit si dhe ndriçimin publik në këtë rrugë për shkak se aty ishte një qendër e Paint-Ball dhe kishte vizitor të shumtë në këtë fshat, si dhe po ashtu kërkohet ndërtimi i tretarit në rrugën “Jetullah Islami” si dhe asfaltimi i rrugës nga lagja “Uka” që lidhet me fshatra dhe lagje të tjera të fshatit Dyz.

Pra këto janë vetëm disa nga kërkesat e qytetarëve, nëse kemi zotimin tuaj si pushtet që këto kërkesa do të merren për bazë dhe do të përfshihen nën KAB si dhe kërkesa të tjera që do t'i adresojnë këshilltarë të tjerë në formë individuale, atëherë Grupi jonë i LDK-së do ta mbështesë këtë dokument, në të kundërtën nëse kërkesat e qytetarëve nuk merren për bazë si dhe vërejtjet që i dhamë sot, atëherë sigurisht do të detyrohemi të mos e mbështesim

z. Ermal Osmani, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës për vitet 2027-2029, më shumë e pashë e nderuar drejtoreshë si copy past tabelat. Pse po them kështu copy past, sepse pashë sa i përket fshatit Gllamnik vitin 2028 e keni planifikuar aneksin shkollor së Gllamnikut dhe pasi që unë jam prej këtij fshati dhe e njohë mirë gjendjen faktike dhe nevojat e nxënësve të fshatit tonë, atje nuk ka nevojë për aneks, por ka nevojë për objekt shkollor, sepse e dimë se objekti shkollor i fshatit Gllamnik është ndërtuar vitet e 80-ta dhe është në gjendje të mjerueshme. Mund të shkojmë ta shikojmë e që e dinë edhe kolegu z. Haki Rudari i cili ka punuar në atë shkollë. Po ashtu e dimë se shkolla e fshatit Gllamnik e ka numrin më të madh të nxënësve në Komunën e Podujevës në krahasim me fshatra, jo me qytet.

Pastaj pash edhe te Drejtoria e Shërbimeve Publike të cilën e udhëheqë z. Bahri Selimi, është rrjeti i kanalizimit në Gllamnik që e ka premtuar kur është ndërtuar ura te rruga “Ulpiana 41”, qysh kanë mbetur gypat e kanalizimit, ndoshta po e dini bash sak ku, dhe janë më se dy vite që kundërmon erë shumë e

tmerrshme, prandaj aty banorët kanë ankesa të shumta për atë pjesë, si dhe se qysh ka mbet gypi në atë gjendje kur i'u keni thënë gjithëve do të kryhet do të kryhet jo në këtë vit jo në atë vit, ndërsa ende nuk e keni kryer asgjë të mirë, andaj veproni sepse është në gjendje të mjerueshme.

Pashë edhe që keni planifikuar sistemin e ujitjes në bujqësi, sikurse atë sistemin e ujitjes, është mirë të na tregoni qysh e keni planifikuar, ndoshta jo si të Lupçit që të bëjnë hajgare krejt Kosova me neve, marre ajo punë ashtu Kryetar, bile për mendimin tim është turp sepse kanë bërë hajgare krejt dhe janë marrë me Llapin, kur e dim se Llapi ka dhënë shumë, ju i nderuar Kryetar e keni dhënë versionin e juaj lidhur me këtë çështje, por nuk po kanë dhe nuk po lëshohet ujë aty, janë prishur ato dërrasta slovenka, andaj për atë arsye unë po ju them se është mirë të na merrni për bazë neve sepse i kemi formuar dhe ndërtuar dy penda në Metehi dhe dy në Dobërdol, dhe ti i nderuar Kryetar e din se reliefi e zonës së Llapit, ka një relief gjeografik shumë të mirë dhe mundet edhe nëpërmes pendave në Bajçinë dhe fshatrave andej të ujitën, pra mund të ngritën disa penda edhe nuk kushtojnë shtrenjtë edhe janë të mjaftueshme për qytetarët edhe ju konvenojmë edhe unë e mendoj se diçka nëse bëhen këto për të mirën e qytetarëve dhe u hyjnë në plan qytetarëve unë si asamblesë i LDK-së e përkrahi këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë i kam dy-tre çështje dhe nuk dua ta zgjati shumë sepse i përmendën edhe kolegët. E para është te ndërtimi i Tregut të kafshëve i cili u përmend më herët si premtim i Kryetarit, madje shkova deri atje dhe i shtypa postimet e Kryetarit në Facebook se qysh do të duket Tregu i kafshëve, ky është do të thotë (prezanton fotot) në vitin 2021 e që në atë postim thuhet se në mandatin e plotë Tregu i kafshëve do të marr pamje krejt tjetër me rend dhe me rregull, e që atëherë ka qenë goxha i mirë dhe shumë i hijshëm, në fakt e di që njëherë janë ndarë 50,000.00€ dhe është heqë disa bërlllog aty dhe është rregulluar pak, përndryshe nuk është rregulluar asgjë deri tani, ndërsa keni paraparë tani 100,000.00€ e që me këtë shumë nuk e di çka doni të bëni, do të thotë në vitin 2027 janë 100,000.00€ kurse në vitet 2028 dhe 2029 zero euro.

E dyta, ishte projektet ndërtimi i terreneve sportive, në vitin 2027 janë 250,000.00€, në vitin 2028 janë 100,000.00€ dhe në vitin 2029 janë 200,000.00€, që i bie 550,000.00€ në total për këto tri vite, mendoj që ndoshta ka qenë më mirë të mirëmbahen këto që janë sepse ne e dimë sidomos nga rrethi jonë andej janë ndërtuar terrenet por nuk janë që shfrytëzohen sepse nuk janë rregulluar ashtu qysh duhet, në Siboc është në mes të fshatrave Siboc, Kaçybeg dhe Lluga një lloj terreni ku nja dy-tre fëmijë po luajnë ngapak, por nuk është terren i përshtatshëm sepse është me do bari sintetik që e kanë marrë prej Stadiumit të Llapit, është shumë i keq.

E treta, këtu paksa kam punë me drejtorin z.Bahri Selimi i cili është në dijeni prej që jemi këtu sepse shtëpinë e kam afër Lumit Dumnica, por që për këtë çështjen e lumenjve keni ndarë shumë pak buxhet, këtë e them sepse hyra në tek projektet e qeverisë edhe Kuvendit që e ka votuar e pashë që nuk janë ato 8 milion që i ka përmend drejtori i cekur në procesverbalin e 31 marsit 2026, mund të hysh edhe ti drejtor të shikosh çka ke thënë, pra ke thënë 8 milion euro janë të parapara për rregullimin e lumenjve, kurse saktësisht sipas asaj që unë munda të nxjerrë i ke ndarë 3,800,000.00 € pse ti kanë ndalë komplet tjerat unë nuk e di, mirëpo e ke përmend 8 milion euro kurse tani në total edhe të Komunës edhe të Qeverisë janë diku rreth 3,800,000.00€, nuk e di përse janë zvogëluar, kurse ti drejtor dy-tri herë ke thënë se i keni rreth 8-9 milion euro për këtë çështje, nuk i di arsyet, ti mund t'i dish.

Gjithashtu te puna e këtyre projekteve, 69 projekte i keni nën 35,000.00€. Ne nëse ankojmë që edhe është shtrenjtuar nafta dhe bizneset po kanë problem t'i kryejnë punët, atëherë çfarë mund të bëhet me këtë shumë tani. Pastaj edhe te emërtimet, është mirë me hy me i shikuar procesverbalet vetë asambleistët e LVV-së, edhe pse prej vitit 2015 e këndej rrugët janë me emërtim dhe keni qenë goxha të zëshëm në atë kohë që t'ju vëhen emrat e rrugëve ku do të investohet, shembull tani janë të ndara 20,000.00€ për Soboc, mirëpo ne jemi dy fshatra aty, Siboc i Poshtëm dhe Siboc i Epërm, kurse as nuk tregohet ku do të shkojnë dhe për çka ato 20,000.00€, nuk po them as që t'i sjellni te shtëpia ime sepse nuk më duhen asgjë, por

vetëm me dit çka ka prioritet dhe t'i vëhet emri që shembull NN rruga do të shtrohet, NN rruga te varrezat sepse janë dy-tri vende të varrezave e që Kryetari i Komunës e din këtë, madje i'u ka premtuar njerëzve atje aë do ta shtroj kurse ende nuk e ka shtruar, për atë rrugë është fjala e që aty bëjnë pjesë edhe varrezat e familjeve Rrahmani dhe Haliti, pra ta dim a është ajo rrugë për atje, a është për ndriçim apo për çka është. Prandaj pres përgjigjen prej drejtorit z.Bahri Selimi për punën e lumenjve, por edhe prej Kryetarit për punën e Tregut të kafshëve.

z.Isak Ejupi, theksoi, kam qenë njëri prej anëtarëve të asamblesë komunale në Podujevë që e kemi pritur diskutimin publik me qytetarë rreth fshatit ku jetoj, dhe njëri prej banorëve të fshatit edhe pse unë e kam mbajtur një takim me banorët e fshatit Sekiraçë, ka qenë edhe aty prezent dhe e ka parashtruar si kërkesë një premtim të mëhershëm të Kryetarit që e ka dhënë, por që nuk është realizuar, ndërkohë që ajo mbetet prioritet nga kërkesat e banorëve të fshatit Sekiraçë. Bëhet fjalë për zgjerimin e rrugës nga rruga kryesore deri te shkolla. Ajo rrugë përveç që është e ngushtë, nuk ka as trotuar edhe rrjedhimisht tash familjarët po i bartin fëmijët deri te shkolla me vetura edhe atje mund t'iu rrezikohet jeta e fëmijëve.

Ne kemi pasur problem me pronësi sa i përket asaj rruge, mirëpo tash së fundmi kemi bërë kompromis me banorët dhe kemi gjete zgjidhjen. Të dy pronarët nga dy anët e rrugës kanë pranuar që ta lirojnë hapësirën e nevojshme për zgjerimin e asaj rruge dhe për vendosjen e trotuareve.

Gjithashtu shkolla në Sekiraçë nuk ka fushë sportive dhe hapësirë e nevojshme për ndërtimin e fushës sportive e kemi gjet, do të thotë e kemi banorët ne banorët dhe presim që në këtë projektbuxhet për vitin 2027 të futen edhe këto tre projekte.

Në ndërkohë kemi identifikuar që kanalizimi nga rr.“Jusuf Fejza” dhe rr.”Mehmet Ejupi” është bllokuar në masë të madhe dhe shumë shpejt do të ketë nevojë të ndërhyhet për tu riparuar. Ju e dini që infrastruktura kritike e fshatit Sekiraçë, duke përfshirë edhe shkollën, kanalizimin, ujësjellësin, rrugën, dhe të gjitha i ka kryer me vetë iniciativë dhe vetë kontribut, pa ndihmën e pushtetit, andaj tani është njerëzore dhe sinqerisht është momenti i duhur që Komuna të ndërhyjë atje dhe t'i përfundojë këto projekte ekzistuese që janë, por që kanë nevojë të riparohen.

z.Enis Dervisholli, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore është dokumentet më i rëndësishëm para buxhetit dhe këtë e keni bërë keq i nderuar Kryetar. Nëpër takime ka pas pak qytetarë dhe kanë qenë pak takime dhe nuk i kemi procesverbalet e atyre takimeve. Në subvencionet në bujqësi i keni paraparë 900,000.00€, në shëndetësi keni paraparë 250,000.00€ dhe u ndala pak te këto dy pika ku në shëndetësi e keni zvogëluar buxhetin numrin e personave me aftësi të kufizuara. Unë e kam nxjerrë një dokument të vitit 2018 ku 14,556.00 € i ka pasë Handikos më parë, kurse ti Kryetar e ke sjellë në 5,000€. Nuk po e di a është më dinjitoze shuma prej 14,556.00€, apo kjo tani prej 5,000.00€, andaj është mirë të kërkoj falje qytetarëve për këto gjëra që e potencove në debatin para kësaj mbledhje kur the që 5,000.00€ është dinjitoze, t'ju kërkon falje sepse ka qenë 14,556.00€ sipas vendimit të vitit 2018.

Në bujqësi veç jepni para në subvencione pa ja ditur asnjë pikë efektet e atyre parave, andaj për këtë arsye kam kërkuar të krijohet një Zyrë për këshillimin e fermerëve e që është edhe obligim ligjor.

Për vitin 2027 keni thënë që do të ndërtojmë një Shtëpi për persona me aftësi të kufizuara, a mund ta dimë e nderuar drejtoresh sa do të kushtoj ky projekt, ku do të ndërtohet, qysh do të funksionoj dhe kush do ta mbikëqyrë këtë projekt. Ju përgëzoj për këtë vendim dhe dashtë Zoti e realizohet sa më shpejt sepse është projekt dhe vendim i mirë.

Po ju bëj thirrje sinqerisht dhe po lus me shpirt që nga tani deri në muajin shtator kur të vije buxheti për miratim të ndani më shumë mjete buxhetore për fëmijët me autizëm dhe me nevoja të veçanta, e kërkoj këtë sepse deri tani më shumë keni ndarë mjete për qentë endacak se sa për fëmijët me autizëm, e them këtë sepse 1.000€ i keni dhënë për fëmijët me autizëm, janë 31 fëmijë dhe i bie 32€ i nderuar Kryetar i ke dhënë për një fëmijë me autizëm, do të thotë 2.60 €, pra më shumë kanë vlerë qentë endacak se sa fëmijët

me autizëm dhe me nevoja të veçanta. Prandaj i nderuar Kryetar i Komunës, nëse nuk ndërmerr diçka unë do të kundërshtoj edhe në mënyra tjera, jam i bindur se nuk e lë me kaq, andaj është mirë me u marrë me këtë çështje dhe ta kryeni i nderuar Kryetar, mund ta merreni këtë edhe si kërcënim ju, por më mirë është të merremi me këto tema dhe me fëmijët me autizëm sesa të diskutohet 1 orë për qentë endacak e për mua është turp zotëri Kryetar sepse e përsërisë që 1.000 € i ke dhënë për 31 fëmijë, nuk ka kurrfarë logjike.

Po i nderuar Kryetar edhe ti ke qenë para viteve 2021 e para 2020 ke qenë pjesë e kësaj Komune, nuk kemi qenë ne, dhe edhe ato të mira janë bërë edhe kur ke qenë, por edhe ato të këqija që janë bërë, pjesë e asaj ke qenë edhe ti, ti ke qenë jo ne, por ne vetëm ju kemi bërë “argatin” duke vrapuar për juve por që kishim pas qenë gabim në atë kohë që kemi vrapuar pas juve dhe s'kishim pas dit.

z.Arben Xhemajli, theksoi, dua të bëj një kërkesë për shtimin në KAB të disa kërkesave në lagjet përreth Kërpimehut, do të thotë rruga “Buzë Llapit” të bëhet ndriçimi, trotuari, zgjerimi i urës dhe sanimi i gropave, anësore mbrojtëse në rrugën “Gjon Kastrioti”. Po ashtu edhe rruga Dobërdol-Kërpimeh rr.“Buzë Llapit”, asfaltim i rrugës lidhëse ndërmjet Kërpimehut dhe Dobërdolit, mandej në fshatin Metehi sanim i gropave, ndriçim i trotuareve, rr.”Arianët” 110 metra asfaltim, rruga Metehi-Kërpimeh “Ruga e fushave” rrugë lidhëse që lidh dy fshatrat. Mandej në Kërpimeh rruga që lidh dy fshatrat, trotuar, asfaltim dhe ndriçim, dhe sërish në Kërpimeh lokacioni i përmendur rregullim i parkut. Gjithashtu Pakashticë-kërpimeh-Zakut-Dobërdol pastrimi i Lumit Llap, dhe në Kërpimeh dhe fshatrat përreth në të gjitha zonat trotuar dhe mirëmbajtje të trotuari dhe rr.”Gjon Kastrioti” anësore mbrojtëse. Në fshatin Metehi rruga te Lagja Uglart rr.”Arianët” në gjatësi 73 metra asfaltim.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, në radhë të parë unë ju falënderoj për krejt këto vërejtje dhe sugjerime që i bëtë sepse unë besoj që brenda këtyre vërejtjeve dhe sugjerimeve ka vend për përmirësime. Jemi duke e kaluar Kornizën Afatmesme Buxhetore dhe pastaj kemi fazën e projekt buxhetit për vitin 2027 që do të kemi mundësi të gjithë të involvohemi në atë. Ky buxhet nuk është i një subjekti politik, është buxhet i qytetarëve dhe gjithsecilit prej juve ju inkurajoj të bëheni pjesë e takimeve dhe debateve që do të zhvillohen me qytetarë, por jo vetëm ju, është mirë të kontribuoni që edhe qytetarët t'i sjellëni në takime sepse fundja prej tyre dalin ato më të mirat, kërkesat dhe nevojat e tyre të drejtpërdrejta. Unë ju preferoj që të mos e lëshojmë në projekte individuale këtë diskutim për KAB sepse ne do të hartojmë projekt buxhetin dhe aty ulemi dhe i diskutojmë.

Këto para nuk janë as të Ekzekutivit, aq më pak të miat si Kryetar i Komunës, por janë të qytetarëve dhe nëse mund t'i orientojmë në mënyrën më të mirë e do të ishte sukses për të gjithë ne, nëse ne këtë planifikim buxhetor për 2027 e bëjmë mirë, unë besoj që të gjithë do të ndahemi të kënaqur e më së shumti qytetarët e Podujevës, mirëpo ajo që duhet cekur është fakti që duhet t'i gëzohemi që kemi një buxhet në total diku mbi 35 milion euro që planifikohet të investohen 2027, më sakt 35,849,048.00€ e që brenda këtij buxheti ka mundësi të bëhen lëvizje.

Pajtohem deri në një masë që shumë prej këtyre definimeve janë të përgjithësuara, u përmendën disa prej tyre siç ishte çështja e ambulancave, (në fillim nuk i dëgjova të gjitha sepse më vonë u kyça) ta keni parasysh sa kilometra brenda një viti i bën një autoambulancë, prandaj edhe amortizimi i tyre është shumë i shpejtë, ne pothuajse për çdo vit deri tani kemi blerë nga një autoambulancë të re, plus një tjetër e kemi marrë donacion dhe atë ju e dini se kemi marrë donacion me vetëm 2500 € shpenzim komunal, do të thotë i kemi paguar vetëm shpenzimet e udhëtimit që e ka sjellë deri këtu automjetin, dhe prapë se prapë kohë pas kohe paraqiten probleme sa i përket autoambulancave, defekte të ndryshme, periudha paksa të gjata derisa të përmirësohen ato defekte dhe probleme që mund të jenë nëpër ato autoambulanca e të tjera.

Ishte edhe çështja tjetër që u cek sa i përket rikonstruimit të shkollave, ju e dini që një numër i madh i objekteve shkollore janë në gjendje jo të mirë dhe shpeshherë derisa vie koha për të investuar në atë shkollë mund të ndodhë që një shkollë tjetër të dëmtohet ende më shumë se sa ajo që mund të jetë e planifikuar, për ta definuar sakt se ku do të investohet. Pra janë punë riparimesh që asnjëherë nuk

mundesh saktësisht t'i planifikosh se ku do të paraqitet nevoja dhe kërkesa më e madhe për fillimin e vitit të ri shkollor që të mund të investohet, dhe për këtë arsye mendoj që janë gjërat jo mjaftueshëm për tu definuar ashtu siç po kërkohet.

U përmend një rrugë "Ali Sfarça", unë i asaj ane jam dhe e di që ajo rrugë është në asfalt, madje tash së fundmi e kemi bërë edhe ndriçimin publik në atë rrugë, pra rruga është e asfaltuar, nëse veç është fjala për atë rrugë "Te Sfarçët", përndryshe ajo rrugë është nuk ka rrugë tjetër në atë pjesë. Rruga e zotëri Abdullahut që e përmendet nuk quhet "Ali Sfarça", rruga kryesore që hyn në atë lagje të Sfarçve është rruga "Ali Sfarça", pra është edhe ndriçimi publik është edhe rruga e asfaltuar deri në fund të asaj pjese, madje i'u kemi premtuar që te oda e pritjes aty do t'iu ndihmojmë me rregullim me kubza, ndërsa nëse është fjala për zotëri Abdullahun, atje është vetëm shtëpia e tij, do të thotë në ara është vetëm një shtëpia e tij e ndërtuar.

Nuk e di a i keni parë ata drunj përkaj rrugës që janë tharë nga ana e tij krejt për rreth 2-3 kilometra, nuk e di a ju ka rastësisë t'i shihni, singerisht kjo është edhe për të qesh por është edhe shumë brengose, nëse në një segment dalin dhe dështojnë të gjitha komplet ata drunj, e që mund të dështojnë 1, 2 ose 3 s'është problem, në një segment komplet të rrugës të thahen drunjët, nuk di çfarë të them. Përndryshe ata drunjë nuk kanë sistem të ujitjes por megjithatë disa qytetarë i ujitin dhe kujdesen për t'i mirëmbajnë, prandaj dua të them që në projekte të përgjithshme kur është interesi i përgjithshëm është mirë të gjithë të kontribuojmë, por nëse nuk mund të kontribuojmë, të paktën të mos bëhen dëme, e keni parasysh këtë.

Lidhur me Ujësjellësin në fshatin Dyz, jemi në dijeni që ky fshat ka probleme, madje jo vetëm Dyzi por te shumica e vendbanimeve është një problematikë që gjatë kohërave është trashëguar. Ne jemi me një përqindje shumë të vogël të kyçur në sistem të ujësjellësit publik si Komunë e Podujevës, dhe kjo ndoshta është edhe arsyeja pse u insistua domosdoshmërisht të bëhet akumulacionin e ri në Pollatë. Ne po kemi problem me burimin sepse nuk kemi burim të mjaftueshëm për t'i bërë ato përmirësime, ne do ta shtyjmë përpara edhe këtë projektin e rehabilitimit për fshatin Gllamnik dhe fshatrat tjera përreth, por edhe për fshatrat Obrancë e Llapashticë e të tjera në atë pjesë për të cilat mbi 1 milion euro janë ndarë nga niveli qeveritar e të cilat i menaxhon KRU "Prishtina" sepse në këtë aspekt kjo Kompani i bënë investimet kapitale në sistemin e ujësjellësit, andaj shpresojmë të përmirësohet diçka situata, por nëse burimin e kemi jo të mjaftueshëm do të ketë probleme të vazhdueshme edhe nëse bëhet shtrirja e rrjetit të ujësjellësit siç është shembull edhe pjesa nga Dumnica që nuk po ka furnizim sepse po ka telashe edhe vetë qyteti i Podujevës, në veçanti gjatë stinës së verës.

U përmend edhe shkolla e fshatit Gllamnik, ajo shkollë nuk është në gjendje të mirë sepse është prej projekteve të para që është bërë dhe duhet menduar edhe për Gllamnikun ta ndërtojmë një objekt të ri shkollor, por e kemi fshatin Lluzhan edhe më keq, ju e dini që është ende shumë më i vjetër projekti i fshatit Lluzhan, prandaj po mundohemi që vit pas viti edhe me ndihmën e Ministrisë t'i fusim në funksion, ndërsa problemi i kanalizimit në atë pjesë duhet të zgjidhet, sepse kemi aktualisht kontratë të hapur dhe besoj se për probleme të tilla ku janë duhet marrë seriozisht me atë punë.

Çështja e Pendave që u përmenden, ju e dini që disa prej tyre jo që na kanë bërë dobi por na shkaktojnë probleme. Në fshatin Metehi kemi telashe prej qytetarëve atje dhe janë duke bërë presion qoftë në Metehi por edhe në Dobërdol për t'i hequr sepse janë duke i'u shkaktuar telashe atyre dhe nuk janë duke shfrytëzuar, tash ose nuk janë bërë mirë për t'u shfrytëzuar dhe tani qytetarët por po na bëjnë presion madje edhe ka peticione në Drejtorinë e Bujqësisë nga Dobërdoli që të shkojmë t'i rrënojmë ato penda sepse po i'u shkaktojnë probleme. Problemi është që ne e filluam këtë projektin prej 9 milion euro për ujitje të tokave bujqësore, Ministria e Bujqësisë ka ndarë një shumë simbolike këtë vit vetëm 100,000.00€ dhe nuk e di qysh do të mund ta fillojmë si projekt sepse është 9 milion totali, projektin e kemi hartuar dhe është i gatshëm. Na kanë premtuar që do ta financojnë dhe po shpresoj që do ta financojnë Ministria e

Bujqësisë, por ky është një projekt kapital që do të marrë kohë paksa për t'a mbuluar një pjesë të madhe të sipërfaqes së tokave të punueshme.

Te çështja e Tregut të kafshëve, vetëm shpresoj të kemi çfarë të dërgojmë atje për të shitur, e them këtë sepse ju po e shihni që në treg më nuk i dërgojnë asnjë kafshë, megjithatë ne e kemi premtuar atë dhe do ta realizojmë gjithsesi, në vitin e ardhshëm e kemi planifikuar një buxhet dhe besoj që do të gjendet edhe forma tjetër e kompensimit, por e rëndësishme është të kemi një pjesë të participimit të mjeteve që të mund të participojmë dhe besoj që qoftë me Ministrinë e Bujqësisë, qoftë me Ministri të tjera të linjave që mund të financojnë projekte të tilla, besoj që do ta realizojmë edhe atë projekt.

Projekti e Lupçit, është shumë e vërtetë që ai projekt “është kap për bishti” dhe u keqpërdor në masën më të madhe sepse ishte fushatë zgjedhore, por ju e dini të gjithë, në veçanti ata që keni lidhje me atë pjesë që ai projekt nuk është projekt i tashëm, por është projekt qindra vjeçar që e kanë shfrytëzuar qytetarët e Lupçit, krejt çfarë kemi bërë ne është që i'a kemi krijuar atë kanal për të lëvizë uji dhe ju e dini shumë mirë që është sqaruar shumë mirë në opinion, mirëpo kjo pjesa tjetër ishte shumë më e gatshme për të bërë fushatë me të. Përndryshe është prej projekteve shumë të rëndësishme dhe se e kanë mirëpritur qytetarët e Lupçit si projekt dhe unë e besoj që edhe menaxheri që e ka menaxhuar këtë projekt është nga ai lokalitet dhe i ka qëndruar afër atij projekti për t'u realizuar në mënyrën ashtu qysh ka qenë në planifikim, por ajo çështje tani le t'i mbetet kohës, mirëpo unë besoj që ai projekt i'u ka zgjidhur problem qytetarëve në momentet që ju duhet sepse ju e dini që ai lëshohet varësisht prej nevojave kur paraqiten për ujitje ngase nuk është projekt që gjithë kohën duhet të ketë qarkullim të ujit sepse pastaj i'u shkakton telashe qytetarëve, por shfrytëzohet në momentin kur i'u duhet qytetarëve në formën qysh është.

Te ndarjet buxhetore për rrugë të ndryshme, është fat i madh që në shumicën rasteve tani nuk ka më rrugë të gjata, me ndonjë përjashtim, por janë rrugë të shkurtra kryesisht që po kryhen gradualisht. Mirë do të ishte nëse është mundur të definohen të gjitha saktësisht me emra sepse do të ishte në interes i të gjithëve, por edhe një çështje duhet pasur parasysh, të gjithë ne po mundohemi në interes të qytetarëve.

U përmend nga njeri prej parafolësve edhe një rast atje te “Sllatinët”, por unë ju them se nuk ka të bëjë asgjë me atë që u tha, absolut nuk ka të bëjë politikë sepse është e vërtetë që kemi investuar në atë pjesë po edhe mund të ketë mbet ndonjë pjesë aty që të kryhet, qëllim politik nuk ka dhe kjo është shumë e rëndësishme edhe po ju garantoj që nuk ka qëllim politik, absolutisht, andaj nuk është mirë të politizohet sepse të paktën këto 5 vite ju kemi dhënë shumë shembuj që ne nuk i kemi politizuar këto gjëra, shikojeni projektet ku janë realizuar, do të thotë ka të LDK-së, ka të PDK-së e ka të VV-së, ka të të gjitha subjekteve politike që kanë përfituar sepse nuk i kemi ndarë projektet e qytetarëve në baza partiake.

Sa i përket kërkesave për te shkolla e Sekiraçes, po ka nevojë dhe aty dhe duhet të bëjmë shumë shpejt besoj atë trotuar në atë hapësirë e që besoj se kemi hapësirë me kontraktorin që e kemi, pra do ta rregullojmë çështjen e trotuarit.

Te fushat sportive, t'ju them të drejtën edhe unë pajtohem me juve që ne i kemi bërë, është e vërtetë disa fusha i keni bërë edhe ju më herët, por pothuajse asnjë nuk janë duke u shfrytëzuar siç duhet ngase nuk po ka kush i shfrytëzon ne po e shohim, më parë “i kemi thyer këmbët” nëpër baltë e nëpër livadhe kurse tani janë të gjitha por nuk ka njerëz, andaj edhe ndoshta është mirë të mendohet mirë që kur të investojmë të shohim mundësitë ndonjë pikë, ndonjë vend, ndonjë lokalitet që vërtetë është e nevojshme, por jo tani për çdo lokalitet të bëjmë fusha sportive. Ju e dini që është një fushë sportive në fshatin Bajçinë e që unë nuk e kam ditë as ku gjendet, mezi e kam gjet par disa ditëve sepse pothuajse gjendej sikur të jetë në oborr të ndokujt, ishte në vend të fshehur dhe nuk po u shfrytëzojke për asgjë, mirëpo paratë janë shpenzuar aty.

Pra janë një ose dy kërkesa aktualisht që mendohet ndoshta vitin e ardhshëm t'i realizojmë, një prej tyre fshati Orllan e ka një kërkesë të kamotshme, pastaj fshati Buricë e që dyshoj se do të shfrytëzohet si dhe disa rrethoja këtyre fushave që janë aktuale e që nuk është ndonjë investim i madh, por realisht unë mendoj që ndoshta më mirë është këto investime eventualisht t'i bartim nëpër oborre të shkollave aty ku

kemi nevojë në shkolla, e jo t'i lëmë si fusha të komunitetit sepse fundja ai komunitet edhe mund t'i shfrytëzon ato fusha nëpër oborre të shkollave.

U përmend edhe problemi i kanalizimit, ato çështje janë punë të përditshme me të cilat ne po merremi dhe kemi telashe jo të vogla në këtë aspekt,

Bujqësia është një prej prioriteteve që e kemi vë, ju e dini që për katër vite kemi pas mbi 2 milion euro subvencione dhe unë mendoj që duhet të vazhdohet të subvencionohen bujqit. Nëse kemi ekspert të mirë të cilët na ndihmojnë të gjejmë se ku duhet orientuar brenda përbrenda këtij sektori nuk ka telashe, janë të mirëseardhur, dhe se edhe kontributi i një asamblisti sikurse që jeni ju është shumë i mirëseardhur, me kënaqësi ju dëgjoj (i drejtohet Enis Dervishollit), ke ardhur në zyrën time dhe sërish mund të vish të më japësh ide, unë do t'i pranoj, madje po dal dhe po them që bashkë me Enisin i kemi bërë ose po ta autorësinë krejt ty, s'ka telashe, vetëm mi jap idet e mira sepse ne po kemi nevojë për ide, dhe ti e din që unë jam i hapur për këtë punë, nuk e kam telash vetëm ndihmomëni me ide më të mira se ku t'i orientojmë, vetëm a kemi ndonjë ide më të mirë se sa kjo që është, nuk ka telashe fare, ju e keni parë që kemi kaluar paksa edhe te shpezëtaria ku i'u kemi ndihmuar paksa në disa elemente që ndoshta asnjëherë se kanë pasuar, duhet t'i ndryshojmë ndoshta fushat ndër vite, këtë vit planifikojmë paksa me subvencionimin e qumështit edhe pse s'e di qysh do të na dalë sepse bujqit e marrin një subvencion edhe prej nivelit qendror, dhe tani në një farë forme sikur po dyfishohet ky subvencion, por provojmë dhe të shohim a po ka efekt pozitiv apo jo, nëse e shohim që nuk do të ketë efekt, në bujqësi sërish kemi hapësirë se ku t'i orientojmë këto subvencione.

Ndoshta nuk arrita t'i përmbledhë të gjitha ato që u potencuan nga parafolësit, mirëpo ajo që është shumë e rëndësishme, edhe njëherë dua të përsërisë është që jemi në fazën kur do të fillohet me hartimin e projekt buxhetit, është mirë të mos shprehim kërkesa individuale apo kërkesa të një subjektit politik sepse ne i kemi fituar zgjedhjet dhe programi i partisë fituese realizohet, kjo është normale, por kur janë interes i përgjithshëm për qytetarët nuk ka rëndësi, aty jemi bashkë, pavarësisht se në politikë jemi të ndryshëm.

Sa i përket çështjes tjetër që u cek rreth fëmijëve me autizëm, është hera e dytë që po e potencon asambleisti i nderuar, çështja është se i'u kemi ndihmuar kësaj kategorie një vit më herët dhe në këtë mund të na informoj edhe ish drejtoresha znj. Adelinë Stublla se a kanë qenë 9,000.00€ ose 10,000.00€, dhe po ashtu një vit para asaj kanë qenë 10,000.00€ ndihmë për këtë kategori. Ju thash edhe në mbledhjen e kaluar kur e ngritët këtë çështje dhe po e përsëris edhe njëherë se më mirë është t'i bëjmë mësuesit tanë dhe e fusim në sistem atë punë, punojnë me pagë personat e caktuar, por jo të thuhet shembull, po ju a heq 5 euro sepse mi ka dhënë Komuna 5 euro më shumë, pra nuk i'a ka dhënë Komuna 5 euro, por i'a ka dhënë 10,000.00€ për t'i menaxhuar

z.Enis Dervisholli, nga vendi ndërhyrës duke theksuar se për fëmijët me autizëm janë ndarë 1000€ kurse për Handikos janë ndarë 5000€, kjo është e ditur dhe se janë të, dhënat.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, vazhdoi, unë edhe në mbledhjen e kaluar e potencova që këtë vit janë ndarë më pak mjete buxhetore për këto kategori për arsye se nga 01 shtatori do të fillojmë me mësuesit tanë, dhe të mos vie puna aty deri aty që t'i thuhet qytetarit ose prindit të atyre fëmijëve unë po t'i heq 5€ e gjëra të ngjashme, sepse nuk është ai ose ajo që i'a heq 5€ apo diçka të tillë, por po i bëjmë mësuesit tanë komunal, po i bëjmë paralelet tona dhe vazhdojmë me shkollimin normal me këta fëmijë, punojnë njerëzit adekuat, i marrim dy staf / personel mësues të cilët marrin pagë prej shteti dhe e kryejnë punën e shtetit, por nuk ka nevojë të më thuhet mua se po i'a heq qytetarit 5€ apo të merret kjo çështje me shuma si 10,000.00€ - 5,000.00€ - 3,000.00€ e ku ta dijë unë, pra kjo është esenca. Nuk i kemi lënë këta fëmijë pa mbikëqyrje, as nuk do t'i lëm, por po kalojmë në një fazë tjetër që po duam që shteti t'i marrë përsipër, edhe nëse i hiqen atij prini 5 euro le të dihet që po ja heq shtetit, jo ai privat sepse nuk është duke i'a dhënë parat nga gjepi i vet ai, kurse sa është punuar aty në atë hapësirë nuk po hy andej sepse kam qenë disa herë në vizitë dhe e kam parë edhe punën edhe angazhimin e gjitha tjerat, në rregull është por ne

po e marrim përgjegjësinë. Prandaj edhe njëherë e them se në këtë çështje nuk kemi më nevojë me privat dhe me shoqata të punojmë por do të punojmë me institucion duke e institucionalizuar këtë shërbim dhe fundja dihet ku shkojnë paratë e buxhetit sepse do të paguhet personat adekuat që merren me atë kategori ngase ne ata fëmijë nuk e kemi ndërmend t'i lëm anash, janë të qytetarëve tanë që janë duke u ndihmuar, do të ndihmohen dhe kemi nevojë t'i ndihmojmë, përndryshe unë e di sa janë shpenzimet për një fëmijë të tillë dhe e di me sa vështirësi ata prind i përballojnë krejt ato kërkesa të tyre, por do t'i ndihmojmë në mënyrë institucionale, të paktën të mos i'u thuhet nga dikush tani që me paratë e Komunës, po të ndihmojmë lëmsh, ty andej po t'i heq 5€ - 7€ sepse më ka subvencionuar Komuna, jo në këtë formë, por do t'i vëmë në sistem institucioni, ta vazhdoj punën institucioni dhe të mbikëqyrë procesin e institucionit sikurse të gjitha punë tjera.

Mendoj që edhe mund të ketë lëshime në këtë KAB, mirëpo kemi edhe fazën tjetër kur mund të riparojmë, nëse të gjithë angazhohemi, por jo nëse ne e thërrasim takimin publik në Luzhan dhe aty e vijnë dy-tre qytetarë dhe nuk e japin kontributin e tyre, por edhe ju si asamblistë e dini që e keni në një farë forme obligim të shkoni nëpër këto takime dhe t'i ndihmoni këtij procesi. Sa më mirë që e bëjmë planifikimin e këtij buxheti, më mirë do të del me projekte në fund.

Edhe një çështje të keni parasysh, nuk kemi mundur t'i kryejmë të gjitha, shumë do të doja ta shihja të kryer edhe Tregun e kafshëve, por të kthehem mbrapa paksa, shikoni sa punë edhe sa projekte janë bërë në këtë periudhë kohe, na u dashtë t'i bëjmë këto zhvendosjet buxhetore që u bënë sepse ne duhet të vazhdojmë me projekte të reja, me inicime të reja dhe të mos lëmë borxhe mbrapa, ose më mirë më mirë të hiqet një ose dy projekt të reja që janë planifikuar, i fusim në planifikimet e vitit të ardhshëm se sa të lëm borxhe dhe që të mos na përcjellim borxhet prej viti në vit. Kjo sepse janë afër 5 milion euro mjete buxhetore që kanë shkuar nga obligimet e Kontratës kolektive dhe pothuajse nuk ka asnjë projekt i vitit 2025 që nuk ka qenë i cënueshëm e që ju me siguri e dini qysh na erdh puna në fund ku nuk kishim para as për ta paguar rrymën dhe shërbime tjera, pra i kanë marrë të gjitha madje edhe nga mallrat dhe shërbimet, prandaj unë nuk po them që s'ka lëshime ngase mund edhe të ketë lëshime ndokund, por është mirë të evidentohen lëshimet që të dihen sakt ku janë.

Tani në Raportin i Auditorit a ceket keq klasifikim apo qysh, do të diskutojmë pas kësaj pike e që e di se me padurim po e pritni, po jua them tani se po ka keq klasifikim, madje prap edhe për këtë vit që jemi ka keq klasifikim sepse paratë e para që u alokuan në buxhet e komunës në këtë vit 600,000.00€ u morën nga përmbaruesi për obligimet nga Kontrata kolektive, prandaj është shumë e vërtetë që ka pasur zhvendosje prej një kategori në një kategori, por tash shtrohet pyetja a më mirë të bëhet një shkelje të vogël, një zhvendosje të mjeteve buxhetore prej një kategori në një kategori tjetër, apo të mbeten të gjitha suficit dhe të rritet borxhi. Ne kemi bërë përpjekje që ta zvogëlojnë borxhin sa më shumë të ketë mundësi sepse keq klasifikimi është qysh në start. Shumë do të isha i lumtur që ky raport të ishte i pakualifikuar, ndoshta do të hynim edhe në garë për grant dhe të marrim buxhet shtesë, mirëpo po del i kualifikuar sepse ka përsëritje prej vitit vit edhe derisa të ekziston kjo Kontratë kolektive edhe po që se super mirë je me shpenzim të buxhetit dhe procedura, prap se prap raport rezulton i kualifikuar, s'mund t'i ikim kësaj pune.

Prandaj politikë mund të bëjmë, s'ka telashe sepse fundja për politikë jemi këtu, aq më shumë në Kuvend e që i ka hije të bëjë politikë, por vetëm është mirë që e bardha të quhet e bardhë, e zeza e zezë.

Sa i përket lëshimeve, po mund të ketë dhe duhet t'i përmendni me emra sepse edhe ne korrigjohemi pastaj, ngase një opozitë e mirëfilltë, e qëndrueshme dhe e fortë, na korrigjon shumë neve në pozitë, mirëpo nëse ju jeni të dobët, ne mund të bëjmë gabime edhe më shumë, nëse jeni të mirë edhe na jepni vërejtje dhe sugjerime me vend gjithmonë, neve na ndihmoni shumë sepse ne pastaj nuk i përsërisim gabimet, e unë s'jam i interesuar të përsëriten gabimet, veç aty ku s'mund t'i ikim asaj përgjegjësie.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani radhën e kanë nga Ekzekutivi i Komunës të japin përgjigjet apo sqarimet e nevojshme në ato që i ngritët, urdhëroni nga Ekzekutivi kush dëshiron fjalën edhe pse thuajse Kryetari i Komunës i sqaroj dhe u përgjigj në të gjitha çështjet edhe të Drejtorive, megjithatë urdhëro zotëri Ekrem, atëherë veç ju lus t'i përmbahemi agjendës dhe rregullave sepse përderisa nuk ju përmendet emri nuk mund edhe të kërkohet fjala sa herë që dëshiron dikush, por mbi të gjitha të jemi paksa edhe ekspeditiv në diskutime.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta e harroj Kryetari që për trajtim të lumenjve nuk e përmend apo ndoshta këtë çështje i'a la drejtorit Bahri Selimi. Pastaj u përmenden projektet në vlerë 550,000.00€ për ndërtimin e terreneve sportive, përse të mos i bartim këto në tjera kategori ose në tjera gjëra. Në fakt unë përmenda 2-3 fusha sportive dhe nuk po e them të mos ndërtohen fusha sportive, por të ndërtohet diku që dikujt i'u ka tekë për t'jua përmbushur kërkesën 2-3 personave që dalin e lozin në atë fushë e cila kushton rreth 50,000.00€, nuk e di a ka nevojë për një gjë të tillë.

Te puna e atyre pemëve / drunjëve dekorativ të u përmenden, nuk e di qysh është çështja atje dhe nuk po dua të hyjë andej sepse ti Kryetar e ke fqinjë atë person, por nëse i ka tharë me qëllim ata drunjë janë organet përkatëse, por nuk besoj që ka shkuar deri në atë situatë ajo farë pune. E them këtë sepse ai person në Lluga nëse ka bërë ashtu siç u tha, mendoj se nuk ka mund t'i thaj, mirëpo edhe kontratat duhet t'i mbikëqyrni sepse ne e dimë që për 1 vit e ka me kontratë që t'i ujit e t'i mirëmbaj, madje duhet që edhe stinën me e përshtat se kur mbjellën e që është në vjeshtë sepse mbihen më lehtë dhe ka ujë më shumë, e jo në korrik të mbjellën sepse pastaj sa do që ujiten është më problem.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ne tashmë e kemi të lidhur Kontratën për drunj të ri dekorativ, është lidhë para pak ditëve, por e kemi lënë që t'i mbjellim në vjeshtë që të realizohet ajo kontratë sepse në atë periudhën kohore është koha më e mirë për t'i mbjellë ata drunj.

Nëse qytetarët nuk na ndihmojnë t'i mirëmbajmë, është problem sepse ne nuk mundemi që krejt me sistem të ujitjes t'jua bëjmë në çdo cep të rrugës skajeve të rrugës sepse është e pamundshme, por një gjë ta keni parasysh, unë i kam disa segmente në rrugën Batllavë - Lluhan dhe aty ku janë ruajtur dhe që ju kanë ndejë gati dhe kanë pasë ujitje fenomenal janë duke u zhvilluar dhe a e dini çfarë forme të mirë po i japin rrugës dhe për këtë qëllim janë mbjellë, mandej e amortizojnë zhurmën, e amortizojnë CO2-shin e të tjera, do të thotë kanë efekte të shumanshme, mirëpo nëse një qytetar (po e them) për një arsye të pajustificueshme mund të bënë veprime që shkojnë në dëm, unë nuk i kam parë, por më ka thënë një person dhe e kam paraqitur si rast, që kam parë individ, unë nuk dua që këtu në publik të lëshohet në këto gjëra, por çfarë më është thënë është se ka parë individ që me preparat total, duke shkuar rend me kovë duke i lagur ata drunj që të mos i lë të zhvillohen, do të thotë kjo është një vepër shumë e rëndë kriminale, që përnjëmend një qytetar me vetëdije nuk e bën një punë të tillë, sepse ata drunj nuk e dëmtojnë e as pengojnë askënd, vetëm e rregullojnë infrastrukturën mjedisore dhe ato të rrugë.

Sa i përket lumenjve, ne e kemi bërë projektin në vlerë prej 9 milion euro për trajtime të gjitha rrjedha ujore, jo vetëm të Lumit Llap, por të gjitha rrjedhat ujore, dhe në vitin e kaluar është nënshkruar Memorandumi për 4 milion euro, të mos gabohet ka qenë në fund të vitit të kaluar dhe në vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara sipas atij Memorandumi që 600,000.00€ të shfrytëzohen dhe jemi munduar të shfrytëzojmë, por ne nuk patëm kohë as procedurat t'i iniciojmë sepse ishte vonë. Mandej kemi premtimet edhe prej Ministrisë së Mjedisit që do ta shtojnë atë buxhet edhe do ta ndërrojnë atë Memorandum Mirëkuptimi, por tash është lënë që të bëhet me rishikim të buxhetit sepse pa rishikim të buxhetit në nivelin qendror nuk mund të alokohen ato mjete për Komunën tonë dhe kështu kemi mbetur tash me 3.4 milion euro sa janë, pa e llogaritur buxhetin tonë Komunal e që parafolësi z.Ekrem Rrahmani e paska llogaritur dhe e cekur se janë në total 3.8 milion euro, pra në këtë situatë jemi dhe ne do ta iniciojmë procedurën me atë shumë prej 3.4 milion euro që i kemi, por fillimisht po e iniciojmë procedurën vetëm për Lumin Llap edhe pse Lumi Llap tani e ka koston mbi 4 milion euro si projekt që është e i cili është

reviduar dhe është bërë konform qysh e ka kërkuar Ministria e Mjedisit, do të thotë janë heqë betonet e gjëra tjera që të mos përdoren dhe do të punohet me gurë krejt. Si projekt është i mirë dhe ne po fillojmë me 3.4 milion euro dhe besoj këto ditë duhet të filloj, por të mos harrojmë që edhe në këtë vit jemi shumë vonë sepse vetëm në javën e kaluar ne morëm dritën jeshile për të filluar. Në këtë vit janë 1.5 milion euro dhe na duhet domosdo ta ndajmë me dalë dy lote në mënyrë që të mund i shpenzojmë ato mjete, përndryshe nëse nuk arrijmë t'i shpenzojmë brenda vitit buxhetor, ato mjetet sipas Memorandumit mund të mbeten suficid, prandaj po bëjmë përpjekje që të mund t'i shpenzojmë dhe dashtë Zoti bëhet Qeveria, e që po më varet prej juve goxha shumë, dhe ka mundësi mandej gjatë muajit gusht të bëhet një rishikim i buxhetit dhe me atë rishikim buxhetor ne mund ndoshta ta marrim edhe pjesën tjetër të mjeteve buxhetore sikurse që presim të marrim mjete buxhetore edhe për sistemin e ujitjes në shumë prej 9 milion euro nga Ministria e Bujqësisë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar Kryetar, kur e përmende pak më parë fshatin Lupç, unë e di që ty nuk të ka ardhur mirë që je qëlluar aty hiç, dhe më shumë më ka ardhur keq prej teje se sa prej atij (Ministrit) i cili nuk merret me këtë punë fare. Por nuk mundesh ti si profesor i gjeografisë të na thuash neve se do të ujitet 100 hektarë, sepse s'ka shans të ndodh ajo sepse ne e dimë sa bëjnë 100 hektar, sa janë të punueshme e që sipas ekspertëve janë 10 deri në 15 hektar, jo 100 hektar. Mandej ne e dimë që ajo rrjedh e lumit është aty dhe ti e din që nuk ujitet krejt Lupçi prej asaj rrjedhe ngase janë vetëm 2-3 lagje, kurse atëherë sa ka qenë pa beton e kanë më mirë dhe e kanë ujitur më mirë, tani po kanë probleme sepse nuk e ka bërë vijën e kanalit mirë sepse kur shkon në gjysmë, fryhet dhe anash rrjedh uji kurse atje në anën e poshtme kur e heq atë dërrasën "sllovenk" unë në shtëpi u ruajta dhe u frikësova që do të na merr uji, por kur pash aty kur dolën nja tre-katër pika ujë. Më së keqi më erdhi që ke ti aty Kryetar.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ju lus të jeni pak më ekspeditiv, edhe unë kam disa vërejtje dhe disa rekomandime por paraprakisht kam diskutuar me drejtoreshën e DBF-së dhe kam planifikuar që në shtator kur të vije buxheti për vitin 2027, do të kemi mundësi t'i japim sugjerimet dhe rekomandimet konkrete sepse kjo sot është vetëm një Kornizë dhe është paksa më vështirë për t'i orientuar të gjitha ato propozime që po i japni sot ju.

z.Isak Ejupi, theksoi, mbase dhe mund të jemi keqkuptuar zotëri Kryetar, por kërkesa ime nuk ka qenë për ndërtimin e terrenit sportiv për banorët e fshatit, por për nevojat e shkollës. Dua të them se edukata fizike për mua është shumë e rëndësishme. Jam një ish sportist edhe sinqerisht po them e vlerësoj shumë.

z.Haki Rudari, theksoi, dëgjova gjithë kolegët parafolës dhe propozimet e tyre, konsideroj se në parim secila kërkesë është në interes të qytetarëve, mirëpo unë po ndalem paksa te çështjet e ngritura nga kolegët parafolës z.Ermal Osmani dhe z.Isak Ejupi, vërtetë kam punuar në ato dy shkolla (në Gllamnik dhe Sekiraçë) dhe atë diku për mbi 25-26 vite, vërtetë konsideroj se duhet pasur kujdes infrastrukturës sportive nëpër shkolla dhe duhet t'i jepet përparësi, duhet identifikuar ku ka mungesë të infrastrukturave sportive nëpër shkolla, e njëjta gjendje shembull është në Shajkoc, unë deri në janar kam qenë kujdestar i klasës së IX-të me 15 nxënës (6 djem dhe 9 vajza), por megjithatë nxënësit nuk janë fajtor sepse duhet të ketë infrastrukturë sportive, andaj pajtohem plotësisht me atë që e potencoj kolegu z.Isak Ejupi që shkolla e Sekiraçës është ndërtuar vitet e 90-ta kur ka qenë kohën e okupimit dhe atë sa më duket me donacione të qytetarëve dhe banorëve atje, prandaj është mirë t'i jepet prioritet me projekte duke filluar me trotuar, pastaj me kanalizim, me ndriçim me terrene sportive e të tjera.

Pra thjesht shkollat dhe objektet shkollore duhet të kenë një përparësi në krahasim me projektet për një lagje të ndryshme për arsye se mbi të gjitha shkolla është e gjithë fshatarëve kurse një projekt i një lagjeje mundet edhe të bartet në vitin tjetër, prandaj konsideroj që duhet t'i jepet përparësi këtyre. Nga ana e Drejtorisë përkatëse të identifikohet mungesa e infrastrukturës sportive qoftë në ato shkolla të vjetra siç është shkolla e Sekiraçës dhe në vendet tjera, dhe natyrisht të bëhen ndërtime të terreneve sportive.

z.Ermal Osmani, theksoi, deshta të ndërlidhem në disa çështje, por Kryetari nuk qenka këtu, megjithatë është drejtoresha e Financave, ndoshta e din edhe drejtori i Bujqësisë. Sa i përket subvencionimit në litër të qumështit, qysh e keni planifikuar dhe qysh do ta bëni këtë subvencionim fermerëve, me çfarë rregullore, a keni bërë ndonjë komision apo ndonjë udhëzim apo në çfarë baze. Nëse dëshironi të merrni paksa opinion prej Komunave tjera, kemi Komunën e Prishtinës e cila qe pesë vite ka pagesa direkte në disa kategori të bujqësisë, në blegtori, në shpezëtari dhe në bletari, do të thotë ka pagesa direkte mirëpo Komuna e Prishtinës shkon në bazë të listave përfundimtare të Agjencionit Zhvillimor të Bujqësisë nëpërmjet atyre listave sepse bëhen kontrole në terren, shkon dhe të njëjtat i paguan jo me shuma të njëjtë por me një solid sa e ka vlerësuar Komuna, kurse ju qysh po dëshironi ta bëni këtë për litër qumështi, do të doja përgjigje prej drejtoreshës së Financave ose drejtorit të Bujqësisë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuar koleg, kjo pyetje do të ishte mirë të lihej në pikën Të Ndryshme për të marrë përgjigje më konkrete, por ne jemi tani veç e paraqite. Unë kam biseduar me drejtoreshën e DBF dhe jemi njoftuar që në muajin shtator do të mund të diskutojmë në detaje për çdo projekt dhe për çdo shumë buxhetore sa i përket buxhetit për vitin e ardhshëm.

Nëse pajtoheni mund ta hedh në votim këtë dokument dhe pastaj të marrim një pauzë të shkurtër për kafe me ftesë të Kryetarit të Komunës, por të përfundojmë me këto dy diskutime që janë paraqitur.

z.Besim Latifi, theksoi, meqë për momentin Kryetari i Komunës nuk është këtu, por sa unë kuptova nga diskutimi i tij, nuk pashë ndonjë pikë në të cilën nuk u pajtua me vërejtjet të cilat i ceka unë në emër të Grupit për atë që kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore në pjesën më të madhe është kopje si dhe në pjesën më të madhe të saj është planifikim paushallë. Do të thotë më e mira e saj ishte shembulli adekuat të cilin e mori për fushat sportive të pashfrytëzuar, dhe ne pikërisht këtë po e kërkojmë të mos bëhet planifikimi paushallë sepse po shihen shumat siç janë për projekte të ndryshme në shumë raste 20,000.00€ e 5000€, pra dokumentin e kemi të gjithë para vetës siç e ka edhe drejtoresha e DBF dhe mund t'i ballafaqojmë faktet në secilën segment.

E dyta, ishte ankesa për mos pjesëmarrjen e qytetarëve në dëgjime publike, nuk vijnë qytetarët sepse unë e tregova se nuk po zbatohet Udhëzimi Administrativ dhe kriteret minimale, nuk mjafton me një njoftim në Facebook që të vijnë qytetarët, mirëpo nëse shohim se ka telashe atëherë duhet të bëhen njoftime nëpër lagje me posterë ose edhe nëpër shkolla, nëpër institucione dhe vijnë qytetarët në dëgjime buxhetore si dhe t'ju merren parasysh kërkesat e tyre sepse tani po klasifikohen si kërkesa politike kur e ceku Kryetari, unë e ceka që nëse s'kanë ardhur te ju, ato i kanë adresuar te unë, ju lexojeni qysh të doni por është kërkesë e qytetarëve pavarësisht bindjeve politike të cilat i kanë, nuk është ajo si çështje për të cilat duhet diskutuar, por duhet të shikohet arsyeshmëria dhe prioritizimi i kërkesave të qytetarëve dhe të vazhdohet tutje.

Unë e deklarova edhe në emër të Grupit se në qoftë se ka vullnet dhe gatishmëri për t'u përmirësuar ky dokument i KAB me kërkesat ose vërejtjet të cilat i paraqitëm ne, por edhe me plotësimin e kërkesave të cilat i ngritëm në emër të qytetarëve të cilët i kanë adresuar tek ne, duke vazhduar tutje nëse ka nevojë edhe në forma individuale për secilin qytetar përmes administratës së Komunës, atëherë në rregull ne kemi gatishmëri ta përkrahim në qoftë se kemi zotim për plotësim-ndryshim të këtij dokumenti.

znj.Arbnorë Uka-Osmani, U.D. drejtoresh e DBF, theksoi, ju falënderoj të gjithëve për komentet, vetëm do të ishte më mirë sikur këto komente ose propozime të ishin ardhur gjatë dëgjimeve buxhetore. Ne kemi realizuar pesë dëgjime buxhetore por fatkeqësisht pjesëmarrja nuk ka qenë e kënaqshme e një ndër këta keni qenë dhe ju (i drejtohet parafolësit z.Besim Latifi) dhe asnjë propozim apo koment nuk kam marrë prej qytetarëve përderisa ti je në komunikim të përditshëm ndoshta me qytetarët ashtu siç edhe po deklaron këtu, prandaj do t'ju sugjeroja që në të ardhmen edhe kur ta kemi planifikimin e buxhetit për vitin 2027 dhe planifikimet për vitet 2028 dhe 2029 të merrni pjesë në dëgjime buxhetore dhe para se të hartohet dokumenti t'i paraqitni kërkesat e juaja sepse para së gjithash janë kërkesa të qytetarëve.

Pra apeloj tek të gjithë, jo me ngjyrimë partiakë, mirëpo kërkesat që vijnë prej qytetarëve edhe ne si Ekzekutiv i Komunës jemi shumë të interesuar t'i paraqitni në projektet tona dhe buxhetet tona.

Sa i përket procesverbaleve nga takimet me qytetarë, ato janë mbajtur gjatë fillimit të muajit qershor dhe kemi afat deri në 30 ditë për t'i publikuar në ueb faqe të Komunës, kështu që po presim që ditëve të ardhshme do të paraqiten.

Sa i përket komenteve për litër qumësht se si do të bëhet pagesa, edhe ne e kemi menduar ta ndjekim të ndjekim variantin sikurse Komuna e Prishtinës dhe disa komuna të tjera. Ato statistika të cilat i marrim nga Agjencia përkatëse janë shumë të sakta, qytetarë të cilët i bëjnë regjistrimet për çdo litër qumësht dhe bazohen në këtë vlerë, do të thotë kemi planifikuar që për këtë gjashtë mujorin e dytë të vitit 2026 të bëhen pagesat për litër qumësht, do të fillojmë me 2 cent për litër qumësht në bazë të statistikave që kemi dhe për vitet e ardhshme nëse e shohim që është e nevojshme do të rritet ky fond i subvencionimit.

U tha disa herë që ky dokument është kopje, realisht unë nuk pajtohen aspak me këtë sepse nuk është kopje sepse janë shumë detaje. Fatkeqësisht ka munguar feedback prej qytetarëve dhe prej asambleistëve që është për keqardhje në këtë rast, mirëpo në detaje janë vlerësuar çdo kontratë që është aktive, çdo borxh i papaguar, çdo punim që pritet të kryhet gjatë 2026, 2027 dhe dy vitet e ardhshme. Tabelat normal që janë kopje sepse ato janë tabela, mirëpo përmbajtja ndryshon. Çka mund të jetë njëjtë është te shpenzimet për mallra dhe komunal, ato nuk mund t'i ndërrojmë sepse emërtimet janë të njëjta, ka qenë rrymë, do të jetë rrymë, ka qenë mirëmbajtje, do të jetë mirëmbajtje. Ndërsa për pjesën tjetër, nëse disa projekte kapitale janë paraqitur prapë, kjo është për shkak që viteve të kaluara me vendime gjyqësore këto projekte janë cenuar edhe është dashtë prapë t'i paraqesim në KAB. Përndryshe kjo Kornizë është në përputhshmëri komplet me kontratat aktive që i kemi, projektet që i kemi në proces dhe disa projekte të reja që i kemi paraparë të arsyeshme t'i paraqesim në KAB.

Presë që gjatë muajit gusht kur bëhen dëgjimet buxhetore për buxhet, pres pjesëmarrje më të madhe dhe komente qoftë prej pozitës qoftë prej opozitës prej të gjithë asambleistëve dhe të gjitha kërkesat të paraqiten me kohë, e jo të ndodh kur të përgatitet dokumenti apo në ditën e fundit të kërkojnë përmirësime sepse nuk është e mundur ajo qoftë edhe teknikisht. Kështu që për buxhetin e vitit të ardhshëm 2027 e tutje, i presim komentet edhe vlerësimet do t'i bëjmë me kohë.

z.Besim Latifi, theksoi, unë në fjalimin tim i përmenda konsultimet e brendshme, një ndër konsultimet e brendshme është konsultimi me këtë Kuvend e që nuk ka ndodhur. Tjetra, në dëgjime publike me qytetarë në këtë Kuvend kam ardhur, kemi qenë unë, Ekrem Rahmani dhe ti drejtoresh, çfarë dëgjimi publik është ai dhe çka të prezantohet aty, prandaj nuk është faj tek ne por faji është te ju sepse nuk janë përgatitur mirë, andaj unë edhe bëra vërejtje se nuk jam përgatitur mirë konsultimet publike, vërejtje këto që nëse e dëgjove shefin tuaj e nderuara drejtoresh ai i pranoi me sportivitet, pra nuk po e kuptoj këtë tension tuaj pse e ke sepse Kryetari i pranoi vërejtjet, nuk e di sa e dëgjove por ai i pranoi që ka vërejtje dhe ka nevojë të përmirësohet dokumenti, atë po e kërkojmë edhe ne.

Ne jemi vetëdijshëm që krejt vërejtjet që i kemi dhënë dhe krejt kërkesat që i kemi bërë në emër të qytetarëve nuk është e mundur të përfshihen në KAB, mirëpo unë kërkoja një zotim që të përmirësohet me ato vërejtje, normale aty ku ka mundësi për përmirësim, pra aty ku kanë mundësi të merren për bazë kërkesat dhe vazhdojmë tutje duke e kryer KAB-in si pjesë të parë dhe pastaj vazhdohet me pjesën e dytë dhe vie deri te buxheti i vitit 2027 dhe atëherë i diskutojmë dhe i shohim a janë ardh me projektbuxhet këto projekte të cilat i kemi ngritur në KAB, a janë në projekt buxhet.

z.Valdet Kamerolli, theksoi, i nderuar Kryesues, po mendoj që vetëm po përsëriten gjërat, diskutimet kanë përfunduar dhe tani vetëm është koha të hedhet në votim sepse të njëjtat gjëra po thuhet.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolësit, theksoi, unë vetëm edhe ty të prita që ta përfundosh sepse diskutimet kanë përfunduar, andaj e hedh në votim miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028-2029 duke përfshirë edhe rekomandimet apo konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa që i përmendi drejtoresha e DBF si dhe propozimin e po kësaj drejtoreshë që te arsimi fillor të shtohet numri i stafit edhe për 10 edukatorë/e që të përfshihen në këtë dokument të KAB.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 24 Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me vendim miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore-KAB e Komunës së Podujevës, për vitet 2027/2029, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje përfshirë edhe plotësim ndryshimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e datës 26.06.2026 si dhe propozimin për plotësim ndryshim të paraqitur nga drejtoresha e DBF-së në fjalën hyrëse të kësaj pike të rendit të ditës.

Pas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit për një pauzë të shkurtër, Kryesuesi i Kuvendit jep pauzë të dhe atë nga ora 14:45, duke thirrur anëtarët/et e Kuvendit që të kthehen në sallë pas rreth 15-20 minutave për të vazhduar me këtë mbledhje.

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 15:35.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi Kryesuesi i Kuvendit z.Isak Shabani, i cili konstatoi kuorumin ku prezent për momentin ishin 23 anëtar/e të Kuvendit dhe atë:

Nga LVV: Adelinë Stublla; Artrit Mulliqi; Fatri Zhitija; Kasib Bashota; Florent Hasani; Valdet Kamerolli; Arbrim Konushevc; Luljeta Muçolli-Azemi; Haki Rudari; Abedin Zeka; Ardi Hasani.

Nga LDK: Enis Shabani; Alisa Jetullahu; Enis Dervisholli; Besim Latifi; Blerta Azemi-Berisha; Ekrem Rrahmani; Arben Xhemajli; Isak Ejupi.

Nga PDK: Isak Shabani-Kryesuesi i Kuvendit; Lulzim Pollomi; Mimoza Abdullahu; Rinesa Goxhufi,

Nga GUXO: Demokrat Hodolli, mungoi.

Nga Unioni i Blakçorve: Gentrit Arifi., mungoi.

Nga AAK: Baki Feta, mungoi.

Gjithashtu në vazhdimin e mbledhjes të pranishëm nga Ekzekutivi i Komunës ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, z.Fahri Restelica Nënkyetar i Komunës; U.D. drejtorët/shat e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Ditjona Statovci-Drejtorja e Administratës DA; Arbnorë Uka Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Ahmet Ahmeti-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Valbona Ibishi Azemi-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Shujab Blakçori-Drejtorja e Inspeksionit DI; Behram Latifi-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues media lokale (TV Llapi), dhe disa zyrtar komunal.

5. Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit - ZKA për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2025.

5.1. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e ZKA

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës përfshirë edhe nënpikën përkatëse, prezentë është drejtoresha e drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e cila me siguri se do të paraqes fjalën hyrëse.

znj.Arbnorë Uka Osmani-U.D. drejtoresh e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF, theksoi, atëherë sipas raportit të Auditorit të përgjithshëm për auditimin e pasqyrave financiare kemi opinion të kualifikuar të pasqyrave financiare dhe baza për opinion të kualifikuar janë shpenzimet e prezantuara që janë keq klasifikuar në vlerën 3,653,581.00€, pasi që Thesari ka ekzekutuar pagesa bazuar në vendime gjyqësore nga buxheti i Komunës për paga jubilarë dhe shujta. Sipas Auditorit, përveç ndikimit të çështjes të përshkruar në paragrafin përkatës për bazën për opinion të kualifikuar. Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë me plotësimet dhe ndryshimet përkatëse si dhe Rregulloren e Ministrisë së Financave nr.01/2017 për raportim vjetor financiar për organizatat buxhetore.

Nga Zyra Kombëtare e Auditimit kemi gjithsej 11 rekomandime, 3 janë të reja, 7 janë të përsëritura dhe 1 është pjesërisht e përsëritur. Materialet i keni pranuar dhe po besoj që edhe planin e veprimit e keni marrë dhe e keni lexuar, kështu që nëse keni diçka ndonjë koment ose përndryshe mund të hyjmë në secilën gjetje po e lexojmë veç e veç, mirëpo materialin e keni dhe për komente jemi këtu qoftë unë qoftë Kryetari i Komunës por dhe kolegët tanë nga Ekzekutivi.

z.Abedin Zeka, theksoi, Raporti i Zyrës Kombëtare të auditimit është një dokument i rëndësishëm sepse na ndihmon të shohim se ku kemi vepruar mirë dhe ku duhet të përmirësohemi. Së pari duhet të jemi të qartë, ky raport nuk është një aktakuzë ndaj Komunës së Podujevës, ai është një raport profesional i cili identifikon në mangësitë në zbatimin e procedurave dhe jep rekomandime për përmirësim. Është normale që në një komunë që realizohen dhjetëra miliona euro investime dhe qindra procedura të prokurimit gjatë vitit, auditori të evidentojë mangësi procedurale, kjo nuk do të thotë që automatikisht kemi pasur keqpërdorim të parasë publike apo dëm financiar.

Një nga çështjet e përmendura në raport lidhet me vonesat e pagesave, megjithatë duhet të kuptohet se jo çdo vonesë është rezultat i neglizhencës së Komunës. Ka raste ku operatorët ekonomik nuk i dorëzojnë faturat me kohë ose dokumentacioni nuk është i plotë. Në këto raste Komuna nuk mund të kryejë pagesa para se përmbushen kushtet ligjore. Po ashtu duhet të kemi parasysh se administrimi i financave publike rregullohet nga ligje dhe procedura shumë të detajuara, edhe një lëshim procedural mund të evidentohet nga auditori, por kjo nuk nënkupton domosdoshmërisht keqpërdorim ose korrupsion. Ne nuk themi se çdo gjë është në mënyrë perfekte, përkundrazi i pranojmë gjetjet dhe i marrim seriozisht rekomandimet e auditorit, pikërisht kjo është arsyeja pse Komuna duhet të hartojë dhe zbatojë planin e veprimit për adresimin e tyre.

Të nderuar kolegë, do të ishte gabim që ky raport të përdoret për propagandë politike, Auditori nuk shkruan raporte për të favorizuar apo dëmtuar ndonjë parti politike, ai e kryen punën e tij në mënyrë profesionale dhe të pavarur, prandaj edhe ne duhet të trajtojmë këtë raport me përgjegjësi, duhet të pranojmë atë që duhet përmirësuar, por edhe të mos krijojmë përshtypjen se çdo gjetje përbën skandal, përkundrazi, duhet të fokusohemi në zgjidhje. Çdo rekomandim i auditorit duhet të zbatohet, kontrollet e brendshme duhet të forcohen dhe procedurat duhet të përmirësohen në mënyrë që raportet e ardhshme të jenë edhe më të mira. Qytetarët e Podujevës presin nga ne jo akuza të ndërsjella, por punë konkrete, shërbim më cilësor dhe menaxhim sa më të mirë të parasë publike.

Në fund duhet të ritheksoj se transparenca dhe llogaridhënia janë vlera që duhet t'i mbrojnë të gjithë, Raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit është një mjet për përmirësim dhe jo një përplasje politike, le ta marrim seriozisht këtë raport, t'i zbatojmë rekomandimet dhe të vazhdojmë punën në interes të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Besim Latifi, theksoi, Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2025 është pasqyra më e qartë e mënyrës se si është qeverisur kjo Komunë gjatë vitit të kaluar, dhe kjo pasqyrë është alarmante, ky raport është aktakuza më e fortë ndaj mënyrës se si është qeverisur Komuna e Podujevës dhe kot nuk po e thotë opozita, por po e thotë Auditori Gjeneral. Ky është viti i katërt radhazi që Komuna e Podujevës dështon të marrë opinion të pastër nga Auditori dhe sërish merr opinion të kualifikuar, katër vite radhazi të njëjtat shkelje, të njëjtat vërejtje dhe të njëjtën papërgjegjësi duke vazhduar dhe duke u shtuar edhe shkelje të tjera. Dua ta rikujtoj edhe një fakt shumë të rëndësishëm, Auditori nuk i kontrollon të gjitha procedurat, të gjitha pagesat dhe të gjitha kontratat e Komunës, auditimi bëhet vetëm mbi bazën e mostrave, kjo do të thotë se gjetjet që kemi sot janë nxjerrë vetëm nga një pjesë e vogël e dokumentacionit financiar, prandaj shtrohet pyetja, nëse këto shkelje domethënë që janë gjetur janë vetëm nga mostrat, çfarë do të kishte dalë sikur të kontrollohej çdo pagesë e Komunës.

Pasojat nuk janë vetëm morale apo politike, por për shkak të këtij raporti të kualifikuar Komuna e Podujevës humb grantin e performancës edhe për të paktën tre vitet e ardhshme, pra, për shkak të keq-qeverisjes së këtij pushteti qytetarët humbin miliona që do të mund të investoheshin në rrugë, në shkollë, në kanalizime, në ujësjellës dhe në projekte të tjera zhvillimore.

Unë sot do të ndalem vetëm në disa nga gjetjet më shqetësuese të Auditorit, dhe po ia heq krejt komplet këtë çështje në B1 që po e anashkaloj këtë keq klasifikimin për shkak të kontratës kolektive, fare s'po dua ta cekë këtë, silleni punën deri te kontrata kolektive dhe le të hiqen këto vërejtje serioze që janë, do të

thotë se do të dal dhe t'jua lavdëroj raportin, mirëpo sot të fshiheni pas kontratës kolektive kur i ke një mal shkeljesh në anën tjetër, së pari Auditori ka gjet shkelje të rënda në Prokurimin publik, pra te çështja B3 thuhet shpërblyer me kontrata milionëshe i kompanive që nuk i plotësojnë kriteret e dosjes së tenderit, pra janë cekur tre raste ku Komuna ka shpërblyer me kontrata operator ekonomikë që nuk i kanë plotësuar kriteret e dosjes së tenderit e që janë kontrata për rregullimin e infrastrukturës së varrezave në vlerë 1,150,000.00€, kontrata për ndërtimin e parkut industrial në fshatin Sfeçël ashtu 1,356,000.00€, kontrata për kuzhinën qendrore 698,000.00€, e që vlera totale e këtyre kontratave me të cilat janë shpërblyer operatorët ekonomikë kundërligjshëm ka vlerën 3,209,132.00€, kjo ngre dyshime serioze për mashtrim me prokurim publik, dhe Kryetari i ka thënë auditorit që pajtohet plotësisht me gjetjet, pa asnjë kundërshtim. Çështja A1, vonesat në përmbushjen e kontratave dhe mos aplikimi i penalltive sipas kushteve kontraktuale, tek vonesat në ekzekutim operatorët ekonomikë janë të obliguar të realizojnë furnizimet, shërbimet dhe punët brenda afateve të përcaktuara, ndërsa në rast vonesash Komuna ka të drejtë të aplikojë penalltitë apo masa tjera kontraktuale. Po ashtu në kushtet e kontratës janë të përcaktuara afatet e realizimit të projekteve të kontraktuara bazuar në planin dinamik dhe përmbushjen e secilës kontratë, gjatë auditimit Auditori ka vërejtur vonesa në realizimin e kontratave duke tejkaluar afatet e përcaktuara kontraktuale deri në 74 ditë vonesë, përkundër këtyre vonesave nuk janë aplikuar penallti ndaj operatorëve ekonomikë, në këto raste do të thotë është vërejtur tek kontrata për furnizim me material për radiologji, furnizim me kabinete dhe mirëmbajtja e lumit Llap.

Po ashtu nga testimi i kontratave për projekte kapitale dhe gjendjes në terren është konstatuar se nuk janë realizuar punët brenda afateve të përcaktuara me kontratë duke rezultuar në realizim të ulët të punimeve dhe vonesa në përmbushjen e tyre, dhe vërejtjet për këtë janë te projekti rinovimi i Teatrit në vlerë 219,000.00€ i cili ishte paraparë të përfundoj në maj 2025, megjithatë deri në shkurt në kohën e auditimit projekti ishte i realizuar vetëm 79% duke rezultuar në vonesa në realizim të punimeve, pastaj projekti i Ndërtimit i shkollës ekonomike në vlerë 566,649.00€ ku sipas kontratës ishte paraparë të përfundojë në muajin korrik 2025, mirëpo deri në shkurt, në kohën kur është bërë auditimi, projekti ishte realizuar vetëm 55%, si dhe kemi projektin e ndërtimit të tregut të qytetit në vlerë 1,440,787.00€ i cili sipas kontratës ishte paraparë përfundoi në muajin tetor 2025 ndërsa realizimi në kohën e auditimit ishte vetëm 27%.

Komuna nuk aplikon fare penalltitë, por ku mund të aplikohen penalltitë si ndëshkim kur më lart e kemi parë se i keni shpërblyer kundërligjshëm me kontrata milionshe operatorët ekonomikë, prandaj të dyjat nuk mund të bësh, pra nuk munden të aplikosh edhe në fillim edhe në fund, mirëpo përgjigja e menaxhmentit edhe në këtë rast është; pajtohem pa asnjë kundërshtim.

Tek çështja B2, kontraktimi i projekteve kapitale në mungesë të fondeve financiare, pra edhe më herët edhe në raport e kemi diskutuar që Komuna ka hyrë në obligime në mungesë të mjeteve financiare që është e kundërligjshme kjo punë sipas Ligjit të prokurimit nenit 9 paragrafi 3, po ashtu ligjit të buxhetit për vitin 2025 nenit 12 paragrafi 7 i cili e përcakton se nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare bëhet nga organizata buxhetore vetëm në raste kur shpenzimet e tilla për koston totale të projektit janë të paraqitura në ligjin e buxhetit për vitin fiskal 2025 dhe në dy vitet në vijim, pra duhet të jenë saktë të gjitha shpenzimet që e mbulojnë kontratën të cilat duhet të jenë paraqitura në ligjin për buxhet., kurse ju keni nënshkruar kontrata milionshe për projekte të mëdha kapitale duke tejkaluar hapur ligjin e buxhetit dhe ligjin e prokurimit. Për projektin e ndërtimit të parkut industrialë në fshatin Sfeçël, kontrata u nënshkruan vlerë 1,356,099.00€ ndërsa buxheti i aprovuar ishte vetëm 400,000.00€, pra për këtë Auditori ka thënë tejkallim 956,099.00€. mandej për rregullimin e infrastrukturës së varrezave të qytetit kontrata është lidhë 1,150,000.00€, kurse në buxhet ishin të planifikuar vetëm 50,000.00€, pra tejkallim 1,100,000.00€, për ndërtimin e kuzhinës qendrore për çerdhe dhe shkolla, kontrata është nënshkrua në vlerë 698.000.00€ ndërsa buxheti i miratuar ishte vetëm 190,000.00€ e që edhe këtu është tejkallim 508,000.00€. lidhur me këtë, e para e punës është se kundërligjshëm i keni filluar projektet, pastaj

e keni fut Komunën në borxhe milionëshe pa mbulesë financiare duke i tejkaluar autorizimet e juaja ligjore, si dhe e dyta është se qysh planifikoni t'i financoni tutje këto projekte, ku do t'i gjeni parat, mirëpo edhe në këtë pikë përgjigja e menaxhmentit është se pajtohet pa asnjë kundërshtim me gjetjen auditorit.

Tek çështja B6, vonesa në lëshimin e lejeve ndërtimore sipas nenit 17 të ligjit për ndërtim, leja ndërtimore lëshohet nga organi kompetent brenda 30 ditëve pas pranimi të kërkesës për leje ndërtimore të kategorisë së parë, kurse 45 ditë për kategorinë e dytë dhe të tretë. Gjatë vitit 2025 Komuna ka lëshuar gjithsej 19 lejen ndërtimore, megjithatë në 10 raste janë evidentuar vonesa në lëshimin e tyre duke tejkaluar afatet ligjore deri në 104 ditë, këto vonesa sipas Auditorit janë shkaktuar kryesisht nga mosrespektimi i kornizës ligjore dhe mosfunksionimi i kontrolleve të brendshme për shqyrtim dhe trajtim të kërkesave me kohë për lejen ndërtimore. Auditori ka thënë se vonesat në lëshimin e lejeve ndërtimore ndikojnë negativisht në argëtim me kohë të të hyrave komunale nga këto leje, po ashtu ato vonojnë fillimin e aktiviteteve ndërtimore dhe zhvillimin e bizneseve që operojnë në Komunën e Podujevës, përgjigja e menaxhmentit edhe për këtë është se pajtohen plotësisht me auditorin pa asnjë vërejtje. Unë ju kam dëgjuar shumë për këtë çështjen e kranave (vinçat), kurse Auditori po tregon që s'keni krijuar kë klimë të përshtatshme për biznese, përkundrazi me krejt mundësitë që i keni pas në dorë i keni penguar, këtë leje keni pasur mundësi t'ju vononi dhe i keni vonuar nga gjysmë viti.

Çështja A2, përdorimi i procedurës së negociuar të prokurimit publik pa plotësimin e kushteve sipas nenit 35 të ligjit për prokurim publik, procedura e negociuar pa prokurim publik të njoftimit për kontratë mund të përdoret vetëm në rrethana e jashtëzakonshme si urgjentë ekstreme që nuk mund të parashikohet dhe që nuk është shkaktuar nga vetë autoriteti kontraktues, ndërsa Komuna e Podujevës kishte lidhur kontratë për projektin ndërtimi i vend-parkimit për autobus në vlerë 6,997€ në janar të vitit 2025, procedura e prokurimit ishte iniciuar në muajin dhjetor 2024 duke përdorë procedurë të negociuar pa prokurim dhe pa publikim të njoftimit për kontratë, megjithatë Auditori e ka thënë se ky arsytim nuk e justifikon përdorimin e kësaj procedure pasi që nuk plotësohen kushtet për urgjencë ekstreme të paparashikueshme siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.

Çështja B4, vonesa në pagesën e faturave të pranuar, edhe këtu sipas ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë nenit 39 e përcakton se Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme për kërkesë për pagim të mallrave dhe shërbimeve të furnizuara ose punë të realizuara për organizatën buxhetore, të paguhen brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimi të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore, ndërsa në shtatë raste në vlerë 401,750.00€ Auditori ka vërejtur se Komuna nuk kishte paguar faturat brenda afatit ligjor, vonesat në pagesa ishin deri në 200 ditë përtej afatit ligjor, këto fatura ishin prej kategorisë së investimeve kapitale dhe mallrave e shërbimeve, kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo adekuate në ekzekutimin e pagesave dhe menaxhimin e kontratave publike, mirëpo edhe në këtë përgjigja është e njëjtë, pajtoheni.

Këto ishin vetëm disa nga gjetjet e auditorit. Ky pushtet ka bërë shpërfillje totale ndaj auditorit, ky pushtet refuzon të përmirësohet, pra nga 13 rekomandime të vitit paraprak, për 7 prej tyre nuk ka filluar fare zbatimin, janë saktësisht të njëjtat shkelje që përsëriten vit pas viti. Kryetari i Komunës tashmë e ka nënshkruar letër konfirmimin ku pajtohet plotësisht me të gjitha këto gjetje dhe pa asnjë koment apo ankesë. Ne si opozitë dhe si asamblesë të Kuvendit Komunal gjatë analizimit dhe diskutimit të raportit po kërkojmë llogari nga pushteti për gjetjet e auditorit dhe shkeljet e rënda në shpenzimin e buxhetit të Komunës, sepse buxheti i Komunës nuk është pronë e pushtetit por është para e qytetarëve të Podujevës dhe detyrë e jona është ta mbrojmë çdo euro të tyre, të kërkojmë transparencë dhe llogaridhënie.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, para se të vazhdojmë ju lus të respektohet koha e përcaktuar për diskutim sipas Rregullores së punës, kjo sepse parafolësi e kaloj minutazhën e paraparë, prandaj lus të gjithë që t'i përmbahen dispozitave të rregullores.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë e përgëzoj asamblistin parafolës i cili në një mënyrë e tha mos dilni me na kritiku se s'bën, e tha kemi bërë keq por nuk bën kurrqysh të na kritikoni (fjalën e ka te diskutimi i parafolësit z.Abedin Zeka), andaj nuk e di qysh e morë mundin e doli duke potencuar ashtu, e që i bie sikur të thuhet se ne i kemi votat e ata mund të flasin çka të duan.

Raporti i Auditorit për Komunën e Podujevës, për ta kuptuar edhe qytetarët më qartë sepse emrin e ka kështu pak si të keq po ta shikosh, i kualifikuar, dhe tani në këtë kohë kur jemi duke shikuar kampionatin botëror të Futbollit qytetarët mendojnë që jemi kualifikuar më lartë, mirëpo ky raport është raport i zi dhe i keq. Në vitin 2021 raporti ka qenë, i pa modifikuar, pastaj në vitin 2022 është raport i kualifikuar, i zi, në vitin 2023 i kualifikuar i zi, në vitin 2024 raport i kualifikuar edhe i zi si dhe në 2025 po ashtu i kualifikuar i zi edhe terr. Tash e dimë që ju dilni dhe e arsyetoni këtë raport duke thënë kontrata kolektive andej këndeje, por përveç asaj ajo është veç një dhe nuk është as e dyta ose e treta, mirëpo këtu janë 11 çështje që e kanë bërë raportin e kualifikuar dhe të zi, do të thotë kudo që kanë marrë mostra kanë gjetë gabime. Te kryerja e punimeve ka pas deri në 74 ditë vonesa, nuk i kanë marrë edhe disa të tjera që ka dhe me një vjet vonesë, shembull te rrugët “Vëllezërit Frashëri”, “Xhemajl Mustafa” dhe “Skënderbeu” ende punohet, madje rr.“Xhemajl Mustafa” është dashur të kryhet në gjysmën e parë të vitit 2024 kurse ne tani jemi në vitin 2026 e që në këtë kemi vonesa me vite, jo me ditë.

Ishin edhe disa çështje interesante që u përmenden më herët siç ishte ndërtimi i parkut industrial bujqësor në fshatin Sfeçël i cili është kontraktuar me 1,356,099.00€ kurse janë planifikuar 400,000.00€, do të thotë këtu është tejkalua shuma mbi 956,000.00€. mandej projekti i rregullimit të infrastrukturës së varrezave të qytetit, shembull këtu është lidhë kontrata 1,150,000.00€ kurse janë të ndara 50,000.00€, tani për këto mjetet tjera duhet thënë “i qon Zoti ose vijnë dikah”, pra unë nuk e di qysh shkon kjo punë kështu me këtë tejkalim kaq të madh të mjeteve financiare.

Plani i veprimtimit për zbatimin e rekomandimeve, po ashtu më bëri përshtypje shumë, në fakt unë nuk i di kush i ka dhënë përgjigjet, mirëpo pati shumë përgjigje qesharake e që një ndër to ishte “hajt se gjithë kështu ia kemi bërë”, nuk është përgjigje kjo ose është përgjigje shumë pa lidhje.

Tek lejet ndërtimore, në raport është cek që ka pasë vonesa deri në 200 ditë, mirëpo ju keni thënë që e keni rritë stafin dhe është zvogëluar koha e lëshimit të lejeve, mirëpo raporti thotë që jeni vonuar 200 ditë, tash nuk e di unë ai staf që është rritur a e kanë penguar apo e kanë përshpejtuar procedurën.

Përmenden edhe shumë çështje tjera por unë nuk po e zgjati më shumë sepse siç po duket Kryesuesi e paska minutazhen dhe ma ndalë fjalimin.

z.Enis Dervisholli, theksoi, i nderuar Kryetar, për 6 vite radhazi raporti i Auditorit të vie, i kualifikuar, e që është shqetësuese, pastaj në 4 raste nuk i ke dënuar kompanitë për vonesat e punës që janë bërë, ipo ashtu Kryetar, më parë i mbroje qytetarët kurse tani po i mbron kompanitë.

Pika tjetër i nderuar Kryetar është se i ke jep 7000€ për projektin e ndërtimit të një stacioni të autobusëve te shkolla ekonomike e që është bërë me ndërmjetësim, nuk e di çka ka qenë aq urgjente bërja e këtij stacioni, pse t'i shkelni procedurat e tenderimit për 7000€, për 30-40 metra asfalt, kjo është shqetësuese që të kushtoj 7000€ ky stacion.

Mandej, ke marrë një autobus donacion prej një kompanie që më shumë se një vit dhe sot e asaj dite nuk përdoret ai autobus sepse nuk ka shofer, përndryshe për 1 ose 2 javë unë në mënyrë vullnetare do ta vozitja dhe nuk do e lëja të rri aty sepse është dëm.

I nderuar Kryetar, ti je pajtuar me shkeljet e gjetura të Auditorit për vitin e kaluar e që kanë mbet të përmirësohen, mirëpo sot e atë ditë i nderuar Kryetar je i pa përmirësuar, përndryshe a ka mundësi një vit të mos kemi shkelje në raport të Auditorit në mënyrë që pastaj të përgëzojmë për një punë të mirë në mënyrë që me dalë me faqe të bardhë, të paktën një vit të mos ketë shkelje të evidentuara në këtë raport.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, dëgjova me vëmendje vërejtjet e parafolësve, por çdo gjë që është në këtë raport të Auditimi është e shkruar, e faktuar, mostrat janë mostra dhe janë marrë këtu, kurse nuk e dimë për të tjerat a janë mirë apo keq, ndoshta janë mirë, ndoshta janë keq, nuk mund të prejudiojmë. Se a është i mirë ky raport dhe se a jemi të kënaqur nuk jemi të kënaqur sepse shumë do të doja të jem i kënaqur po të ishte ky raport i pakualifikuar dhe do të vazhdonim tutje dhe ndoshta do të hynim në garë për të fituar diçka nga granti i performancës, por fatkeqësisht është i kualifikuar.

Nuk është viti i parë që është i kualifikuar ky raport, por edhe sikur çdo gjë të ishte në rregull, ju e dini shumë mirë që vetëm me faktin pse kemi mjete të cilat janë tërheq nga buxheti komunal dhe nga projektet, për shkak të Kontratës kolektive raporti do të rezultonte i kualifikuar.

Se çfarë kemi bërë ne për ato 13 gjetje të vitit të kaluar e që 7 janë përsëritur, do të thotë se 6 i kemi përmirësuar, andaj nuk qëndron fakti që nuk janë përmirësuar sepse janë përmirësuar, mirëpo disa i kemi të përsëritura sepse janë disa punë që edhe po të duam të mos përsëriten, detyrohesh t'i përsëritësh sepse ndodhin lëshime të atilla të cilat faktikisht përsëriten.

U përmendën shumë kategori dhe t'ju them të drejtën unë po kaloj nëpër ato vetëm për hir të opinionit publik sepse fundja ky raport është publik e që edhe po të dojë ndokush të fsheh diçka nuk mundet sepse është publik dhe madje është i publikuar e që disa prej juve e keni marrë më herët ende pa u publikuar sepse ne nuk e kemi fshehur dhe nuk e kemi praktikuar të fshehim ngase janë gjetje të cilat janë të evidentuara dhe të cilat normal ne duhet të punojmë për t'i mënjanuar.

Te granti i performancës, të jeni shumë të bindur se unë do isha shumë më i kënaqur të krijoheshin mundësi për të qenë përfitues në këtë grant të performancës, mirëpo e dini shumë mirë që i kemi sjellë me dhjetëra miliona euro investime në Podujevë gjatë vitit që shkoj, po ta sjellnim edhe 1 milion më shumë sigurisht do të ishte e mirëseardhur për qytetarët tanë, por në anën tjetër po ta ruanim ne vetëm këtë grantin e performancës, ndoshta investime tjera nuk do të mund të merrnim, do të thotë që nuk kemi qëndruar duarkryq në këtë drejtim por kemi punuar e bashkëpunuar me nivelin qeveritar dhe kemi sjellë shumë punë dhe projekte të tjera faktikisht janë duke u realizuar ose janë në proces të realizimit ose edhe që janë realizuar.

Sa i përket asaj që u tha se nuk kemi aplikuar penallti për kompani në katër raste që ka pasë vonesa në realizimin e kontratave, mirëpo nuk është ajo që Kryetari i mbron kompanitë, por nëse nuk ke para që ta paguash kompaninë atëherë qysh ke për ta dënuar atë, pra nuk ke pas mundësi të paguhen faturat përkatëse sepse ato mjete janë marrë përmes Përmbaruesit, prandaj nuk mund ta dënosh kompaninë kur nuk mund t'ia paguan borxhin, andaj kjo çështje edhe është normale pastaj që gjendet si vërejtje e Auditorit sepse nuk kemi pas mjetet buxhetore për t'i paguar kompanitë që kanë kryer punë. Nëse i kemi planifikuar 200,000.00€ ta zëm për të paguar një kompaninë dhe kur ka ardh koha e pagesës ato para nuk i kemi pasë në buxhet fare sepse na janë marrë përmes Përmbaruesit dhe janë shpenzuar diku tjetër, prandaj këtu edhe lindin ato periudha kohore që edhe shtyhen kontratat dhe nuk mund të bësh pagesa kompanive dhe në anën tjetër nuk mund ta detyrosh me zor askënd të kryej punë nëse nuk ke mundësi ta financosh.

Në treguesin B2 thuhet se Komuna ka kontraktuar 3 projekte në mungesë të fondeve financiare duke tejkaluar fondet e miratuara me ligj të buxhetit, për këtë mund të them se ne e kemi ditur atëherë kur është iniciuar, shembull projekti i ndërtimit të Parkut industrial nuk kryhet me 400,000.00€ por ne e kemi iniciuar sepse është projekt dyvjeçar, pra nuk është projekt i një viti, por që e kemi ditur që për 2 vite do ta mbulojmë projektin, prandaj atë shumë buxhetore që kemi pasë, me atë kemi iniciuar kontratë dhe kjo është normale. Gjithashtu edhe te projekti i varrezave, e kemi ditë sa kushton por e kemi iniciuar me një shumë buxhetor më të vogël sepse atë shumë e kemi pasë të planifikuar në buxhet në vitin paraprak dhe me at shumë kemi filluar sepse nuk mund ta shkruajmë 1,000,000.00€ ta zëm, nëse në buxhet shembull kemi vetëm 500,000.00€, por ato që i kemi pasë, ato i kemi shkruar dhe me ato kemi iniciuar procedurën sepse është projekt dy/tre vjeçar varësisht periudhës kohore në të cilën do të realizohet, ndërsa kjo për

Auditorin është vërejtje, por realiteti është ky dhe nuk kemi mund të lidhim kontratë njëvjeçare nëse projekti është diçka mbi 1 milion euro, andaj për atë e kemi proceduar si projekt dy/tre vjeçar varësisht mundësive që do të kemi në planifikime për pagesën e borxhit të atij projekti.

Një çështje që mund të diskutohet dhe besoj që ia vlen të diskutohet është rasti ku thuhet që në tre raste Komuna kishte shpërblyer në kontratë operatorët edhe pse nuk i kishin plotësuar kriteret e vendosura, çështje kjo e cila është për diskutim por që dhe në këtë kemi një përgjigje dhe të njëjtën përgjigje kam kërkuar t'ju dërgohet edhe auditorëve dhe t'ju jepen sqarime shtesë, të njëjtin sqarim tani dua t'ju jap edhe juve asambleistë por edhe qytetarëve. Te ndërtimi i Parkut industrial bujqësor në fshatin Sfeçël është fjala për certifikatën ISO 900125 operatorin ekonomik Genti dhe atë certifikatë zyrtari i prokurimit ose udhëheqësit e procedurës e kanë pas për obligim sipas Udhëzimit Administrativ 01/2023 për prokurimin publik, pra thuhet që lista e kontratave të realizuara nuk është dorëzuar por janë dorëzuar dëshmitë, referencat, certifikatat e pranimit të kontratës, mund të kërkolet informata sqaruese, pra është pikë që me Udhëzues të prokurimit publik ajo certifikatë ka mund të kërkolet dhe nuk do ta kishim këtë vërejtje të Auditimit, pra ka mund të kërkolet prej zyrtarëve të prokurimit por që është lëshim teknik që nuk e kanë bërë sikurse që është lëshim teknik edhe nga komisioni përkatës që ka bërë vlerësimin, mirëpo edhe zyrtari i prokurimit është dashur t'ia tërheq vërejtjen atij komisioni duke i kërkuar ta rregulloj këtë çështje sepse nuk është në rregull, kjo sepse kompania në fjalë e ka certifikatën në fjalë dhe atë para asaj date që e ka fituar punën, ja ku është certifikata në fjalë ISO 900125 (prezanton dokumentin në fjalë), por kjo tashmë ka shkuar prandaj e potencova se është dashtë t'i thuhet ta sjellë atë certifikatë dhe të futej/ngarkohej pastaj në dokumentacion dhe këtë e ka krijuar Udhëzimi, mirëpo kjo justifikohet për shkak të ngarkesës së madhe të komisionit me punë dhe është bërë ky lëshim teknik, prandaj kjo që e potencova, kur do që dëshironi mund të vërtetohet sepse certifikata në fjalë e asaj kompanie është publike dhe jua tregova atë, pra për këtë lëshim kemi marrë vërejtjen.

Rasti i dytë, ka të bëjë me projektin e rregullimit të infrastrukturës së varrezave të qytetit, numrin e prokurimit dhe kompaninë EING të cilën të gjithë e dini besoj që është një kompani që ka goxha një qarkullim të madh këtu, në Prishtinë dhe gjithandej Kosovës punon njeri, por këta zotëritë si komision së bashku me zyrtarin e prokurimit i cili mbikëqyrë punën e atij komisioni ngase Kryetari nuk shikon atje çfarë bëhet, pra ka mundur sërish sipas të njëjtit Udhëzim t'ia kërkoj qarkullimin bankar i cili siç e dini bëhet përmes ATK-së dhe nuk mund të fshihen këto gjëra, unë e kam kërkuar atë dhe ja shikojeni ky është qarkullimi bankar i vitit 2024 i kompanisë EING që i ka plotësuar kriteret (paraqet dokumentet sipas të cilave prezantohet qarkullimi bankar i kësaj kompanie), çështje këto për të cilat kush do që dëshiron mund të hyj në ueb-faqe të ATK-së dhe të nxjerr qarkullimin bankar, ata që kanë biznese e dinë këtë sepse ky si dokument nuk është i fshehtë por është publik. Kjo kompani ka qarkullim dhe nuk është hera e parë që ka ardh në projekte, mirëpo nuk i është kërkuar kjo e që sërish është lëshim teknik i atyre që është dashur ta mbikëqyrin këtë proces, kurse Auditori e ka evidentuar si vërejtje dhe unë nuk mund t'i them Auditorit që nuk e pranoj këtë vërejtje sepse realitet është kjo, mirëpo ju them që realiteti tjetër është që ekzistojnë këto dokumente dhe janë publike e zyrtare që nuk mund të fshehën po edhe nëse ndokush dëshiron t'i fshehë sepse qarkullim bankar nuk mund ta rritësh ose zvogëlosh, ndërsa kompania e cekur i plotëson ato kriteret, prandaj mund të llogaritet si një lëshim teknik.

Te ndërtimi i Kuzhinës Qendrore, thuhet ISO 50012018, dhe i njëjti autor ka pas certifikatën 992012 e që kjo është vetëm për konsum të energjisë, por kjo që kërkolet ajo kompani e ka certifikatën brenda të cilës certifikatë hyn edhe kjo certifikatë, por edhe certifikata tjera të cilat i posedon në dokumente ajo kompani, por që nuk i është sqaruar qysh duhet kjo çështje as operatorit as auditorit, andaj normal që janë evidentuar nga Auditori si shkelje, unë nuk mund t'i them që nuk janë shkelje, mirëpo komisioni përkatës bashkërisht me zyrtarin e prokurimit është dashur t'ia sqaroj që kjo certifikatë ngërthen edhe certifikatën e kërkuar për konsum energjie e që kjo kompani e ka pas certifikatën 99212 e që brenda saj janë gjitha certifikatat tjera

të standardeve të njohura ndërkombëtare, mirëpo për shkak të këtyre ne kemi marrë këto tre vërejtje dhe atë pa asnjë nevojë.

Ju e dini që më parë zyrtarët e prokurimit një është caktuar dhe ai më nuk ka lëvizë prej aty për 20 vite, ndërsa siç e keni parë unë po i ndërroj në çdo tre-katër muaj, po të mos kishin problemi nuk do të ndërroheshin sepse do të ishte problem t'i ndërrojmë, por ne po i ndërrojmë sepse lëshimet e cekura kanë pasë edhe pasoja, pra kanë ndodh ndryshime ngase të paktën këto tri problemet/vërejtjet e cekura nuk kanë pasë nevojë të jenë në këtë raport sepse kanë qenë probleme që nuk kanë pasur nevojë të shkruhet për to e që më së shumti është përfol për to. Në anën tjetër këto çështje tashmë kanë shkuar për shkak se këta zotërinjtë (zyrtarët e prokurimit dhe anëtarët e komisionit vlerësues) është dashur të japin sqarime se çka është problemi ngase certifikatat nuk mund të merren pas kohe, por janë certifikata që ekzistojnë para kohës së marrjes së tenderit, mirëpo nuk u janë kërkuar dhe normale Auditori e ka gjetur si vërejtje.

Sa i përket afateve të kontratave veçse u cekën, fjala është te ndëshkimi i kompanive dhe afateve të kontratave e që mendoj se nuk mund të ndëshkohet një kompani që nuk i ka kryer punët kur nuk ke mund t'a paguash atë e që kjo është përgjegjësi e jona si Komunë sepse ne i kemi kontraktuar, dhe nëse ne nuk kemi buxhet t'i paguajmë pastaj nuk mund t'i thuash një kompanie po ju dënoj për shkak se nuk e keni kryer punën. Ju e dini që këtu ka transparencë buxhetore, të gjithë e dinë sa mjete buxhetore ka në xhirollogari, sa kanë mbet, sa i ka marrë Përmbaruesi e të tjera, madje në kohë rekord informoheni edhe rreth shpenzimeve që normale bëhen në ato projekte ku ka buxhet, kurse në ato për ato projekte ku nuk ka buxhet normale që mund të ketë pauza sa i përket kryerjes së punëve. Për këtë arsye edhe u bënë ndryshimet buxhetore pak më parë këtu nga një kod në kodin tjetër me qëllim që të mundësohet përmbyllja e atyre projekteve sepse kemi ngecur dhe kemi mbetur mbrapa, kjo është shumë e vërtetë, madje mund të them se viti 2025 është viti më i rëndë buxhetor që kemi pas ndonjëherë për shkak se rreth 3.6 milion si dhe një shumë rreth 600,000.00€ në fillim të këtij viti na janë marrë nga Përmbaruesi, do të thotë mbi 4 milion euro, ndërsa siç e dini ne kemi 9 milion euro buxhet për investim kapital, andaj afërsisht gati gjysma e buxhetit për investime kapitale ka shkuar përmes Përmbaruesit, prandaj edhe ka pas probleme dhe vërejtjet që janë bërë.

Sa i përket çështjes së lejeve ndërtimore, për çka njëri prej parafolësve e tha që nuk i kemi pritur mirë kompanitë, janë paditur ose që kanë kaluar keq, mirëpo unë ju them që për atë që kanë kaluar "keq" po vazhdojnë të investojnë, pra nuk ka probleme, mirëpo ta sqaroj, ta zëmë bëhet kërkesa për kushte ndërtimore ose leje ndërtimore, pastaj gjatë shqyrtimit jepen vërejtjet që kërkohet të plotësohet me këtë ose atë dokument për të vazhduar tutje dhe ndodh mandej që pasi ta merr atë letër kompania, ndodh të ketë vonesa deri në dy muaj e më shumë, vazhdon me punë tjera, dhe pas dy muajve vie dhe e sjellë dokumentin e kërkuar duke i'a bashkëngjitur kërkesës për të vazhduar atë punë që ka filluar. Pra nuk janë vonesa tona nëse kompania sot i merr kushtet, pastaj kërkohet të plotësohet me dokumente tjera përkatëse dhe nëse ato dokumente i vonon kompania për dy ose tre muaj derisa t'i sjellë, kërkesa kthehet sepse lënda është lëndë dhe ka një datë kur nisë dhe kur mbaron, andaj nëse kompania nuk kthen menjëherë përgjigje brenda afateve me dokumentacione, normal që pastaj ndodh të zgjatet periudha e lejes, përndryshe tregomëni nëse gjeni një rast që diku në Kosovë ku mund të kryhet leje ndërtimore për 30 ditë, mendoj që nuk ka shans të kryhet. Qysh kanë mbetur këto afate unë nuk e di, por në praktikë është problem të kryhen sepse edhe nëse si Komunë dhe administratë mund të jesh ekspeditivë në masën më të madhe në kryerjen e punëve, ato lëndë nuk ka shans të kryhen brenda afateve siç specifikohet sepse kur shembull kompania ndërtuese vonohet 10 ditë për të ardhur t'i marrë vërejtjet apo kërkesat shtesë për plotësim të lëndës për kushte ndërtimore, dhe vijnë pas 10 ose më shumë ditëve (ngase kanë shumë më shumë punë dhe projekte tjera), mandej të gjitha ditët llogariten në afatin kohor i cili rrjedh nga momenti i paraqitjes së kërkesës, prandaj për këtë arsye shkaktohet vonesa me nga 60, 70 e 80 ditë, dhe kjo nuk varet prej Komune sepse lënda është e hapur dhe në proces nga dita kur është pranuar si kërkesë por askund nuk

shkruan prapa plotësim dokumentacioni që të mund të plotësohen komplet kriteret rreth asaj leje ndërtimore. Nuk e di sakt përmendësh sa leje ndërtimore janë lëshuar në këtë periudhë kohore të këtij viti, mirëpo qenkan 19 leje ndërtimore e që besoj se është sukses dhe është një sinjal i mirë që njerëzit po besojnë të vijnë të punojnë dhe investojnë në Podujevë, përndryshe ju e dini sa leje kemi pas të lëshuara më herët, madje unë besoj që këto janë interes i përgjithshëm sepse njerëzit këtu po investojnë, këtu po ngrënin, këtu po pinë, këtu po punësohen, andaj besoj që këtyre punëve duhet t'i gëzohemi të gjithë ne. Ejani të ulemi bashkë dhe të shikojmë mos po mund të përmirësojmë diçka dhe ta rrisim ekspeditivitetin sa i përket trajtimit të këtyre lëndëve në mënyrë që t'i përshpejtojmë, por jo në kuptimin që të shihet vetëm zi ashtu siç e potencoj asambleisti z.Ekrem Rrahmani sepse nuk është krejt zi siç e thua ti Ekrem, shkruar me të zezë në të bardhë është.

U përmend edhe Stacioni i autobusëve, konkretisht shuma e shpenzuar 6000€, kurse ju e çekët 7000 euro si vlerë, mirëpo ndërtimi i atij stacioni ka pas nevojë të bëhet sepse ju e dini që Stacioni kryesor u ndërtua në pjesën e poshtme të qytetit dhe mandej filluan ankesat se nuk po u'a sjellim autobusët deri në brendësi të qytetit, andaj u paraqitë nevoja të fusim një linjë autobusi deri aty për t'i marrë udhëtarët, përndryshe nëse do t'i lenim autobusët në rrugë do të shkaktonin shumë telashe në qarkullim, prandaj është dashur të bëhet ai stacion i cili aty është, nuk ka shkuar askund, tani çka t'ju them juve, aty po parkohen autobusët dhe po shfrytëzohet nga qytetarët dhe nga vozitësit e kompanive të autobusëve, kështu që ai stacion aty është, ndërsa a janë shkuar në rregull apo jo, është kompetent dhe për atë është zyrtar përkatës e që për atë pastaj ka sanksionime, ka avancime dhe këtu jemi.

Tani se a është mirë të mos na përsërit këto 7 raste, mirë është. Ne vërejtjen e mëhershme të vitit të kaluar e kemi pasë për mosmenaxhim të kontratave përmes E-prokurimi, dhe tani sërish e njëjta vërejtje na është dhënë edhe përkundër faktit që unë ju kam tërheq vërejtjen menaxherëve të kontratave që t'i menaxhojnë kontratat përmes E-prokurimit, tju them të drejtën nuk e di sa punë ka ajo procedurë dhe a është shumë e koklavitur, sepse nuk e kuptoj atë proces, mirëpo nëse është menaxher është dashur të bëjë më shumë përpjekje për t'i kryer sa më shumë, edhe nëse nuk mundet gjitha kontratat sepse ne këtu kemi edhe një problem në këtë aspekt, ju e dini sa inxhinierë kemi këtu, të gjithë këta inxhinierë që kemi kanë nga 4 deri në 7 e më shumë kontratat duke i menaxhuar njëkohësisht, kjo sepse numri i tyre është i vogël dhe ne nuk mund që kontratën e infrastrukturës t'ia japin një zyrtari tjetër pa pasë një përgatitje të tillë që e kupton atë problematikë. Kjo pastaj po i ngarkon me numër të madh të kontratave të cilat menaxhohen njëkohësisht, e them këtë pa dashtë t'i arsyetoj, absolut, sepse nëse është kërkesë nga prokurimit për të menaxhuar një kontratë, ne duhet të bëjmë çmos ta rritim të paktën kapacitetin e menaxhimit të kontratave.

Mund të ndodh të ketë ndonjë lëshim, por me këtë numër të zyrtarëve-inxhinierë dhe arkitekt të ndërtimit që kemi, konsideroj se edhe një kohë do të na përcjellë ky problem sepse nuk mjaftojnë. Në këtë rast, nëse një zyrtar i tillë ka 4 ose 7 kontrata nën menaxhim njëkohësisht vërtetë është volumi i madh i punës, shtoj kësaj edhe punët tjera administrative që kanë qoftë në dhënien e lejeve ose kushteve ndërtimore e të tjera kurse në anën tjetër i ngarkuar edhe me procesin e menaxhimit të kontratave, vërtetë shumë, prandaj si shkak i këtyre unë kam frikë që kjo situatë dhe këto probleme / vërejtje do të na përcjellin dhe do të na paraqiten edhe në vitet në vijim, mirëpo detyrë e jona është që maksimalisht të punojmë për t'i zvogëluar qoftë gjetjet, qoftë lëshimet teknike të cilat mund të ndodhin e të cilat e të cilat në shikim të parë krijojnë një farë situatë "ju ka dhënë pak kriterë", mirëpo nëse një kompani qysh është EING cila përmendet, aktualisht është me katër-pesë projekte duke i zhvilluar në Podujevë, dhe për të thuhet kinse nuk ka qarkullim bankar, por që qarkullimi bankar është legal e publik dhe çdonjëri që hynë në ATK e gjen në formularin i cili plotësohet që është si kriter, mirëpo pse këta nuk e kanë kërkuar është përgjegjësi e tyre si komision dhe e zyrtarit përkatës të prokurimit i cili fundja është dashtë t'i mbikëqyr sepse kontratën e ka nënshkruar ai, si dhe pasi janë kryer gjitha procedurat e kam nënshkruar edhe unë atë kontratë.

Prandaj mirë është të mos ketë keqpërdorim, kjo është shumë e rëndësishme, ndërsa sa i përket keq klasifikimit, lëshimeve teknike, mandej lëshimeve për shkak të mos futjes në sistem të menaxhimit të kontratave përmes E-prokurimi, janë lëshime të cilat janë evidente, janë të shkruara edhe prej Auditori dhe është normale që ne jemi pajtuar me ato, por në rast se ndokujt i duhet kjo më hollësisht, do të thotë janë gjëra që mund të dëshmojnë me dëshmi të cilat ekzistojnë, ndërsa edhe pse kanë bërë lëshime teknike është përgjegjësia e tyre, madje dikush edhe e ka marrë atë përgjigje për këto gjëra, dhe jemi këtu ku jemi.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po filloj nga fjalimi i fundit i Kryetarit që e përmendi menaxhimin e kontratave përmes E-prokurimit, unë nuk mendoj që ato gjëra janë lënë si shkak i punëve të shumta, por ne e dimë qysh shkon këtu në Kosovë “që me u dokt kah zyra e tij pak”. Pastaj sa i përket procedurave për të cilat Kryetari e tha që kanë zgjatur, ne e dimë që ai zyrtari i prokurimit që ka qenë më herët ti pate vazhduar me atë, por kur e ke sjellë tjetrin ne të kemi thënë se nuk është duke i bërë mirë mirëpo ti ke thënë që e ke sjell si ekspert, pra e ke sjellë vetë. Tani është mirë të shikohet qysh po e rinovon shtëpinë ai, për çka dhe ku i mori ai gjithë ato para, pastaj qysh ka blerë Jeep, qysh po don të blej shtëpi tjetër, do të thotë këtu nuk është keq klasifikim.

Sa i përket asaj që Auditori i ka gjetur dy-tri kompani pa i plotësuar kushtet, mendoj që nëse si Komunë ia obligon që ai të punoj me ISO Standarde 5001 e pastaj ia dërgon një tjetër ISO 992, dhe në fund i thua se kjo mirë është, kjo është totalisht gabim sepse nuk mund t’i thuash je në rregull.

Sa i përket kompanisë EING për të cilën Kryetari e tha se ka qarkullim në ATK, ajo është e vërtetë sepse atë edhe një qytetar i thjeshtë mund ta shohë, mirëpo procedurat dihen, dhe kush ka kompani mezi nuk presin ta shohin një gabim të një kompanie që nuk e ka plotësuar ndonjë dokument dhe ta rrëzojnë atë, për ta marrë vetë punën, andaj këtë nuk mund ta thuash i nderuar Kryetar sepse te përgjigja e parë pash se ishte përgjigje tepër interesant kur e ceke që e keni dhe e keni ruajtur atë dokument, shtrohet pyetja qysh e keni ruajtur ju atë dokument, kurse ju e keni vë si kriter që duhet me pasë atë dokument, e jo ajo kompani të mos i fut dokumentet dhe mandej të marrë punën, kjo është shumë gabim dhe automatikisht është dashur të s’kualifikohet kjo kompani që nuk e ka fut atë dokument sepse ne nuk mund ta dimë a e ka ose jo qarkullimin bankar, apo mos ndoshta i ka humb të gjitha paratë në bixhoz, mirëpo dokumentin duhet ta ketë aty, nuk mund të thuash se ai ka bërë mashtrim sepse nëse e ka harruar këtë certifikatë ISO të standardit 5001 ta fut në dokumente dhe e ka futë një të standardit tjetër, do të thotë ka dashtë të bëjë mashtrim ngase është dashur t’i harroj të dyja, si dhe qysh e ka ndërruar dokumentin dhe e ka fut dokumentin tjetër, nuk është krejt e thjeshtë ashtu kjo çështje. Në dokumente nëse nuk ka qenë aty, për gjëra tjera mund të kërkojë sqarime ose dokumente shtesë dhe parashtron pyetje, por nëse harron kjo i bie sikur të thuhet (Kosova fiton por portieri mori kartonin e kuq dhe nuk mundi pastaj të fitoj), prandaj i nderuar Kryetar, kemi të bëjmë me dokument dhe ajo kompani është dashtë të fus në dokumente kur i ka sjellë, ndërsa vetëm ka thënë që e ka ndërruar, në fakt mund të kërkojë informata shtesë sqaruese por jo kështu, kurse ti Kryetar përgjigjen e dhënë duke thënë që atë dokument e kemi si Komunës sepse e kemi ruajtur, mirëpo nuk mundesh si Komunë t’ia ruash dokumentet një kompanie.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, për atë edhe ka shkuar dhe po pushon tani.

z.Ekrem Rrahmani, vazhdoi, ai po pushon Kryetar, por ashtu kisha pushuar edhe unë dhe nuk isha djersitë hiç, andaj nuk shkon ashtu nëse veç dëmtohet Komuna. Unë nuk kam hyrë t’i shikoj cilat kompani janë eliminuar dhe që i është dhënë tenderi kompanisë në fjalë, por është shumë gabim sepse është dashur që ai që plotëson kriteret ta merr tenderin, e jot të thuhet “valla ka harruar dhe e ka ndërruar certifikatën dhe se e ka qarkullimin por se ka sjellë”. Pra nëse Komuna i vë kushtet e që njëra prej tyre është sjellja certifikatës përkatëse si dhe prej ATK-së qarkullimi financiar, duhet të sjellët certifikata e ISO standard me numrin dhe shifrën përkatëse, duhet të sjellët komplet, nëse jo, komisioni duhet ta anuloj se nuk është në rregull dhe e kompletuar kompania dhe vazhdohet tutje me tjetrën.

Sa i përket ndërtimit të Stacionit, nuk ka qenë gjendje e jashtëzakonshme që të bëhet ai stacion në atë mënyrë, në fakt ne me kohë e kemi thënë që Stacioni i autobusëve po ndërtohet shumë larg qytetit dhe nuk do të funksionoj, kurse ju keni thënë shumë mirë është, madje e keni reklamuar me video duke e përhapur të gjithë duke e lavdëruar, ndërsa tani e thirrni prej zyrës një njeri i thoni hajde silli dokumentet e ndërtoje një stacion siç e keni bërë këtë tek shkolla Ekonomike, mirëpo ta kuptoni se nuk janë paratë e juaja madje edhe në shtëpi/familje nuk mund të shpenzosh pa u ulur me gjysmën e anëtarëve dhe të bisedosh.

Prandaj nuk mund të thirrësh një kompani, t'i thuash zgjeroje pak aty 10m² asfalt dhe po t'i jap 7000€, sepse janë procedurat e prokurimit se qysh thirret dikush në atë mënyrë, nuk ka qenë gjendje e jashtëzakonshme.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, meqë po na kritikoni neve për atë stacion te shkolla Ekonomike, unë po ju pyes juve shumë sinqerisht, ju ku do ta ndërtonit atë Stacion, pra më tregoni mua ku do ta bënit atë stacionin ju.

z.Isak Ejupi, theksoi, është dashtë më herët të pyesni dhe ne do t'ju tregonim, jo tani të na pyetni kur ai projekt ka përfunduar.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, po ashtu shtrohet pyetja se a kemi pasë vend ku ta ndërtojmë Stacionin e Autobusëve më tregoni, unë them se jo nuk kemi pas vend tjetër ku ta ndërtojmë Stacionin e Autobusëve dhe ju e dini shumë mirë se më parë është nisur një Palestër sportive atje të bëhet e që nuk është bërë, por a e dini arsyen pse nuk është bërë, sinqerisht nuk dua të kthehem mbrapa sepse mund të mos jeni përgjegjës ju disa që nuk keni qenë në atë kohë në asamble, ndoshta dikush edhe ka qenë por nuk dua të kthehem mbrapa e ceka. Unë mendoj që është bërë zgjidhje e mirë me Stacionin e Autobusëve, mirëpo ajo çka na duhet tani është trafiku urban që të bëhet e që patjetër dhe domosdo duhet ta bëjmë, nuk kemi zgjedhje tjetër, duhet ta bëjmë, përndryshe në atë lokacion ku ka qenë në të kaluarën Stacioni i Autobusëve nuk ka pas vend për Stacion, të gjithë e dimë dhe për atë arsye nuk është investuar.

z.Ekrem Rrahmani, nga vendi kërkon nga Kryetari t'jua tregoj mënyrën se qysh e keni thirr operatorin për ta ndërtuar këtë stacionin te shkolla Ekonomike.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, unë nuk e di a është apo jo në rregull, është gjetje që nuk është në rregull, mirëpo ai zotëriu si udhëheqës i asaj zyre, nëse nuk ka qenë në rregull nuk është dashtë të inicioj, pavarësisht qejfit të z.Bahri Selimit (drejtori i DSHPMSh) apo kërkesës time nëse kam kërkuar, mirëpo që është menduar se është e nevojshme të bëhet ai stacion dhe është bërë. Nëse kemi bërë shkelje dhe atë e ka evidentuar Auditori, ai zotëria (udhëheqësi i prokurimit) nuk është dashur të lejoj të ec tutje pavarësisht kërkesës së Drejtorisë përkatëse që është bërë për inicim të procedurës dhe unë nuk e di cila është arsyeja, ndoshta që ka qenë procedurë e negociuar sepse negociimi nënkupton diçka pak më të shpejtë dhe urgjente që bëhet, kurse ai vlerësuar që është urgjencë të bëhet dhe është bërë, në anën tjetër është evidentuar si shkelje, por stacioni që është bërë, aty është, asfalti aty është, skajoret aty janë (nëse është hëngër pitja, tepsia është), nuk ka mund të shkoj askund, përndryshe do ishte shumë keq dhe shumë dëshpëruese nëse do të thonim e kemi bërë një parking stacion dhe aty të mos ishte parkingu e as stacioni, ndërsa qenka bërë një lëshim në procedurë, ejani të shohim së bashku dhe të mos bëjmë gabime tjera, të mos i përsëritim gabimet e tilla, por mos e dramatizoni shumë këtë çështje se nuk janë 1 milion euro, as 100,000€ por janë rreth 7,000€.

z.Enis Dervisholli, theksoi, është shqetësuese Kryetar ajo sepse në atë vend ai ndërtim ka mund të bëhet me 1,000€, por është bërë me 7,000€, po në pjesë më të mëdha çka jeni në gjendje të bëni, kjo është shqetësuese Kryetar. Sa kushton një metër asfalt.

Kryetari i Komunës, pyet parafolësin se a është inxhinier apo çka je, përndryshe qysh e thoni që ajo pjesë e asfaltit bëhet me 1,000€. Ndërsa çmimet e asfaltit unë nuk e di.

z.Enis Dervisholli, theksoi, aty janë 15m² dhe nuk është ai projekt për 7,000€. Për këtë është mirë të thoni që nuk është bërë mirë, të kërkonin falje për këto shkelje dhe që nuk do të ndodhin më këto gjëra.

Po folim për 7,000€, po në vlera më të mëdha çka jeni në gjendje të bëni Kryetar, drejtorë apo pavarësisht kush, kur jeni në gjendje me 7,000€ të bëni këso shkelje edhe pse nuk ka qenë urgjencë. Mirëpo prap të themi që mirë që është bërë ai stacion, ndërsa për çmim 7,000€ ju betohem në Zot që nuk ka kushtuar.

Kryetari i Komunës, sërish i përgjigjet parafolësit, theksoi, unë nuk e di a janë 2,000€, 5,000€ apo 7,000€, sepse nuk jam i thirrur të di atë punë, mirëpo nuk e besoj që është lëshuar ndokush në atë nivel që po mendon ti që për një Stacion të Autobusëve të fitoj ai sepse nuk fitohet në atë Stacion.

Sa i përket çmimit, nuk e di dhe nuk guxoj as të them që ka kushtuar ose nuk ka kushtuar aq sepse nuk e di dhe nuk jam inxhinier, mirëpo dikush e ka bërë një paramasë dhe një parallogari e këto nuk i bënë as Kryetari i Komunës e as drejtori i Drejtorisë, por i bëjnë inxhinierët, këta që i kemi, nuk i bëjmë ne këto, dhe gjithmonë dikush e merr një lloj të përgjegjësisë që e shkruan atë paramasë dhe parallogari sepse nënshkruhet edhe një deklaratë në betim nga ata, përndryshe po të isha unë inxhinier nuk kisha ndej fare këtu por do merrja 3,000€ rrogë diku në një kompani private, ky është problemi, kështu që mos i merrni aq me betim në Zot sepse nuk i dinë as ti as unë shumë këto gjëra.

z.Enis Dervisholli, sërish rreth kësaj çështje, theksoi, çfarë po thua Kryetar, përse të mos e bëjnë ekspertët atë. E përsërisë që kur ti 7.000€ i ke paguar aty, çfarë je në gjendje të bësh me projekte tjera.

Ai projekt 7,000€ nuk ka mundësi të kushtoj.

Në vazhdim replika dhe kundër replika në mes;

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit - DSHPMSH, i cili nga vendi i drejtohet parafolësit, ndër të tjera, se nuk je ti kurrfarë eksperti në këtë fushë që ndërhyjnë vazhdimisht në këtë çështjen e ndërtimit të Stacionit të Autobusëve të shikolla Ekonomike dhe se nuk e din fare çka është ndërtuar aty si dhe nuk i din çmimet e as punët e kryera aty, por vetëm fol ashtu sa për të thënë diçka, ti veç me sy e sheh atë vend Stacion sepse asnjëherë nuk ke dalë në atë vend dhe nuk e din se çfarë është punuar aty. Pra nuk je kurrfarë eksperti ti në këtë fushë që të vlerësosh as çmimin, as punët, as procedurat e as asgjë, kështu mos ndërhy vazhdimisht sepse nuk kupton në këtë çështje....., dhe

z.Enis Dervisholli, i cili insiston në atë se ai Stacion si i tillë nuk ka mund të kushtoj 7,000€ dhe nuk është dashtë të zhvillohet procedurë me negociim sepse nuk ka asgjë për të fshehur dhe se as nuk ka qenë gjendje e jashtëzakonshme dhe se atë çështje Auditori e ka gjet si gjetje. Ai Stacion nuk ka mundur të kushtoj mbi 2,000€, e di unë këtë sepse me punë të ngjashme punoj që një kohë të gjatë, andaj mos bëni shaka sepse nuk kushton aq shumë për një vend të vogël sikurse ai Stacion. Unë me firmën time do ta kryeja për 1,000€ ose ose edhe pa para, veç është dashtë të më tregoni, nuk është në rregull kjo farë punë kështu, duhet t'ju vie marre për atë, e jo të reagoni kështu.

(Vëmendje: mund të ketë pasë edhe shkëmbime tjera të fjalëve mes tyre por që ka qenë e pamundur të evidentohen të gjitha çka janë thënë për shkak se vazhdimisht janë thënë dhe kthyer replika mes vete)

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, diskutimet rreth kësaj çështje konsideroj se përfunduan dhe se ju lutem ta respektoni rregulloren e punës së Kuvendit ngase nuk lejohet të ketë diskutime, kohëzgjatje dhe replika e kundër replika të tilla çfarë ishin, tani fjalën e ka z.Besim Latifi rreth pikës së rendit të ditës dhe kjo çështje konsiderohet se përfundon.

z.Besim Latifi, theksoi, unë po e shoh që po tentohet të relativizohet komplet kjo çështje. Ajo çka e ceku Kryetari është që s'po na bie tash tamam ligji, sa kuptova unë si në çështjen e lejeve ndërtimore, si në çështjen e kontraktimit të projektit në mungesë të fondeve po thoni që këto ligje nuk po na bien tamam. Ligji është shumë i qartë dhe të tregoj që para nënshkrimit të një kontrate me një operator ekonomik duhet pasur mjete të destinuara për atë projekt, është ligjore kjo punë. Do të thotë shefi i prokurimit shkon te drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e merr konfirmimin që i ka mjetet në llogari për ta filluar procedurën e prokurimit, kryhen procedurat e prokurimit, vie koha e lidhjes së kontratës me operatorin

ekonomik, shkon e merr konfirmimin e dytë me çka e fut në përgjegjësi dhe implikon edhe Kryetarin e Komunës për një obligim të tillë. Në qoftë se nënshkruhen kontrata kundërligjshëm në mungesë të mjeteve financiare po i bie që e kemi shkel ligjin, do të thotë po shkelet ligji, po investohet pa e respektuar rregullën ligjore, andaj për atë edhe raporti vie kësisoj.

Tek çështja e lejeve ndërtimore, është ligji për ndërtim dhe unë nuk e di pse po diskutohet për zbatim të ligjit, në qoftë se ai zotëria (ndërtuesi) nuk i plotëson kërkesat brenda afatit 30 ditësh, i refuzohet leja ndërtimore dhe ri aplikon sërish pastaj, pse duhet të vonohet 104 ditë, refuzohet leja ndërtimore, ri aplikon në rregull pastaj, këto janë ligjet që i kemi, të mira e të këqija, me këto ligje duhet punuar për të mos vije raporti kësisoj, por nuk është në rregull të diskutohet në nivel të tillë dhe të relativizohet komplet situata, janë këto 7 shkeljet që nuk i keni përmirësuar dhe a ka mundësi të përmirësohen.

U cek dhe u bë shumë zhurmë për një kontratë të negociuar, keni pas vërejtje të tilla edhe në raportin e kaluar sa kujtoj ka qenë për barna dhe reagenca ashtu diçka, por ka pas edhe kontrata të negociuara dhe ata njerëz janë vendosur prej juve, qoftë ai ish shefi apo ky shefi i prokurimit, do të thotë ky pushtet i ka vendosur dhe ata njerëz duhet të shkojnë në përgjegjësi.

Unë e besoj që Raportin i Auditorit me gjitha këto vërejtje është një zyrë e veçantë atje që e dërgon në Prokurori edhe ata zyrtarë të cilët kanë qenë kompetentë sigurisht se duhet të ballafaqohen me ligjin sepse në qoftë se nuk respektohet ligji kemi tejkalime të autorizimeve ligjore dhe Kodi Penal për këtë është që kur kemi tejkalime të autorizimeve ligjore. Prandaj nuk është mirë të provohet të mbrohet jo ligjshmëria, unë e kuptoj që në projekte mund të ketë gjëra të tilla se ku të merren mjetet siç edhe u cek dhe në rregull është kjo, mirëpo hyrja në obligime kontraktuale në këtë variant me shuma kaq të mëdha është shkelje goxha e madhe, dhe për atë Auditori e ka cek saktë aty ligjin e buxhetit dhe ligjin e prokurimit që është tejkualuar dhe nuk është respektuar, andaj është mirë të respektohet dhe të punohet konform rregullativës ligjore, por atë janë bërë ligjet për të rregulluar çështje dhe të punohet në bazë të tyre, ndërsa ai i cili bie në kundërshtim me këto ligje sigurisht se ballafaqohet pastaj me instancat e drejtësisë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, deri në këtë vit është lejuar inicimi procedurave edhe nëse nuk është komplet shuma buxhetore dhe kemi iniciuar deri në këtë vit, mirëpo tani nga ky vit pa i pas gjitha mjetet buxhetore për projektin nuk mund të nisët procedura fare.

Absolut nuk diskutohet se a duhet të respektohet ligji apo nuk duhet sepse për atë qëllim është nxjerrë dhe kemi obligim të gjithë të respektojmë ligjin, mirëpo siç e ceka që deri në këtë vit është lejuar mundësia e inicimit të një procedure edhe nëse të gjitha mjetet nuk kanë qenë të zotuar. E potencova që ato kanë qenë projekte dyvjeçare ose trevjeçare nëse nuk gabo, projekti i Parkut Bujqësor edhe Projekti i Varrezave qenkan projekte trevjeçare të cilat janë nisë si procedura me një shumë më të vogël mjeteve buxhetore për ta bërë të mundur arritjen deri te shuma përkatëse e mjeteve buxhetore e planifikuar për këto projekte, e që kjo është ndoshta një tolerancë që ka qenë dhe që ka krijuar këtë mundësi, por Auditorët e kanë gjetur si lëshim në proces, prandaj prej këtij viti asnjë procedurë nuk mund të filloj pa pasë mjete buxhetore të zotuar e që mendoj se është më e mirë kjo, sepse ajo situatë ka bërë që Auditori ta gjejë si gjetje.

Çështja e lejeve ose kushteve ndërtimore, kthimi në pikën zero i atyre projekteve si mundësi ekziston ngase mund të bëhet kërkesa, refuzohet dhe kthehet në pikën zero, mirëpo problemi ka qenë që të mos detyrohen edhe njëherë ata ndërtues me gjithë dokumentacionet që kanë t'i kthejmë në pikën zero sepse çdo kthim pikën zero, siç e dim pastaj krijon edhe goxha një kosto qoftë të dokumentacioneve që duhet përgatitur qoftë të tjera sa i përket lejes ose kushteve ndërtimore çka do qofshin ato. Këto situata e kanë zgjatur afatin kohor për të ardhur deri te përmbyllja e një lënde, por që normal tani për sy të Auditorit tejkalohej afati 30 ditor, por unë besoj dhe jam shumë i bindur që nuk ka asnjë Komunë në Kosovë që mund ta zë këtë afat prej 30 ditësh për të kryer lëndët ose që mund të mbërrij krejt këtë procedurë sepse ka edhe zhagjitje prej operatorëve derisa sjellin një dokument mund të kalojnë 10 ditë dhe kalon edhe kalon

pjesa tjetër derisa të fillohet të shqyrtohet edhe njëherë. Pra ju them që në këto çështje duhet pas parasysh që kemi stërngarkesë. Ndoshta mund të jetë ajo që tha Ekrem Rrahmani nuk e di, por problemi është që ka edhe zvarritje dhe stërngarkesë të inxhinierëve që duhet t'i trajtojnë këto lëndë sepse çdo kërkesë që vie për kushte ose leje ndërtimore domosdoshmërisht duhet angazhuar njërin prej inxhinierëve, pastaj çdo kërkesë që vie në procedurë të tenderimit për t'u vlerësuar duhet të paktën një inxhinier të jetë në komision për t'a vlerësuar një lëndë, pra i kanë nga 7, 8 deri në 10 lëndë të ngarkuara një person / zyrtar andaj nuk duhet bërë shumë të lehtë këtë punë. Unë absolut nuk kam qëllim t'i arsyetoj sepse lëshimet janë lëshime dhe ashtu quhen e që nuk është mirë të ketë, por se a kanë ngarkesë e themi që po ka, sepse shtu këtu që plus atyre që i ceka është edhe mbikëqyrja në terren si dhe shumë e shumë gjëra tjera siç janë pranimi i projekteve në terren e të tjera, andaj gjitha këto janë volum i punës që kanë ngarkesë, përndryshe po të kishim 20 apo 50 inxhinierë në punë, sigurisht do të bënim ndarjen e punëve në numër më të vogël dhe ndoshta më lehtë do të mundnim të azhurnojmë punët, mirëpo justifikim nuk ka për shkelje të ligjit, krejt këto që po i themi, po i themi në kuptimin thjeshtë njerëzor, por ligji nuk guxon të shkelet pavarësisht krejt këtyre ngarkesave që munden të jenë në punë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ne kemi parë që ata inxhinierët janë shumë të zënë sepse po i shoh që në disa projekte janë menaxher, në disa mbikëqyrës të projekteve, i dim këto, mirëpo është mirë të merret një iniciativë që të dërgohen pak më shumë punëtorët në trajnime për këto kontrata, të paktën për komisione, e jo të jenë ata në çdo komision dhe të rëndohen vetëm ata. Përndryshe ne po e dimë që inxhinierët edhe ndoshta edhe nuk vijnë këtu në punë sepse po kanë punë edhe privat, madje edhe po të kërkojnë inxhinierë të ndërtimtarisë nuk është se aplikojnë sepse e shohin veten pak më të zotët e shkojnë në privat, nuk vijnë këtu për 500 apo 600€, prandaj është mirë të dërgohen në trajnime edhe zyrtarë tjerë për t'i trajtuar këto lëndë.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në Rregulloren e punës shkruan që duhet të përcjellë se kush po e kërkon fjalën dhe zakonisht kjo të bëhet prej administratës, por ne këtu nuk kemi administratë speciale e profesionale për t'i përcjellë këto, andaj i nderuar kolegë Isak Ejupi ka mund të jetë lëshim ky edhe pse zakonisht ju vërej kur e kërkon fjalën.

z.Isak Ejupi, theksoi, po përpiqem të jem i arsyeshëm zotëri Kryesues, mirëpo unë thuajse 10 herë e kërkoja fjalën për të parën herë kurse të tjerët morën fjalën së paku nga dy herë, nëse ka diçka personale në këtë aspekt urdhëroni të lutem më trego, nuk është problem.

Krejt ajo çfarë unë po dua të them është një shqetësim që në gjithë këtë debat po shoh se është relativizim i gjetjeve të Raportit të Auditorit e që mua më bën të kuptoj që edhe Raporti i Auditorit për vitin 2026 do të jetë i njëjti, do të thotë nëse ne vazhdojmë t'i injorojmë këto gjetje dhe vazhdojmë t'i trajtojmë me arsyetime të ndryshme, sigurisht që raporti i radhës do të jetë po ashtu i kualifikuar dhe kjo nuk na mundëson neve të kemi një performancë pak më të mirë ose shumë më të mirë se sa ato aktuale dhe të marrim grande dhe të kemi një performancë të mirë e që ne jemi të interesuar absolutisht të gjithë.

Pastaj këto vërejtje që po i japim janë në kuadër të asaj që të ngritët niveli i performancës dhe funksionimit të Komunës në përgjithësi. Ka edhe shumë gabime dhe lëshime tjera në këtë raport, por janë të evidentuara këto që janë. Unë po them sinjerisht që nuk duhet neglizhuar dhe nuk duhet relativizuar këto çështje, por duhet me u marrë në mënyrë aktive që këto gjetje të mos përsëriten në vitet pasues.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, po e përsëris edhe një herë që nuk është qëllimi të relativizohet as të zbutet sepse këto janë gjëra të shkruara bardhë dhe zi dhe ne kemi obligim t'ju përgjigjemi pozitivisht dhe të punojmë shumë për t'i mënjeluar në mënyrë që të mos përsëriten.

Qëllimi jonë është të bëhet përpjekje t'i kryejmë ato rekomandime dhe të mos përsëriten e që prej trembëdhjetëve ishin shtatë që janë përsëritur, gjashtë prej tyre janë krye që do të thotë se as në vitin e kaluar nuk janë relativizuar dhe as në këtë vit nuk është qëllimi t'i relativizojmë, por qëllimi është t'i adresojmë dhe për t'ju bindim juve që kemi për qëllim t'i zbatojmë praktikisht, përndryshe po sa e kam

pranuar këtë dokument unë kam marrë veprime, nuk është që nuk kam marrë veprime ose që nuk kemi qëllim t'i kryejmë, madje kam qëllim edhe fort bile për t'i kryer dhe t'ju shkoj deri në fund.

Çështja e cekur nga parafolësi, ato çështje domosdoshmërisht është një vijë që shkojnë diku dhe dikush do të pyetet besoj për këto gjëra, sepse dikush pyet dhe për këtë jam i bindur sepse çdonjëri që bën lëshime duhet ta dijë që pyetet për ato lëshime, prandaj nuk është qëllimi relativizimi, por qëllimi është të zbatohen në praktik me fakte.

Jeni në dijeni se rekomandime ka pas edhe në të kaluarën, madje goxha shumë, por veprime drejtpërsëdrejti tek të implikuarit në ato lëshime kanë qenë shumë të rralla, kurse tani këtu veç kemi veprimet e para që janë marrë.

z.Enis Dervisholli, theksoi, i nderuar Kryetar, të paktën po e pranoni faktin që jeni kampion sa i përket dështimeve. Këtë nuk po e them unë, por e thotë Raporti i Auditorit, do të thotë jeni kampion.

Kryetari i Komunës, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, duhet lexuar gjitha Raportet e komunave të Kosovës për me i dit atë që e thua ti.

z.Enis Dervisholli, vazhdoi, Raporti po thotë atë Kryetar, nuk po e themi. Për të gjitha shkeljet, madje edhe për shkeljen e bërë me procedurën e negociuar 7,000€ për investimin përkatës, Raporti i Auditorit po e thotë Kryetar, nuk po e them unë. Kor do që dëshironi dalim e shikojmë dhe e testojmë sa ka mund të kushtoj ai Stacion, është duke të mashtruar dikush me çmime të larta Kryetar, andaj është mirë të shikosh aty ku janë ato defekte dhe t'i përmirësosh si dhe ato investime t'i bësh diku tjetër Kryetar.

Për punë të mira ku keni bërë ju përgëzoj, po për shkelje i nderuar Kryetar ne kemi obligim t'ju tregojmë se ku janë ato shkelje, mirëpo edhe se ku janë punët e mira do t'ju përkrahim dhe jemi dakord, përndryshe ne të gjithë jemi këtu jemi për të bërë punë të mira, nuk kemi ardhur për punë të këqija.

Sot e gjithë dita shkoj për të bërë një punë të mirë, për t'ju treguar qytetarëve se a është punuar mirë apo nuk është punuar mirë.

Konstatohet e përfunduar kjo pikë e rendit të ditës.

6. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia kadastrale P-71712029-00209-0 në sipërfaqe 38882 m², ZK Lupç i Poshtëm

6.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00209-0, në sipërfaqe 38882m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

z.Bahri Selimi, U.D. drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim-DSHPMSH, theksoi, drejtoresha e DPKGJ znj.Saranda Stublla, për shkaqe shëndetësore i'u desh të shkonte, andaj po e prezantoj unë këtë pikë të rendit të ditës, konkretisht këtë propozim vendim për miratimin paraprak për dhënien e shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësia kadastrale 209-0 në sipërfaqe 38882m² Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, gjithashtu krahas tij keni edhe propozim vendimin për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësia kadastrale që e potencova më herët.

Nga Shoqëria Civile kemi dy aplikime; është Nebih Balaj dhe Shqipdon Rushiti, dhe tani mundësia është që Kuvendi të përzgjedh njërin prej tyre, pra ju duhet të votoni se cili ta përzgjedhni. Ndërsa sa i përket anëtarëve nga Ekzekutivi në këtë komision, propozojmë të jenë anëtar drejtori z.Shuajb Blakçori dhe drejtoresha znj.Valbona Ibishi.

z.Besim Latifi, theksoi, në një prej mbledhjeve të kaluara kur është diskutuar për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone, ne kërkuam që nëse është për një projekt investiv i cili krijon mundësi për të gjeneruar vende pune edhe për të përfutur qytetarët nga ai investim, jemi për ta dhënë atë pronë në shfrytëzim, pavarësisht kohëzgjatjes e cila është diskutabile. Për anëtar në komisionin përkatë propozojmë z.Enis Dervishollin.

z.Fatri Zhitia, theksoi, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës dhe njëkohësisht ftojme dhe këshilltarët tjerë që ta mbështesin këtë pikë të rendit të ditës.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën për propozim vendimin për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësia katastrale P-717120229 00209-0 në sipërfaqe 3882m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 20 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent, me 19 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë Të Përmbajtur, miratohet propozim vendimi për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, Njësia katastrale P-717120229 00209-0 në sipërfaqe 3882m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim ju sqaroj se janë dy parcela që kanë kaluar në dhënien shfrytëzim në atë lokacion që gjendet në ZK të fshatit Lupç i Poshtëm, e që njëra parcelë ka kaluar në një seancë më herët, dhe është kjo këtu e që kemi investitorin për autobus elektrik i cili është një bashkatdhetar i joni, dhe është goxha një investim i madh që planifikohet të bëhet.

Do t'ju lusja krejt çka jeni anëtar/e të komisionit vlerësues qoftë nga Ekzekutivi qoftë nga Kuvendi, por edhe anëtarin e Shoqërisë Civile, që të krijoni mundësitë për shpalljet publike sa më shpejt të jetë e mundur sepse ata janë të gatshëm të investojnë dhe të bëhet një fabrikë aty e cila planifikohet të punësojë diku mbi 250 të punësuar duke qenë një kapacitet investues që është i pari në këtë pjesë që bëhet, kështu janë fjalët, kështu është edhe projekti, andaj ju lus që të mos neglizhohen gjërat por të bëhet shpallja publike sa më shpejt që është e mundshme. Sot po shqyrtohet si propozim vendim, miratohet dhe pastaj presim ligjshmërinë e vendimit nga ana e Ministrisë dhe po sa të vije ligjshmëria prej Ministrisë përkatëse, menjëherë të iniciohen procedurat e shpalljes publike në mënyrë që të ecë si projekt sepse është projekt shumë i rëndësishëm, fillon projekti pastaj dhe ndoshta përfitojnë njerëzit nga ky investim i atij investitori.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kjo ishte arsyeja pse unë abstenova, pra mënyra qysh ka ardhur për mua është gabim, kjo sepse në qoftë se është investitori i madh ka të drejtë Kryetari të negocioj dhe ta sjellë këtu në Kuvend, mirëpo në momentin që bën komision atë e fut në konkurrencë pastaj dhe ai investitor më nuk llogaritet që është i paprekshëm sepse mund dikush tjetër të konkurroj me më shumë dhe ta marrë atë pronë në shfrytëzim, pra ky është gabim.

Pra nëse është investim i madh, e besoj ligjin e din Kryetari se cilat kontrata ka të drejtë ai vet të kryej pa i sjellë në Kuvend, por përmes negocimit, nëse ai (investitori) ka 10% të buxhetit të investimeve kapitale e që investimet kapitale janë diku rreth 9 ose 10 milion euro, e që i bie se duhet të investoj të paktën 100,000€ në atë pjesë, Kryetari e ka të drejtën e plotë të negocioj dhe të kërkoj llogari prej tij, përndryshe por sa të futet në konkurrencë ajo pronë, mund ta merr dikush tjetër për gjëra tjera. Prandaj nëse tani bëjmë komision vlerësues dhe paraprakisht po e dim se kujt do t'ia japim atë pronë, kjo pastaj madje është edhe diqysh si mbrapsht.

Pra unë e arsyetova se për çka isha dhe votova Përmbajtur (Abstenim) sepse ke mundur të mos e futësh në konkurrencë atë person nëse është investitor serioz dhe dëshiron ta marrë atë pronë në shfrytëzim, e që mendoj se në atë pronë ka punë goxha shumë, madje vetëm therra (shkurre) me heq nga aty ka mjaft.

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë kalojmë te nënpika që është propozimi për formimin e komisionit vlerësues. Nga Ekzekutivi janë propozuar znj.Valbona Ibishi dhe z.Shuajb Blakçori, nga Kuvendi janë propozuar z.Enis Dervisholli edhe Fatri Zhitia nëse s'gabo ashtu e mora këtë emër. Tani para se ta hedh në votim formimin e këtij komisioni si tërësi, ne kemi dy kandidat të propozuar

ose nominuar nga sektori joqeveritar që janë z.Nebih Balaj dhe z.Shqipdon Rushiti e që na duhet të përcaktohem për njërin prej tyre që të jetë anëtar i komisionit në fjalë.

z.Fatri Zhitia, theksoi, për parcelën që jemi duke diskutuar, në komisionin paraprak është kolegu z.Kasib Bashkota andaj është mirë ndoshta të vazhdojmë me të njëjtin meqë është për të njëjtën parcelë thuajse dhe kjo të jetë vetëm vazhdim i saj.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po vërejë se kemi një propozim që të jetë i njëjti komision sikurse herën e kaluar, nëse pajtoheni mund ta hedh në votim.

z.Besim Latifi, theksoi, i nderuar Kryesues, së pari hedhi në votim propozimet e Kuvendit, pastaj atë nga Ekzekutivi dhe mandej vazhdon me kandidatët nga Shoqëria Civile.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani a ka propozime për ndryshim të përbërjes së anëtarëve të këtij komisioni apo të mbeten të njëjtit.

z.Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i LVV-së propozojmë z.Kasib Bashota që të jetë anëtar i komisionit, mirëpo nuk do të thotë që nuk mund të bëhet ndryshim i komisionit, ta kemi parasysh këtë, dhe meqë kemi dy kandidat prej OJQ-ve ne duhet të votojmë për njërin prej tyre duke marrë parasysh se ai i cili ka qenë më herët nuk ka aplikuar fare. Pra nga LVV propozojmë sërish z.Kasib Bashota, pro nuk do të thotë që nuk mund të ketë ndryshime prej Grupeve tjera në raport me anëtarët që ishin në komision paraprak për parcelën në fjalë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në rregull, atëherë vetëm të përsëriten ata emra edhe njëherë në mënyrë që t'i votojmë. z.Kasib Bashota ishte njëri prej tyre nga radhët e LVV-së si i propozuar.

z.Lulzim Pollomi, theksoi, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, propozojmë znj.Mimoza Abdullahu për anëtare në këtë komision.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nga Grupi i LDK-së sa kujtoj nuk keni pranuar të keni anëtar në komisionin vlerësues për pronën në fjalë, nëse s'gaboju ashtu ka qenë.

z.Besim Latifi, theksoi, unë e sqarova edhe në fjalën tim pak më parë që ne kemi qenë kundër që të jepet në atë formë ajo pronë në shfrytëzim për 99 vite pa e ditur destinimin e saktë për çka, diskutimet janë në procesverbale dhe mund të evidentohet ku kam thënë se në qoftë se kjo pronë jepet për investime të cilat gjenerojnë punësim edhe të ardhura për Komunën e Podujevës, ne do ta mbështesim, mirëpo sot jemi pikërisht në një situatë ku po na prezantohet një projekt i tillë. Unë e dhashë mbështetjen por edhe propozimin për anëtar të komisionit për këtë çështje, besoj mjaftueshëm jam i qartë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë nga radhët e LVV-së po mbetet z.Kasib Bashota, nga Ekzekutivi i Komunës z.Shuajb Blakçori dhe znj.Valbona Ibishi, si dhe kemi dy propozime nga Shoqëria Civile që janë z.Nebih Balaj dhe z.Shqipdon Rushiti,

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në vend të propozimit nga Grupi i LDK-së që ishte z.Enis Dervisholli, ne ta për anëtare në këtë komision e propozojmë znj.Arnisa Sylejmani. Kjo për shkak të barazisë gjinore.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë kalojmë te votimi për kandidatët e nominuar nga Shoqëria Civile, fillimisht e hedh në votim kandidatin e nominuar nga sektori jo qeveritar lokal z.Nebi Balaj.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 21 anëtarë/e të Kuvendit sa ishin prezent, 11 vota ishin Për, asnjë Kundër, 1 votë E Përmbajtur, të tjerët nuk votuan, që z.Nebih Balaj të jetë anëtar i komisionit nga radhët e sektorit jo qeveritar lokal.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim propozimin që z.Shqipdon Rushiti të jetë anëtar i komisionit vlerësues përkatës nga radhët e sektorit jo qeveritar lokal.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se për z.Shqipdon Rushitin nuk votoi Për, asnjë anëtarë/e i Kuvendit që të jetë anëtar i këtij komisioni nga radhët e sektorit jo qeveritar lokal.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë konstatoj se nga 21 anëtar/e sa ishin prezent në sallë, me 11 vota Për, asnjë votë Kundër, 3 vota Të Përmbajtura, z.Nebih Balaj merr votat e mjaftueshme të jetë anëtar i komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00209-0, në sipërfaqe 38882m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.

Tani vazhdojmë me propozimet në tërësi për anëtar/e të komisionit në fjalë, dhe atë; nga radhët e Kuvendit z.Kasib Bashota dhe znj.Arnisa Sylejmani, nga Ekzekutivi i Komunës z.Shuajb Blakçori dhe znj.Valbona Ibishi, dhe nga Shoqëria Civile z.Nebi Balaj, andaj nëse nuk të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën unë e hedh në votim formimin e këtij komisioni sipas propozimeve të paraqitura dhe propozim vendimit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se nga 21 anëtar/e të Kuvendit sa ishin prezent në sallë, me 20 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë Të Përmbajtur, miratohet propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës -Njësia Kadastrale parcelë: P-71712029-00209-0, në sipërfaqe 38882 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm, sipas materialit përkatës të dërguar me konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së e datës 26.06.2026 dhe prezantuar edhe sot në fillim të kësaj mbledhje, në këtë përbërje:

- 1. znj.Valbona Ibishi-Azemi, nga Ekzekutivi i Komunës*
- 2. z.Shuajb Blakçori, nga Ekzekutivi i Komunës*
- 3. z.Kasib Bashota, nga Kuvendi i Komunës*
- 4. znj.Arnisa Sylejmani, nga Kuvendi i Komunës*
- 5. z.Nebih Balaj, nga sektori joqeveritar lokal*

7. Rishqyrtimi i Vendimit nr.prot.01-463/06-0019215/26 të datës 31 mars 2026 - Shkresa e MAPL-së nr.020-270/10 datë 12.03.2026

z.Isak Shabani, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në fakt këtë pikë të rendit të ditës unë e arsyetova në fillim të mbledhjes kur e propozova të hyjë si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, konkretisht kemi të bëjmë me rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0019215/26 të datës 12.03.2026 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit, prandaj në bazë të asaj që e potencova pasi tani më kemi edhe mendimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, urdhëroni nëse ndokush dëshiron të jap sqarime rreth kësaj çështje apo të merre fjalën për diskutim.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, lidhur me këtë çështje problemi qëndron në aspektin pronësor sepse ato parcela ku janë të ndërtuara objektet përkatëse e që janë ndërtuar në vitet e 70-ta apo nuk e di sakt kur janë ndërtuar, ato prona ende ishin në emër si pronë e dikujt prej familjes Blaku, do të thotë për gjithë këto vite aty funksionojnë institucionet shëndetësore ashtu siç jemi në dijeni të gjithë, ndërsa pronësia asnjëherë nuk është ndryshuar. Se çfarë ka ndodh me atë pronësi dhe qysh ka mbete në emër të personave privat është problem ta dimë, a ka pas ndonjë ndryshim më vonë apo çfarë sepse tani dokumentacionet arkivore mungojnë dhe për atë pronë nuk mund ta dimë sakt, por është mëse normale që kur e kemi gjete Fletën Poseduese kemi parë që është në emër të personave privat dikujt nga Familja Blaku nuk po e di sakt emrin ose emrat por janë të evidentuar në dokumentacione e që besoj i keni pasë edhe ju si asambleistë kur është votuar, dhe tani ligjshmëria e ati vendimi nuk ka mundur të kalojë për shkak se prona nuk është në emër të Komunës, prandaj ne mund të diskutojmë sado që dëshironi këtu por realiteti është ky që e potencova.

Institucioni i Shëndetit Mendor thuajse tani veç është funksionalizuar dhe ata janë duke punuar aty, objekti është i yni si Komunë, mirëpo tani sa kam informacione por nuk e di sa është e sakt, Gjykata Kushtetuese ka marrë një vendim sipas të cilit të gjitha ato prona të cilat për 20 vite e më shumë janë shfrytëzuar dhe nuk ka pasë ndonjë kontest, në një formë me një vendim të veçantë mund të kalojnë komplet në pronësi të atyre që mund ta kenë shfrytëzuar, andaj nëse veç është diçka e tillë do të thotë ajo pronë në mënyrë legale duhet të kalojnë në pronës të shfrytëzuesve apo të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevës.

Ky nuk është i vetmi problem sepse kemi edhe shumë probleme tjera të kësaj natyre të cilat jeni në dijeni që ende janë me konteste të tilla pronësore dhe tani na duhet që gradualisht çka të mundemi të bëjmë përmes inicimit të procedurave për ta bërë të mundur kthimin në pronësi të Komunës.

Një prej problemeve të tilla është edhe parkingu nëntokësorë për të cilin tani e rreth 3 vite nuk po mund t'i fillojmë procedurat për shkak të 5 ari sipërfaqe që mbeten në pronësi private brendapërbrenda qendrës së qytetit të Podujevës ose sheshit në të cilin është investuar në të, kështu që shpresojmë të dalin sa më pak telashe të tilla mirëpo janë punë të cilat ndoshta është dashtë të kryhen paera 30-40 viteve dhe të rregullohen si çështje, ndërsa pse nuk janë rregulluar dhe pse ka ndodh kjo problematikë deri këtu ndoshta është vështirë të vijmë deri te ndonjë konstatim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kur është sjellë kjo si pikë e rendit të ditës e kemi përkrahur dhe kemi votuar për, mirëpo është mirë të jeni më serioz atëherë kur të sjellën pikat e rendit të ditës dhe të nxjerrën ato çështje në kadastër sepse nëse drejtoresha e sjellë një pikë të tillë dhe ajo nuk e din këtë, unë t'ju them të drejtën as që jam kujtuar se aty është pronë private, por drejtoresha është dashtë ta sqaroj dhe ta sjellë me kohë, përndryshe tani po bëjnë edhe ndryshime të tilla dhe nuk e di ku dhe si e kanë gjetë një kanal të tillë e që nëse vazhdon kështu duket se as sheshi i qytetit nuk do të del në emër të Komunës sikurse që është sheshi "Ali Ajeti" ku 5 ari kanë dalë të jenë në pronësi të personit privat, tani edhe QKMF me gjithë atë hapësirë dhe gjithë atë ndërtesë ku një pjesë del të jetë në pronësi private kur e dim që shumë vite para luftës ekziston QKMF aty dhe janë ndërtuar ato objekte kurse tani të del pronësi private dhe kontest gjyqësor, përndryshe nëse fillohet me një trend të tillë ne nuk do të mund të investojmë asgjë por vetëm do të mbetemi duke paguar prona sepse ata persona pastaj po kërkojnë miliona euro kompensime, apo ndoshta të fillohet me rrënimin e tyre do të ishte një katastrofë në vete.

Ne Grupi i LDK-së do të votojmë për anulimin e vendimit në fjalë edhe pse nuk di a mund ta quajmë vendim pasi nuk e ka marrë formën e plotë, por që tani po votojmë për anulimin e tij edhe pse për të njëjtin kemi votuar në mbledhjen përkatëse e tani po e anulojmë të njëjtin.

z.Besim Latifi, theksoi, unë disa herë e kam ngritur si çështje që kur të na dërgohen materialet të jenë të plota, pra sikur të na dërgohej ky material dhe certifikata e asaj prone sigurisht që ndokush prej 35 anëtarëve/eve të këtij Kuvendit do ta vërente duke e lexuar seriozisht që diçka nuk është në rregull. Dikush po e përmend që ka qenë në material por unë posa e kontrollova materialin dhe pash që nuk ka pasë material përcjellës për atë propozim vendim përveç dokumenteve dhe raporteve të QKMF-së që janë marrë atje për atë objekt, por nuk pash që ka qenë certifikata e pronës në atë material që na është përcjellë në e-mail. Prandaj kjo ndoshta duhet të na shërbej që të jemi shumë më të kujdesshëm në të ardhmen, aq më shumë kur tani jemi duke e respektuar edhe afatin përkatës që është 7 ditë pune dhe po kemi pak më shumë hapësirë për t'i trajtuar temat, kështu që materiali duhet të na dërgohet ashtu qysh duhet dhe të kemi mundësi që vendimet ose aktet e këtij Kuvendit të jenë në, përputhje të plotë me ligjin.

Tani unë po e kuptoj saktësisht se qysh do të funksionojnë ata (Qendra e Shërbimit Mendor) pasi që qenka funksionalizuar ai shërbim atje dhe nuk e di qysh ka mund të funksionalizohet ai shërbim kur në anën tjetër prona është private dhe në kontest, a duhet ndonjë vendim shtesë për t'i lejuar të funksionojnë ata deri sa të bëhet ndonjë zgjidhje apo qysh është e rregulluar kjo çështje ligjërisht.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, një pjesë e objektit është në pronësi të Komunës kurse një pjesë tjetër del të jetë në pronësi të dikujt nga familja Blaku, do të thotë një pjesë është andej një pjesë këndej, kështu që problemi është që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kur vëren se në qoftë se është një kontest i tillë siç është, nuk e aprovon ligjshmërinë e vendimit, përndryshe objekti dhe investimi është i Komunës, është shfrytëzuar për shumë vite për nevojat e Urgjencës së Qytetit, kurse tani se qysh do të zhvillohet procesi më tutje është vështirë të planifikohet.

Ta keni parasysh që ka raste dhe dukuri si dhe kam informacione që edhe rrugët që i kemi asfaltuar me kërkesa të qytetarëve tani kanë filluar të bëjnë ngapak edhe eskivazhe të tilla nëpër Gjykata në emër të kompensimit, do të thotë që në njërin anë kanë bërë presion të madh për t’jua asfaltuar rrugën kurse tani në një formë e dredhin situatën dhe kërkojnë kompensimin nëpër Gjykata, prandaj ne do të detyrohemi që tani e tutje çdo investim që e bëjmë fillimisht të kërkojmë që të shkojnë te Noteri, t’i plotësojnë dokumentet që janë të gatshëm të lëshojnë hapësirën e nevojshme e pastaj të fillohet me punime. Ju e dini shumë mirë që ne shumicën e rrugëve i kemi nëpër prona të qytetarëve sepse shumë pak ka pasë rrugë që në kuptimin e thjeshtë kanë qenë të definuara edhe në kadastrë si pronë/rrugë publike, andaj tani nëse na ndodh edhe kjo dukuri do të ishte problematikë dhe kush e di çfarë do të ndodh pastaj në të ardhmen sepse do të duhej të paguanim vetëm prona të atyre qytetarëve për ta zgjidhur këtë problematikë, apo mund të ndodhin raste që të shkojmë t’jua heqim asfaltin dhe t’iu kërkojmë falje që jua kemi asfaltuar rrugën.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë nëse pajtoheni e hedh në votim anulimin e vendimit nr.prot.01-463/06-0019215/26 të miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 31 mars 2026.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri me 21 vota Për, nga anëtarët/et e Kuvendit sa ishin prezent, me vendim vendoset të anulohet vendimi për dhënien në shfrytëzim afatgjatë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, objektin e ish Emergjencës së Qytetit, me arsyetimin se i njëjti nga MAPL është vlerësuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ndër të tjera duke theksuar se: “Parcela kadastrale në të cilën gjendet objekti që jepet në shfrytëzim afatgjatë, nuk është pronë e Komunës së Podujevës por është pronë e cila figuron në emër të personave individual dhe se po ashtu evidentohet se e njëjta parcelë kadastrale nr.258-0 ZK Podujevë, është në kontest gjyqësor”, si dhe duke kërkuar nga Komuna që të ndërmerr veprimet e nevojshme për rishqyrtimin e këtij.

8. Të ndryshme

z.Isak Shabani, Kryesues i Kuvendit, theksoi, thajse për këtë pikë të tëndit të ditës u ngritën të gjitha pyetjet dhe çështjet në mbledhjen e paradites që u mbajt (vazhdim i mbledhjes së 28 majit 2026), por si do që të jetë, nuk mund t’iu mohohet të drejta edhe tani, andaj urdhëroni e hapim këtë pikë të rendit të ditës kush dëshiron të marrë fjalën.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, po shfrytëzoj rastin pasi Kryetari i Komunës është këtu prezent, çështja është pikërisht për emërtimet e rrugëve sepse kemi parë që në Komunën e Podujevës shumë probleme, janë ndryshuar, por më bëri përshtypje para një jave rastësisht e pashë në intervistë Kryetarin kur tha se qytetarët i kanë ndryshuar, kurse atë të drejtë e ka veç Kuvendi i Komunës e që realisht ashtu është, mirëpo ato faktikisht në gjeoportale janë ndryshuar, nuk e di kush i ka ndryshuar, dhe për çka unë kam bërë pyetje njëherë këtu në Komunë me atë zyrtarin përkatës që është për këtë farë pune. Ka thënë që jo kam të drejtë, jo s’kam të drejtë. Pastaj i kam marrë vendimet e vitit 2015 të komisionit të Kuvendit se qysh është votuar dhe qysh janë emërtuar rrugët dhe gjitha çështjet tjera, dhe ju kam drejtuar me një shkresë Agjencionit Kadastral. Më është kthyer përgjigje dhe më kanë thënë saktë që po i dërgojmë Komunës të Podujevës sepse kanë bërë gabim. Është e vetmja rrugë dhe mënyrë që Kuvendi i bënë emërtimet e rrugëve. Pra kanë thënë

që po i'u dërgojmë shkresë Komunës që t'i kthej në gjendje të mëparshme qysh kanë qenë, kjo ngase unë i'a kam dërguar me dëshmi që në gjeoportali kanë ndryshuar kurse në dokumente dhe në vendime të Kuvendit janë ndryshe, duke i'a dokumentuar.

Ne e dimë që para një jave në Prizren pati edhe vrasje për këtë punën e emërtimit të rrugëve, andaj nuk e di përse po e bëjmë gjithë këtë punë kështu dhe nuk po e rregullojmë dhe ta lëm ashtu qysh ka vendosur Kuvendi, pavarësisht kush kanë qenë atëherë anëtar të Kuvendit që kanë votuar. Janë vendimet që janë votuar. Emrat e rrugëve të mos ndryshohen por të mbeten ashtu qysh kanë qenë të votuar edhe për rrugë të reja dhe emrat rezervë, ta dim a janë harxhuar ata emra rezervë apo ka ende, ndoshta në muajin tjetër të sjellët si pikë të rendit të ditës për shqyrtim këtu në Kuvend që të formohet komision dhe të dalim e ta zgjedhim këtë punë, e jo kur të na teket të punojmë tabela dhe t'i ndryshojmë emrat. Madje nuk e di pse këta emra të rrugëve me emra familjarëve, mua në shtëpi më janë bërë monoton e lëre t'jua lë emrin aty në rrugicën time, nuk e di çfarë kënaqësie është kjo kështu, ndoshta ka qenë mirë ta shqyrtojmë këtë farë pune.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ne e dimë që mbi këtë bazë ekziston një rregullativë ligjore se qysh ndërrohen emrat e rrugëve. Unë e di që Kuvendi Komunal ka punuar kohë të gjatë me një komision për të mbërri në pikën ku edhe kanë mbërri, tash a me lëshime apo pa lëshime unë nuk i di ato gjëra, me ose pa pakënaqësi e që sigurisht që ka pas pakënaqësi edhe atëherë, ka edhe sot pakënaqësi.

Kam informata, që ka raste individuale që njerëzit vet i kanë ndryshuar, po ashtu tani po flitet edhe për raste që një zyrtar (x zyrtari) i ka ndërruar e që e dim se nuk është përgjegjësi e tij dhe nuk mund ta bëjë këtë punë sepse nuk ka të drejtë ta bëjë. Për ta bërë të mundur mënjanimin e gjitha këtyre dilemave që mund të kenë ndodhur deri tani, unë jam i gatshëm ose Drejtoria përkatëse, të iniciojmë si problem dhe të formohet një komision nga ky Kuvend sepse unë e di që vendimin final veç ky Kuvend është kompetentë ta marrë për ndërrimin e emrave të një rruge apo rrugice. E di që ka qenë një listë primare dhe një listë sekondare ndihmëse e emrave të rrugëve, andaj nëse veç kërkohet të ndryshohet janë bërë disa korniza brenda të cilave duhet të gjenden emrat e rinj dhe për t'i heq këto dilema është mirë që në një seancë të radhës të formohet një komision prej të gjitha subjekteve politike, numri i anëtarëve nuk paraqet ndonjë problem.

Si çështje mendoj se është goxha punë me përgjegjësi sepse ka shumë probleme në terren. Tek unë ai zyrtar më ka sjellë një listë me gjithë lëndët me mbi 500 kërkesa që janë ku edhe figurojnë nënvizimet me të gjelbër në rastin e aprovimit dhe në rastin e mos aprovimit me një arsyeshmëri mbrapa dhe unë si Kryetar i Komunës nuk e kam as fuqinë e as guximin të marrë një përgjegjësi të tillë për t'i ndryshuar sepse është Kuvendi ai që vendos në fazën finale.

Pra të formohet një komision, unë mendoj ndoshta është mirë prej 5 anëtarëve sepse ka punë aty, madje nëse dëshironi edhe më shumë anëtarë, të ulet si komision dhe t'i trajtojnë gjitha ato kërkesa, zyrtari përkatës është këtu dhe ai është i obliguar t'jua ofroj krejt informacionet dhe kërkesat në fjalë sepse e di dhe kam dëgjuar që goxha ka telashe dhe ka pengesa në disa pjesë, kam dëgjuar që goxha probleme kanë ndodhur në këtë aspekt e që ka raste ku një person e heq tabelën me emrin e rrugës dhe e vë tjetrën, tjetri e vë atë tabelë e gjëra të tilla, kështu që e përsërisë që është mirë të formohet një komision siç e cekëm i cili të punoj për 3 apo 6 muaj apo sa të ketë nevojë, t'i analizoj të gjitha çështjet dhe në fund të përgatit një listë finale të cilën e sjellë në Kuvend për miratim e që besoj se zgjidhet si problem.

Ndoshta ka edhe rrugë të reja që janë ndërtuar në ndërkohë dhe paraqitet domosdo nevoja për vendosje të emrave të rinj andaj të kryhet si procedurë. Jam në dijeni se do të ketë probleme dhe këtë e mbështesë në informatat që kam për punën e atyre më herët si komision që kanë qenë dhe që kanë punuar në këtë çështje por sidoqoftë sa unë jam në dijeni baza ligjore është, nëse nuk ka ndryshuar diçka e që këtë Zyra ligjore mund ta hulumtoj, mirëpo siç jam në dijeni vendimin final për çdo ndryshim e merr ky Kuvend, dhe nuk ka të drejtë ligjore askush tjetër të ndryshoj emra të rrugëve pa vendim të Kuvendit, madje as unë si Kryetar i Komunës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, këtë kaos ai zyrtari përkatës e ka bërë më së shumti, shembull unë personalisht i kam dërguar edhe materialin çfarë më ka dërguar Agjencioni Kadastral sipas të cilit nuk ka të drejtë ai t'i bënë ato çka ka bërë, mirëpo ai qytetarëve ju ka thënë keni të drejtë me nënshkrime. Dhe pastaj kanë vërshuar me mbledhjen e nënshkrimeve dhe sjelljen e tyre në Komunë, prandaj atij zyrtari duhet t'i tregohet edhe publikisht sepse disa herë i kam thënë edhe privatisht, por nuk po merrke vesh, andaj duhet t'i tregohet edhe publikisht.

Jo që Kuvendit është i vetmi kompetentë, por ai nuk mund as t'ia delegoj askujt këtë kompetencë sepse është punë ekskluzive e Kuvendit me komision, pra nuk ka të drejtë as t'ia dërgoj e as t'i delegoj asnjë institucioni tjetër. Është pikërisht punë e Kuvendit të formoj komision, po edhe 100 Udhëzime të ndërrohen, Ligji e thotë këtë që e potencova unë që është njëra prej pikave që as të delegoj nuk mundet askujt, për atë që don ta kuptoj, por nuk ka nevojë t'i gënjejë qytetarët duke i'u thënë se ndërrohen me nënshkrime, sepse asgjë nuk mund të vlejë nënshkrimet e qytetarëve. Duhet të formohet komision këtu në Kuvend, ai komision të del në terren dhe atje duhet t'i merre nënshkrimet komision, por jo ky zyrtar sepse ky vetëm e bënë atë që komisioni e thotë si dhe ashtu qysh të vendos Kuvendi i Komunës, pra vetëm ka për t'i fut në gjeoportali fiks ashtu qysh janë vendos dhe shkruar në Kuvend. Duhet me kuptuar njëherë mirë që ligji e rregullon çartë këtë çështje e që është njëra prej kompetencave që as ta delegoj nuk mundet si Kuvend e që është emërtimi i rrugëve, i shesheve dhe të tjerave, ai ligj nuk ka ndryshuar.

z.Haki Rudari, theksoi, dëshiroj të inkuadrohem në këtë diskutim për arsye se në 2015 është formuar një komision nga Kuvendi dhe prej LVV-së në atë kohë ka qenë kolegu z.Bahri Selimi që ka qenë një komision i formuar prej partive politike në bazë të peshës së subjekteve politike përfaqësuese në Kuvend, pastaj ka pasë edhe nga Ekzekutivi i Komunës. Sa i përket çështjes që u diskutua, nuk ka të drejtë askush ama çfarë do zyrtari të jetë ai e që nuk po e di për kë është fjala, por nuk ka të drejtë askush të bëjë ndryshimin e emërimit të rrugëve që janë votuar në Kuvendin e Komunës.

e ceku e Kryetari i Komunës dhe ashtu është që tani ka edhe rrugë të reja, sigurisht numri mund të jetë i madh, po për ta emërtuar një rrugë, unë u mundova të hulumtoj këtu në telefon dhe pash dy-tri komuna që kanë ngritur komision nga Kuvendi komunal për emërtimin e rrugëve, dhe ne sigurisht në seancën e radhës do e shikojmë këtë çështje sigurisht edhe me Zyrën ligjore dhe mund ta formojmë komisionin në fjalë.

Vërtetë se nuk është punë e lehtë sepse jam informuar në atë kohë edhe nga kolegu z.Bahri Selimi për punën që e kanë bërë, dhe më besoni që nuk është krejt i lehtë në terren. Sigurisht që do të ketë vështirësi, propozime të shumta e tjera e tjera, por megjithatë fundja jemi këshilltarë të Kuvendit të Komunës dhe duhet të marrim edhe përgjegjësitë që na takojnë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj që kjo çështje është e sqaruar dhe e pastër si loti. Të gjithë ne qoftë Kryetari i Komunës, qoftë ne anëtarët e Kuvendit, ulemi dhe bisedojmë si Grupe të Kuvendit dhe në fund vendosim për procedurat e mëtutjeshme rreth çështjes së emrave dhe emërtimeve të rrugëve.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, nëse ai zyrtar i ka kaluar kompetencat e veta, do të sanksionohet.

z.Besim Latifi, theksoi, atëherë meqë ka kërkesë dhe ashtu siç e ceku edhe Kryetari i Komunës por edhe parafolësit dhe po shohim që ka njerëz të cilët edhe po i keqpërdorin këtë, unë mendoj që duhet të iniciohen si raste për ata që i keqpërdorin, qoftë qytetarë qoftë zyrtarë sepse ligji është i qartë.

Edhe ne e përkrahim formimin e një komisioni të tillë i cili do të dal në terren për t'i trajtuar ato ankesa për emërtim të rrugëve, dhe të kryhet si proces.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, unë mendoj që është edhe një lehtësim në këtë çështje sepse zyrtari në fjalë i ka edhe nënshkrimet e mbledhura dhe ka informata edhe tjera të cilat mund t'i merren dhe të trajtohen nga komisioni që do të ngritet e që sigurisht që do ta lehtësoj paksa edhe punën e këtij komisioni në trajtimin e çështjeve.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa kuptova unë do të thotë se në këtë kemi pajtueshmëri, si shefa të grupeve dhen unë si kryesues i Kuvendit mund të bisedojmë se kur mund ta prezantojmë formimin e një komisioni dhe normal që e dim që si kompetenca për një gjë të tillë ka vetëm ky Kuvend që të emërtoj rrugë në Komunën tonë, askush tjetër andaj nuk kemi çka diskutojmë tutje për këtë punë.

z.Isak Ejupi, theksoi, në periudhën e paradites njëri nga folësit që nuk qenka këtu tani, e potencoi çështjen e ndriçimit publik dhe unë për tre jave e kam monitoruar kohën kur ndezën dhe kur fiken dritat, kurse zotimi i drejtorit z.Bahri Selimi ka qenë që dritat do të fiken në ora 24:00. Në fakt dritat janë duke u fikur në ora 23:00, dhe unë sinqerisht po them se është çështje e vogël kështu në shikim të parë, mirëpo mos harroni që ka shumë punëtorë që punojnë në turne ose ndërrime dhe vijnë nga ndërrimi i dytë pikërisht në atë periudhë. Pastaj ka shumë nxënës e studentë që vijnë në kushte të ndryshme në Prishtinë edhe vijnë po në atë kohë edhe pa ndriçim i nënshtrohen edhe pasigurisë nga shumë faktorë duke përfshirë edhe faktorin njeri që në atë kohë mund të breshë për arsye të ndryshme por jo për arsye të mira. Prandaj unë e kisha lut drejtorin zotëri Selimi që dritat të ndizen pak më vonë, kjo sepse po ndizen kur është ndriçimi absolutisht i qartë do të thotë herët po vërehen, dhe po fikën atëherë kur janë më së shumti të nevojshme që të jenë të ndezura.

Edhe një pyetje të dytë nuk e di për kë shkon kjo sepse nuk po e di sakt kush është kompetent, por më intereson ta di a ka ndonjë statistikë dikush sa serbë e kanë shfrytëzuar të drejtën e kthimit në bazë të ligjit që kohëve të fundit është aprovuar, pra a ka serb nga Komuna e Podujevës që e ka shfrytëzuar këtë drejtë dhe është kthyer në Kosovë.

z.Enis Dervisholli, theksoi, në fshatin Shtedim te rr.”Besëlidhja” janë 33 metra tek lagja “Metehija” për tu shtruar asfalt. Po ashtu edhe rr.”Kongresi i Manastirit” në të cilën tani është bërë riparimi i rrugës ku është heq asfalti dhe është shtruar në kubza, andaj kam pyetje për drejtorin z.Bahri Selimi, përse nuk u shtrua asfalt por u shtrua kubza sërish, kjo si kërkesë e qytetarëve.

Gjithashtu edhe rr.”Sheqir Igishta” në fshatin Dumnice e Epërme në gjatësi 190 metra, edhe kjo si kërkesë e familjarve të asaj lagjeje.

z.Valdet Kamerolli, theksoi, unë e kam një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, faktikisht një kërkesë për hapësirat e jashtme të objekteve shkollore të përdoren prej qytetarëve, për lagje, gjatë vikendeve dhe atë tani gjatë pushimeve verore e që shembull ka shumë të tilla sikurse në Lagjen ku jetoj unë te shkolla “Isa Boletini” ku është mbyllur fusha e jashtme dhe nuk mund të përdoret nga qytetarët, përndryshe këtë e kemi edhe premtim elektorale.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, **kur e kemi votuar** listën e përgjithshme të pronave dhe listën e veçantë, janë kanë qenë edhe fusha e futbollit të KF Llapit dhe lokalet, pra kanë hyrë në plan dhe e kam shikuar ku aty thuhet; mars-qershor duhet të sjellën në Kuvend, andaj a ka mundësi ta dimë përse nuk janë sjellë në Kuvend, apo a do të sjellën, kjo meqë janë votuar përse nuk po dalin në Kuvend për shqyrtim.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, përgjigje para folësit, theksoi, besoj që do të sjellën në seancën e radhës sepse nuk besoj që ka ndonjë arsye tjetër, absolut. Po ashtu besoj që asnjëri prej juve nuk keni asnjë dilemë që fusha dhe stadiumi i KF Llapit është pronë e Komunës.

z.Ekrem Rrahmani, nga vendi i drejtohet Kryetarit duke theksuar që ai atje po thotë që stadiumi është i imi, kam investuar dhe madje po e shfrytëzon atë dhe lokalet përreth duke i dhënë me qira.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, vazhdoi, unë e kam nisur procedurën administrative për ta sqaruar atë çështje sepse ai person mendon që e ka privatizuar atë krejt e që në realitet nuk është ashtu sepse është pronë e Komunës. Po ashtu ju e dini besoj qysh është edhe çështja e Zyrës së Kadastrit këtu në Komunë, të cilët i’a kanë vë klikun (shkrimin) aty në dokument për shfrytëzim të përkohshëm të stadiumit nga KF Llapi dhe sot e asaj dite nuk dihet arsyeja se mbi çfarë baze ligjore i’a kanë vë atë klik (shkrim) mbrapa, mirëpo kur një ditë kërkoja me ngulmë të informohem sakt, më thanë që i’a kanë vë ashtu sepse ka pasë rrezik për t’ia kaluar të tërin në pronësi atë pronë publike, andaj për të mos kaluar në pronësi, i’a kanë vë atë klik (shkrim), dhe pastaj kur jua kërkoj vendimin e Kuvendit me të cilin i është dhënë shfrytëzim, nuk ka vendim

të Kuvendit fare. Do të thotë i'a kanë vë klikun (shkrimin) pa vendim të Kuvendit dhe pa asgjë fare e që është një shkelje flagrante ligjore që e kanë bërë ata që kanë qenë paraprakisht drejtor të Drejtorisë, dhe tani ai person është duke e shfrytëzuar atë sikur të jetë pronar, kurse në realitet nuk është pronar, andaj jo rastësisht unë i kam paraparë në atë listë për t'i dhënë në shfrytëzim për t'ia bërë me dije që nuk është e tij por është pronësi e Komunës.

Në seancën e radhës, mund të bisedoni me drejtoreshën e DPKGJ, dhe t'i sjellë në Kuvend për miratim parapark dhe pastaj të zhvillohen procedurat e shpalljes publike dhe të vazhdojnë gjërat sepse edhe Restorantin që është duke e shfrytëzuar është në mënyrë jo të ligjshme, do të thotë në një formë konsiderohet uzurpim, madje ju e dini shumë mirë që edhe po të jetë shfrytëzues i objektit nuk ka të drejtë t'i jap në shfrytëzim personit të dytë apo tretë ai vet, ndërsa ai zotëriu ka bërë edhe kontrata me të tjerët, e them këtë sepse unë posedoj kontrata dhe dokumentacion sipas të cilave ai person i ka dhënë në shfrytëzim të dytit e të tretit...

z.Ekrem Rrahmani, sërish i drejtohet Kryetarit të Komunës për këtë temë duke theksuar se për këtë çështje edhe Auditori në raportin e vet që e ka bërë vetëm për prona i ka cekë disa mangësi të Komunës së Podujevës sa i përket shfrytëzimit të pronave komunale, mbikëqyrjes së kontratave e gjëra të tilla. Përndryshe ne nuk jemi kundër shfrytëzimit të asaj prone nga KF Llapi, le të merre ai për 10 ose 20 vite por vetëm të rregullohet kjo çështje me dokumente.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, vazhdoi, po është e vërtetë ajo, mirëpo unë jam shumë i interesuar për ta mbrojtur ligjshmërinë absolutisht sepse nuk është pronë e tyre. Çka është e vërtetë se ne nuk kemi vendim të Kuvendit, unë kam kërkuar vendim të Kuvendit se mbi çfarë baze i është dhënë në shfrytëzim ajo pronë ose ai stadium. Në rregull, ne e dimë klubi që ka qenë atëhershëm, ai ka qenë i themeluar dhe në pronësi të Komunës, por ai klub është shuar tani dhe ka kaluar në OJQ e në shoqëri aksionare, përndryshe edhe asambleisti z.Isak Ejupi mund t'i din edhe disa gjëra që edhe unë i di pak a shumë, për disa marifete se çka kanë bërë, qysh kanë gjërat për ta prurë deri këtu, kështu që e keqja e madhe është që ai person mendon ende që është pronë e tij, thotë që ka investuar aty, mirëpo ne si Komunës jemi duke investuar 2 milion euro së bashku me Ministrinë e Kulturës, e që në objekte të huaj nuk shkojmë të investojmë sikurse as në objekt privatë që nuk investojmë ne sepse nuk kemi obligim për objekte private, pra investojmë në pronë publike dhe objekte publike të Komunës, ndërsa ai person thirret në atë duke thënë se kam investuar madje po ta dëgjosh atë, ne jemi në borxhe tek ai, kurse bëhet fjalë për objekt të Komunës.

Kështu që për këtë çështje unë legalisht / zyrtarisht kam iniciuar procedurë administrative në Gjykatë, por këto Gjykatat tona, zoti e bëftë hair sepse nuk dihet edhe se çka mund të na vendosin, por dokumenti zyrtar është që është në shfrytëzim në pronësi të KF Llapit, në anën tjetër vendim të Kuvendit nuk ka e që një pronë nuk mund ta jap askush në shfrytëzim pa vendim të Kuvendit, përveç nëse e kanë bërë me negociim ashtu qysh u përmend më herët mirëpo ai person duhet ta ketë 10% të buxhetit të komunës për investim, kurse të gjithë e dim sa ka investuar aty. Pra situata është kjo.

Sa i përket çështjes së regjistrimeve që u cekë, ne thuajse jemi interesuar por jo legalisht sepse kjo është çështje e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk është e Komunës, mirëpo sa kam disa informacione, po ka që po vijnë po regjistrohen sa për zgjedhje e këso gjëra. Pra jam interesuar me këtë zyrën përkatëse e cila lëshon dokumente të tilla, më kanë thënë që janë raste shumë simbolike dhe jo nuk ka ndonjë trend diçka më shumë, raste çfarë kanë mund me ndodh një-dy, por jo në kuptimin e trendit diçka. Kështu më kanë thënë gojarisht, ndonjë informatë tjetër zyrtare nuk kam sepse u interesova edhe unë ngase më tha edhe dikush që po vijnë shumë e gjëra të tilla, por jo as me dokumente as me gjëra të tjera nuk ka diçka. Madje i kam pyetur edhe zyrtarët e Gjendjes Civile këtu në Komunë se a ka trend të regjistrimit sipas ligjit të ri, përgjigja e tyre është sikurse që ka ndodhur gjithmonë, jo diçka jashtë normales.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, atëherë të sqarohemi se tek pyetjet që bëjnë këshilltarët nuk hapet debat, jepen vetëm përgjigjet sikurse që i'u dha përgjigja z.Ekrem Rrahmanit, prandaj për pyetje nuk kemi nevojë të hapim debat, përndryshe në disa pyetje ka mbet vetëm edhe drejtori z.Bahri Selimi që t'i jap disa përgjigje, nëse veç nuk ka të tjera këtu e tutje.

z.Abedin Zeka, theksoi, një pyetje e kam për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z.Bahri Selimi, në lidhje me ndriçimin e rr.”Bekim Lushaku” përkatësisht rrugës për në Ballocë, e cila që një kohë të gjatë është në defekt një pjesë e ndriçimit publik sepse një pjesë është në rregull, e që banorët atje kërkojnë nga Drejtoria sqarim apo përgjigje sepse ka një kohë të gjatë që nuk është duke punuar ndriçimi publik në atë pjesë.

z.Arbrim Kunushefci, theksoi, pyetja ime ka të bëjë ose thënë të drejtën më shumë është si kërkesë për Drejtorinë e Arsimit, pra është hall i mësimdhënësve ose kolegëve të mi mësimdhënës që ka të bëjë me përdorimin e një platforme digjitale për plotësimin e dëftesave që të kalohet prej një forme klasike që është aktualisht në një formë digjitale. Kjo do ta lehtësonte edhe punën administrative të mësimdhënësve dhe do të ishte një lehtësim barre për pagesat që nxënësit për çdo vit blejnë dëftesat me paratë e tyre vetanake. Prandaj besoj që është një kërkesë sado e vogël por do të krijonte kushte më të mira sa i përket digjitalizimit dhe lehtësim pune për mësimdhënësit.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH, theksoi, po mundohem shkurt të jap përgjigje në pyetjet e adresuar në drejtim të DSHPMSH.

Fillimisht sa i përket ndriçimit publik apo kohës së ndaljes së ndriçimit publik, unë e kam shpjeguar edhe njëherë më parë në këtë Kuvend kur kemi diskutuar për këtë çështje, ideja ka qenë që të bëhet me rele kohore dhe ndriçimin publik të ndalet në kohën të cilën ne e caktojmë e që ka qenë në ora 12:00, kurse tani ndezja e atyre që ke si pyetje se a mund të ndezën pak më vonë, ju informoj se ndezja e tyre bëhet me foto-rele që nënkupton me dritë dhe me terr, ndërsa kjo rele kohore është përcaktim i kohës se kur të ndalet ndriçimi, pra të gjitha ndezën me foto-rele ndërsa sa i përket ndaljes së tyre vërtetë që nuk është rasti i parë që ka ankesa në këtë aspekt ku diku ndalen më herët diku më vonë, mirëpo ta keni parasysh që kjo rele kohore është mekanike, nuk është digjitale dhe kjo me dorë rregullohet përmes rregullatorit, andaj ka disa raste ku dritat ndalen diku më herët diku më vonë, por tash më kompania jonë (NPL Eko-Llapi) po merret edhe me këto probleme dhe kudo që ka ankesë ata shkojnë dhe mundohen ta rregullojnë, edhe pse është goxha problem që sakt në ora 24:00 të ndalen sepse mund të ketë pak kohë para ose pas orës 24:00, por me rëndësi është që po mundohemi t'i ndalim të gjitha në ora 24:00 në mënyrë që kursimet e shpenzimit të energjisë të jenë sa më të mëdha e që tani më kanë filluar të reflektojnë si kursime edhe tek pagesat që po faturohen nga KEDS.

Sa i përket çështjes të rr.”Kongresi i Manastirit”, parashtuesi i pyetjes tani më nuk qenka prezent këtu, por unë po jap përgjigje për hire të qytetarëve dhe opinionit sepse jam në dijeni që kanë shprehë si shqetësim, pra rr.”Kongresi i Manastirit” e cila ka qenë me asfalt edhe tani po bëhet me kubza, arsyet kryesore janë që ne në vitin e kaluar kemi bërë kanalizimin fekal në atë rrugë e që ka qenë problem goxha i madh për ta bërë atë kanalizim për shkak të kablllove dhe rrjeteve tjera të shumta në atë rrugë, por kemi arritur diqysh dhe e kemi bërë atë kanalizim me pretendimin që të vazhdohet të bëhet edhe kanalizimi atmosferik që i mungon asaj rruge dhe gjitha problemet kanë qenë të lidhja apo përzjerja e kanalizimit atmosferik me kanalizimin fekal, kurse tani e kemi ndarë atë dhe është dashtë ta bëjmë edhe një kanalizim atmosferik shtesë dhe tani ajo rrugë komplet nën dhe është me rrjete të ndryshme, qoftë rryma, qoftë rrjetet e interneteve, qoftë kanalizimet fekal dhe atmosferik, mandej gypi i ujit i cili është më lart me të cilin kanë pas një problem që do të thotë se të gjitha këto rrjete janë nën atë rrugë. Prandaj kjo është arsyeja që është dashtë të bëhet ajo rrugë me kubza sepse në të ardhmen mund të ndodh të intervenohet në atë rrugë për secilin defekt të mundshëm që mund të ndodh në këtë infrastrukturë nëntokësore, por edhe për shkak të ngushticës së rrugës e që është dashur ekstra me një rrafshues të asfaltit të hyhet aty e që pothuajse ka qenë e pamundur, pra këto

janë dy arsye kryesore, mirëpo unë mendoj që edhe për ata banorë është më mirë që është me kubza për shkak se intervenimet edhe sanohen shumë më lehtë por edhe nuk bëhen më prerje ashtu qysh janë bërë më herët në tërë rrugën e që pastaj ka mbetur shumë keq.

Sa i përket ndriçimit publik në Lagjen e cekur nga asambleisti z.Abedin Zeka, atje veç kanë qenë kompania përkatëse disa herë dhe janë munduar ta rregullojnë atë problem, por jua kemi shpjeguar edhe banorëve aty se ekziston një problem i lidhjes së shkurtër diku aty por që janë duke u munduar ta gjejnë si problematikë që ta rregullojnë në atë pjesë ndriçimin publik i cili ka një kohë që është jashtë funksionit.

z.Avni Fetahu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, u parashtruan dy pyetje shumë me vend nga asambleistët z.Valdet Kamerolli dhe z.Arbrim Kunushefci.

Sa i përket çështjes së mundësisë për t'i shfrytëzuar hapësirat publike për ushtrimin e aktiviteteve sportive të shkolla ekonomike në Podujevë, ne do të bisedojmë me NPL "Eko-Llapi" për dhënien si mundësi që vetëm në këmbë të hyhet aty dhe të mos lejohet hapësirë për hyrje me vetura dhe do ta bëjmë një gjë të tillë, kurse shkolla "Shaban Shala" jeni në dijeni se është duke u ndërtuar objekti dhe posa të përfundohet do t'i japim mundësinë edhe aty qytetarëve të zhvillojnë aktivitete sportive.

Ishte pyetja shumë me vend e z.Arbërim Kunushefci, disa mësimdhënës të cilët me teknologji qëndrojnë më mirë veç kanë filluar ta përdorin atë, por ne jua kemi lënë dy mundësitë sepse siç e dini ka disa mësimdhënës të cilët janë në moshë të shtyrë dhe po kanë probleme, kështu që i kanë dy mundësitë, plotësimin e dëftësave qoftë përmes teknologjisë, qoftë përmes formës klasike siç i kanë vepruar më parë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të nderuar anëtarë/e të Kuvendit të Komunës, meqë shqyrtuam dhe trajtuam të gjitha pikat e rendit të ditës, ju falënderoj për kontributin, diskutimet dhe korrektësinë në këtë mbledhje, dhe me këtë rast e shpallë të mbyllur këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës. Mirupafshim në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 17:45

Procesverbalin e mbajtën dhe hartuan;

Enis Sheholli

Osman Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0037574/26

Podujevë,

29 qershor 2026

Kryesuesi i Kuvendit

Isak Shabani